

1 E martë, 23 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal vërej se të katër të akuzuarit janë të pranishëm
13 në sallën e gjyqit sot.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Mbrojtjes së Thaçit 1DW-006.

16 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, do të
17 trajtojmë disa çështje paraprake. Së pari, do të jap një
18 urdhër gojor.

19 Trupi Gjykses rikujton që në seancën e ditës së djeshme
20 Mbrojtja e Thaçit paraqiti për pranim në prova gjyqësore një
21 dokument që ne i dhamë numrin e provës provizore MF1 1D00388.
22 Prokuroria kundërshtoi pranimin e këtij dokumenti si provë
23 gjyqësore sepse bëhet fjalë për një deklaratë me shkrim të
24 dhënë nga një dëshmitar dhe si rezultat kjo deklaratë, sipas
25 Prokurorisë, nuk duhet të pranohet në prova. Mbrojtja e Thaçit

1 u kundërpërgjigj që deklarata në fjalë nuk bie nën
2 fushëveprimin e rregullave 153 deri në 155 sepse nuk është një
3 dëshmi e cila është dhënë në kontekstin e proceseve penale
4 sikurse parashikohet në rregullat 153 deri në 155. Kjo jepet
5 në transkriptin në kohë reale të ditës së djeshme në faqet 104
6 dhe 105.

7 Sikurse është theksuar dhe një herë nga Trupi Gjykses,
8 rregulla 153 dhe 155 janë *lex specialis* në kuptimin që
9 dëshmitë e dhëna me shkrim ose deklaratat me shkrim nga një
10 dëshmitar, pra, janë pjesë e *lex specialis*. Këtë e ka
11 specifikuar Trupi Gjykses në parashtrimin F01852, në
12 paragrafin 10. Kur dëshmia e propozuar cilësohet si deklaratë,
13 ajo duhet të ofrohet në pajtim me një prej rregullave të
14 rregullores.

15 Trupi Gjykses vëren që rregulla 153 deri në 155 nuk e
16 kufizon fushëveprimin në deklaratat në proceset civile ose
17 procese penale. Sa i takon formulimit të Trupit Gjykses në
18 parashtrimin F03340, Trupi Gjykses vëren që fjala "proces" nuk
19 është e kufizuar në proces penal. Në mbështetje të kësaj,
20 Trupi Gjykses udhëzon palët dhe pjesëmarrësit që të shohin
21 parashtrimin F01700, paragrafin 69, F0152, paragrafi 8 dhe
22 F00334, paragrafin 84 dhe 87 në Çështjen 07, të cilat
23 përmenden të gjithë në poshtëshënimin 34 të parashtrimit
24 F03340. Për qëllime të rregullës 153 deri në 155, mjafton që
25 deklarata në fjalë është një dëshmi në natyrë dhe që është

1 dhënë përpara një procesi gjyqësor, pavarësisht natyrës së
2 procesit gjyqësor.

3 Në këtë rast, nuk ka pikë dyshimi që dokumenti i
4 propozuar përbën një deklaratë me shkrim të dëshmitarit të
5 propozuar dhe kjo është një deklaratë e cila është dhënë
6 përpara Gjykatës së Lartë në panelin ose në Divizionin e
7 Panelit të Gjykatës së Queen.

8 Dhe, për rrjedhojë, Trupi Gjykses shqyrton dhe vlerëson
9 që nuk dëmtohet procesi përmes pranimi të deklaratës
10 përkatëse, pasi Mbrojtja e Thaçit ka pasur mundësi të
11 mjaftueshme që të japë paragrafë ose pjesë të ndryshme
12 relevante dhe deklaratës për Trupin Gjykses.

13 Për pasojë, duke marrë parasysh sa më sipër Trupi Gjykses
14 rrëzon kërkesën për pranimin e dokumentit që ka numrin
15 provizor 1D00338 dhe udhëzon Zyrën Administrative që ta heqë
16 këtë dokument dhe të lirojë numrin e provës.

17 Kjo përfundon urdhrin e parë gojor të Trupit Gjykses.

18 Së dyti, Trupi Gjykses vëren se deri më tani koha e
19 vlerësuar nga ekipet e ndryshme është shumë më poshtë sesa
20 koha e vlerësuar paraprakisht. Trupi Gjykses i bën thirrje
21 palëve që të japin një vlerësim real për dëshmitarët në vijim.

22 Në këtë aspekt, Trupi Gjykses ju kujton palëve që gjatë
23 gjithë procesit gjyqësor ka qenë fleksibël lidhur me kërkesën
24 e tyre për kohë shtesë për të bërë pyetje për dëshmitarët
25 përkatës.

1 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të

2 Mbrojtjes së Thaçit 1DW-006.

3 Znj. Sekretare, ju lutem silleni në sallë dëshmitarin.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
6 Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
9 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtohet që të përpigjeni t'i
10 jepni përgjigje pyetjeve qartë dhe me fjali të shkurtra. Në
11 qoftë se nuk e kuptoni një pyetje të caktuar, lirisht mund t'i
12 kërkonit avokatit përkatës që t'ju thotë edhe një herë pyetjen
13 ose t'ju sqarojë më tej atë. Po ashtu, ju lutem kujtoni që
14 duhet të jepni bazën e njohurive, të fakteve dhe rrethanave
15 për të cilat do të pyeteni.

16 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrim të thoni të vërtetën
17 sikurse e keni deklaruar në deklaratën solemne.

18 Ju lutem gjithashtu duhet të flisni pranë mikrofonit për
19 të dëgjuar plotësisht dhe bëni një pauzë prej pesë sekondash
20 përpara sesa të jepni përgjigje për pyetjet dhe ju lutem
21 gjithashtu flisni ngadalë për t'ju kapur përkthyesit.

22 Nëse e shihni të nevojshme për të bërë pushime, na e bëni
23 me dije këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse.

24 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë.

25 Z. Halling, e keni ju fjalën.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

2 DËSHMITARI: JOHN DUNCAN [Vijon]

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Halling:

4 [Vazhdim]

5 Z. HALLING: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

7 PË. Mirëmëngjes.

8 PY. Sikurse e tha Gjykatësi, do të fillojmë me pyetjet e mia
9 sot paradite.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 [Përkthim] Ka një problem me Gjykatësin Barthe pasi nuk i
12 shfaqet transkripti në ekran.

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Mund të vazhdoni, Prokuror. Ju kërkojmë ndjesë për
16 ndërprerjen.

17 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e seancës

18 këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

20 vazhdoni, Prokuror.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

22 PY. Sikurse po thosha, Dëshmitar, do të vazhdoj me pyetjet e
23 mia sot paradite. Do shohim në qoftë se do të mund të
24 përfundojmë deri në orën 11.00.

25 Tani do të kthehemi dhe një herë tek diskutimi që patëm

1 dje në fund të ditës. Dje e përfunduar bisedën duke folur
2 lidhur me masën deri në të cilën ishin të përfshirë
3 komandantët e zonës në 17 qershor 1999 dhe negociatat për
4 marrëveshjen dhe po flisnim konkretisht për Ramush Haradinajn.

5 A mund të na përmendni emrat e të gjithë komandantëve të
6 zonës që kanë qenë të pranishëm atë ditë atje, në qoftë se ju
7 kujtohet, Dëshmitar?

8 PË. Përgjigja për këtë pyetje është jo. Ju kërkoj ndjesë për
9 këtë. Jam i sigurtë që ju merreni me këtë çështje përditë,
10 ndërkohë që unë personalisht nuk jam marrë në këtë nivel
11 detajesh lidhur me këtë çështje gjatë 26 viteve të fundit. Më
12 kujtohen disa figura kryesore, disa persona kyç si, për
13 shembull, Remi ose Haradinaj, po në qoftë se më tregoni një
14 fotografi sikurse e pamë në rastin e videos dje, mund të më
15 tregoni personat, mund të më thoni emrat dhe unë mund t'i
16 konfirmoj. Ndërkohë në qoftë se më kërkonit sot që të përmend
17 emrat e komandantëve pas 26 vitesh nuk e bëj dot këtë gjë.

18 PY. Kur po flisnit për Ramush Haradinajn dje, ju thatë që
19 mesa ju kujtohet, ai ka qenë i pranishëm gjatë gjithë kohës
20 dhe që ai ishte pjesë e grupit më të ngushtë që mori pjesë më
21 pas në banketin që u shtrua pas takimit. A ju kujtohet ta keni
22 thënë dje këtë?

23 PË. Po.

24 PY. Tani dua të shikojmë së bashku intervistën e Ramush
25 Haradinajt që e pamë edhe dje. Është intervistë e vitit 2001.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
2 që të paraqesë në ekran dokumentin SPOE000523072 deri në
3 00053080.

4 PY. Do ta shikojmë këtë dokument bashkë, Dëshmitar.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Do të fillojmë në faqen
6 SPOE00053080. Faleminderit që i treguat të dyja versionet në
7 shqip dhe në anglisht.

8 PY. Kjo është nënpjesë e intervistës nën titullin
9 transformimi i UÇK-së. Ramush Haradinaj në këtë pjesë nuk flet
10 për negociatat e 19 qershorit konkretisht, megjithatë ajo i
11 thotë diçka lidhur me datën 17 qershor.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares tani të
13 kalojmë në dokumentin SPOE00053082.

14 PY. Dje folëm lidhur me kolonën në të majtë. Dua që t'ju
15 kërkoj që të lexoni drejt fundit të kolonës së majtë dhe
16 pastaj të vazhdojmë në të djathtën. Aty thotë që:

17 "Filloi që të fliste për reagimin e Jakup Krasniqit."

18 Dhe më tej në kolonën në të djathtë thuhet si më poshtë:

19 "Jakup Krasniqi reagoi në titullin e kërkesës, jo të
20 çarmatosen grupet e armatosura, por të flitet për Ushtrinë
21 Çlirimtare të Kosovës. Aty e kam marrë fjalën dhe unë dhe kam
22 thënë se duhet biseduar për transformimin e jo për
23 çarmatosjen. Më pastaj kanë folur edhe të gjithë, edhe
24 Gjeneral Çeku, i cili ka qenë shumë i prerë. Dhe ka treguar,
25 se në bazë të rrethanave të krijuara dhe në bazë të

1 trashëgimisë e të tjera, ne do të transformohemi, do ta humbim
2 rolin çlirimtar që kishim në luftë por dëshirojmë të
3 zhvillojmë si strukturë për të ndihmuar rindërtimin dhe
4 zhvillimin e Kosovës dhe natyrisht për t'i ndihmuar aspiratat
5 e popullit tonë për një mekanizëm mbrojtës që do të ketë
6 Kosova në të ardhmen. Fillimet e negociatave për transformimin
7 e UÇK-së kanë qenë në këtë takim të Berishës. Unë jam
8 nervozuar në këtë takim të parë me ato që dëgjova dhe kam
9 braktisur takimin. Pra, kam marrë pjesë vetëm në një seancë
10 dhe më pas nuk shkua më."

11 Dëshmitar, plus asaj çfarë ka thënë Ramush Haradinaj këtu
12 që thotë që u inatosa dhe u nervozova dhe nuk u ktheva, ai
13 thotë që nuk ka qenë i pranishëm në banketin që ne diskutuam
14 dje. A është e mundur që ju ta keni pasur gabim që thatë që
15 Ramush Haradinaj ka qenë i pranishëm gjatë gjithë negociatave
16 dhe më pas ka qenë i pranishëm në banket?

17 PË. Mbase do ishte mirë që të shikonim dhe njëherë
18 fotografinë që kishte të bënte me banketin. Kjo mund të jap
19 përgjigjen e saktë.

20 PY. Po patjetër, mund ta shikojmë këtë video.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Është dokumenti 1D287 dhe video u
22 transmetua dje nga minuta e 05:48 deri në minutën 06:29.

23 Përderisa thjesht do shikojmë videon, domethënë, nuk do ta
24 dëgjojmë me audio, nuk është e nevojshme që të kemi
25 transkriptim për këtë pjesë.

1 [Luhet videoincizimi]

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. E patë, ishte tek kjo video?

4 PË. Jo, nuk ishte.

5 PY. Do t'ua bëj edhe një herë pyetjen që ju bëra përpara një

6 çasti. A është e mundur që ju ta keni thënë gabim dhe ta keni

7 kuptuar gabim që Ramush Haradinaj ka qenë aty gjatë gjithë

8 takimit?

9 PË. Varet se për çfarë e keni pyetjen. Nuk jam i qartë për

10 pyetjen që më bëni. Domethënë, ajo çfarë Ramush Haradinaj

11 thotë në libër është një përkthim shumë i saktë i asaj çfarë

12 ka ndodhur në negociatë. Banketi ka ndodhur më pas. Sikurse e

13 thashë, banketi ka qenë një pjesë e rëndësishme e diskutimeve.

14 Por nuk ishin negociatat. Domethënë, negociatat thjesht kishin

15 të bënin me diskutimin e tekstit, me të parin e formulimit të

16 tekstit, me diskutimet lidhur me tekstin, por nga na tjetër

17 ngrënia e një kafshate bukë ishte tjetër gjë ishte diskutim i

18 përgjithshëm, pra, sikurse mund të shihet shumë qartë nuk

19 është një person që e udhëheq diskutimin por ka shumë njerëz

20 që flasim, që flasin për tema të ndryshme dhe që shprehin

21 mendimet e tyre. Pra, dua të them dhe një herë tjetër që është

22 një proces i rëndësishëm i procesit, por nuk është negociatë.

23 Negociatat sikurse e patë më herët në video, negociatat

24 ndodhën në një sallë tjetër ku kemi shkëmbyer mendimet,

25 opinionet për pika të caktuara, domethënë, kemi pasur dhe

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 10

1 përkthim, kemi pasur dhe përkthyesin të pranishëm, në qoftë se
2 ju kujtohet, ndërkohë që në banket nuk kishte përkthyes.
3 Domethënë, ishin thjesht biseda të lira por nuk ishin
4 diskutime të strukturuar lidhur me negociatat.
5 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
7 të pranohen në prova gjyqësore përgjigjet e Ramush Haradinajt
8 në këtë pjesë të intervistës për sa i takon transformimit të
9 UÇK-së. Dokument që kërkojmë që të paraqitet si provë
10 gjyqësore, është SPOE00053080 deri në 00053083. Duhet që të
11 pranohet për të gjithë kontekstin sepse ka të bëjë me
12 besueshmërinë me atë çfarë i kujtohet dëshmitarit për ngjarjet
13 dhe ka të bëjë gjithashtu edhe me nënkuptimet e bëra ose
14 pikëpamjet e tij lidhur me rolin që kishin komandantët e
15 zonave në negociata.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
17 kundërshtim?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk
19 kundërshtojmë për këtë pjesë konkrete që iu paraqit
20 dëshmitarit, por duhet të pranohet vetëm pjesa që iu tregua
21 dëshmitarit, asnjë dokument tjetër, asnjë shtesë. Po ashtu
22 edhe udhëzimi ose komentet e bëra nga z. Halling, këtë pjesën
23 neve e kundërshtojmë. Po ashtu z. Halling tha që video nuk
24 kishte të bënte me datën 19, pra, të paktën në intervistën që
25 u tregua.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e dimë se
2 si mund të tregojmë ndryshe që negociatat e datës 19 nuk janë
3 diskutuar në këtë pjesë që ne kërkojmë që të pranohen në prova
4 gjyqësore.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
6 SPOE00053080 deri në 53085 pranohet në prova.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
8 të marrë numrin e provës P4493. Klasifikimi është publik, apo
9 jo?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

11 PY. Dëshmitar, sapo në fakt pamë dje pjesë të videos që
12 kishin të bënim me datën 17, po tani do shohim një pjesë të
13 videos që lidhet konkretisht me negociatat.

14 E gjithë pjesa e kësaj videoje iu tregua dhe më herët, iu
15 bënë pyetje se kë mund të njihnit aty dhe ju thatë që njihni
16 veten, Gjeneralin Çeku, Gjeneralin John Reith, Ramush
17 Haradinaj, mendoni që edhe Remi ka qenë aty dhe kishte disa
18 emra të tjerë që nuk ju vinin në mend, që nuk i kujtonit dot.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është dhënë në faqen 49 të
20 transkriptit në kohë reale.

21 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur më konkretisht me
22 persona që do të shfaqen në video dhe çfarë mund të kujtoni ju
23 lidhur me këta persona.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Do fillojmë në video në minutën
25 03:07.

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 12

1 Do i lutesha Sekretares ta paraqesë.

2 PY. Personat që janë në qendër, domethënë, personi i cili
3 është tek cepi në qendër të fotografisë, a është Gjenerali
4 John Reith ky?

5 PË. E keni fjalën për personin që është ulur pas kësaj pjesës
6 me ngjyrë të kafe dhe që është ngjitur me mua, ky është John
7 Reith.

8 PY. Në fakt ju identifikuat dy persona se kjo ishte pyetja
9 ime e radhës se kush është ulur ngjitur me John Reith?

10 PË. Unë jam ulur në të majtë të John Reith.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkojë Sekretares që të
12 kalojmë në minutën 05.00.

13 PY. Ju lutem përqendrohuni tek zotëria në mes në qendër. Kush
14 është ky person?

15 PË. Është Gjenerali Çeku.

16 PY. Kush është personi që është ulur në të majtë të tij ose
17 në të djathtë të fotografisë?

18 PË. Z. Krasniqi.

19 PY. Agim Çeku dhe Jakup Krasniqi çfarë ishin, komandantë zone
20 apo komandantë rajonalë?

21 PË. A mund të ma sqarosh pak pyetjen sepse përgjigja e
22 thjesht është po. Por përgjigja e thjeshtë është jo,
23 domethënë, ne të gjithë e dimë këtë gjë. E di unë, e dini ju,
24 e di gjithë bota, kështu që nuk e kuptoj dot se çfarë ku doni
25 të dilni me pyetjen tuaj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 përgjigjuni pyetjes.

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 PY. Ju thatë jo, ju thatë që nuk janë komandantë zone. Në
5 fakt kjo është përgjigja e pyetjes time sepse fushëveprimi i
6 pyetjes time është pak më i gjerë. Po ju u përgjigjët pyetjes.
7 Ju falënderoj për këtë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Tani dua që të shkojmë tek minuta
9 e 04:47 në video.

10 PY. Dëshmitar, do shfaqet një zotëri në video dhe unë do i
11 kërkoj Sekretares që të paraqesë videon për dhjetë sekonda
12 pastaj do ju bëj një pyetje lidhur me këtë person.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kështu që le ta transmetojmë, le
14 ta paraqesim videon nga këtu ku jemi deri në minutën 04:57.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 PY. Ky zotëria që është në cep në të majtë të fotografisë që
18 keni në ekran, a e njihni, e dini kush është ky person?

19 PË. Nuk më kujtohet kush është ky person.

20 PY. A e dini nëse ky person është komandant zone?

21 PË. Përderisa nuk më kujtohet se kush është, nuk mund të them
22 në qoftë se është komandant zone apo jo personi përkatës.

23 PY. Po emri Bislim Zyrapë a të kujton ndonjë gjë?

24 PË. Pas 26 vitesh, sikurse ju shpjegova dhe pak më herët,
25 emrat e komandantëve, emrat e të gjithë komandantëve,

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 14

1 sigurisht që nuk më kujtohen.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Le të kalojmë tani në një
3 fotografi të marrë nga videoja që është në minutën 04:23.

4 PY. Ky zotëria që është me këmishë me vija blu dhe të zeza,
5 kush është ky zotëria?

6 PË. Jemi futur në një fushë të ndjeshme, z. Kryegjykatës. Unë
7 e di kush është ky zotëri, ai është një person me interes të
8 veçantë, ishte një person me interes të veçantë për ne. Por
9 nuk jam i sigurtë në qoftë se jam i përgatitur ose jam i
10 gatshëm që të tregoj se kush është ky person.

11 PY. Dëshmitar, dëshironi që të kalojmë në seancë private
12 mbase do ju ndihmonte që të na thoni se kush ishte ky person
13 në qoftë se kalojmë në seancë private?

14 PË. E dyshoj këtë gjë.

15 PY. Dje keni folur për Xhavit Halitin, Dëshmitar, apo jo? A ë
16 Xhavit Haliti ky person?

17 PË. Ky nuk është personi që mua më kanë thënë që ka qenë
18 Xhavit Haliti në Tiranë, në takimin në Tiranë.

19 PY. Personi me këtë bluzën me shirita të zinj e ngjyrë blu a
20 e dini në qoftë se ka qenë komandant zone?

21 PË. Ju lutem, a mund të kalojmë në seancë private që mbase
22 mund të shpjegoj diçka në seancë private?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
25 palë kundërshtime?

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 15

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] As ne nuk kemi kundërshtim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
3 në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 16

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
6 publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Mund të vazhdoni.

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 PY. Dëshmitar, pa dhënë hollësi të mëtejshme lidhur me
11 informacionin që na dhatë në seancë private, a mund të thuash
12 "po" apo "jo" nëse mund të thuash, nëse ke patur dijeni nëse
13 ky person ishte apo jo komandant zone?

14 PË. Jo, mesa më kujtohet.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Tani në pjesën e videos 04:06.

16 PY. Individidi që është në qendër të ekranit, a e dini se kush
17 është?

18 PË. Nuk e di emrin. Nuk ja di emrin, por e di se kush është.

19 Ju kërkoj ndjesë përkthyesëve. Nuk e di emrin e tij, por e di
20 se kush është.

21 PY. Kush është?

22 PË. Është, mesa më kujtohet mua, është një nga njerëzit me
23 funksione të larta në funksionin policor dhe të zbulimit.

24 PY. Si e dini një gjë të tillë?

25 PË. Nuk jua them dot.

1 PY. Nëse unë do të them që ky është Kadri Veseli, a ke ndonjë
2 arsye për ta kundërshtuar?

3 PË. Nuk kam arsye për ta kundërshtuar.

4 PY. Në këtë takim më datën 17 janë një numër njerëzish të
5 cilët ti i ke ditur që nuk ishin komandantë zone apo nuk ke
6 ditur se çfarë funksionesh kanë patur?

7 PË. Është tërësisht e mundur.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekranin.

9 PY. Dua të bëj një pyetje vijuese lidhur me një fotografi që
10 pala Mbrojtëse iu tregoi gjatë ditës së djeshme.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe të vendosim në ekran 1D385.

12 PY. Na treguat se kush ishte komandant zone nga këta persona
13 në këto fotografi dhe kush nuk ishte. Nga transkripti i ditës
14 së djeshme nuk ishte e qartë nëse personi që ndodhet në të
15 majtë fare ishte komandant zone, apo jo, sipas asaj që dini ju.
16 A mund të përgjigjesh kësaj pyetjeje?

17 PË. Në cilën të majtë e keni fjalën? Ju kërkoj ndjesë. E keni
18 fjalën në të majtë në fotografi apo siç rrimë?

19 PY. Faleminderit. E kam fjalën në të majtë të fotografisë.
20 Nga perspektiva jonë, pra, siç e shohim në fotografinë në
21 majtë.

22 PË. Ju kërkoj ndjesë. A mund t'ju shpjegoj se çfarë mendoj
23 unë si janë komandantët e zonave?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë të
25 kemi një problem teknik.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Përkthim] Mund të
3 vazhdoni. Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen. Mbase duhet ta
4 bëni edhe një herë pyetjen.

5 Z. HALLING: [Përkthim]

6 PY. Mund ta thjeshtëzohj pak. Dje thatë se njëri nga këta
7 persona në këtë fotografi ishte Remi. A mund të na tregosh se
8 cili është Remi sipas teje?

9 PË. Pra, në të djathtë në këtë fotografi personi i cili ka
10 triko sportive, është një komandant zone. Më kujtohet fytyra e
11 tij. Në të djathtën e tij është Remi, pastaj është personi i
12 tretë, nuk më kujtohet se kush është dhe është një tjetër
13 është komandant zone ngjitur me të, po emri i tij nuk më
14 kujtohet dhe ky është në të majtë të fotografisë.

15 PY. Dhe për këtë person po të pyesja pikërisht. Dëshmitar, a
16 e dini emrin Nuri Bexheti?

17 PË. Siç ua thashë, nuk më kujtohen emrat e këtyre
18 komandantëve të zonave pas 26 vitesh, këta janë emra shqiptar.

19 Mund të bëj një koment lidhur me pyetjet që po më bëni
20 pasi më hutojnë pak.

21 Ju po më pyesni nëse mund të identifikoj individë. Unë
22 nuk isha atje për të thënë "Ah, i kemi të gjithë komandantët e
23 zonave këtu". Çeku na kishte thënë se "Duhet të ishin të
24 pranishëm komandantët e zonave". Kaq më tha. Pra, unë kam
25 menduar se ai kishte sjellë të gjithë komandantët e zonave dhe

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 19

1 nëse nuk i kishte sjellë do të më thoshte se "Nuk është këtu
2 njëri prej komandantëve të zonave". Po nuk më duket sikur me
3 të drejtë ma bën mua këtë pyetje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të duhet
5 t'i jepni përgjigje pyetjeve siç bëhen.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një arsye
8 pse bëhen pyetjet.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Sa u përket emrave dhe për të freskuar kujtesën ekziston
12 një faqe, një libër për të cilat do të shohim nëse mund t'ju
13 freskoj kujtesën.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Të shkojmë në provën P64 në faqen
15 SPOE00128903.

16 PY. Dëshmitar, po ju shpjegoj se për çfarë bëhet fjalë, është
17 libri i një gazetari shqiptar, Nuhi Bytyqi i cili pretendon se
18 ka qenë në këto negociata të 19 qershorit 1999 dhe në një
19 pjesë të librit shënon emrat e këtyre personave. Po jua
20 paraqes këtë pjesë dhe t'ju lexoj emrat.

21 Po e filloj me pjesën ku thotë: "Takimi në Malet e
22 Berishës dhe dollia me Shtabin e Përgjithshëm në Divjakë".

23 Sa për të orientuar këtu thuhet:

24 "Më 19 qershor me Abazin kemi shkuar në malet e Berishës
25 në Fshat të Ri, ku vepronte një pjesë e Qeverisë së Përkohshme

1 të Kosovës. Kryeministri Hashim Thaçi kishte arritur me
2 helikopter nga Tirana bashkë me zëdhënësin e Departamentit
3 Amerikan të Shtetit James Rubin.”

4 Tani të kalojmë në faqen tjetër në SPOE00128904:

5 “Në selinë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në
6 Divjakë, Abazi dhe unë jemi përshëndetur ngrohtësisht me
7 drejtuesit kryesorë të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe
8 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë. Aty përveç Hashim Thaçit,
9 jemi takuar dhe me Jakup Krasniqin, anëtar i kabinetit
10 qeveritar, Gjeneralin Agim Çeku, i cili ishte shef i Shtabit
11 të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatmir
12 Limaj, zëvendësministri i mbrojtjes i Kosovës Xhavit Haliti,
13 një ndër themeluesit e UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të
14 Përgjithshëm të UÇK-së i emëruar shef i zyrës së Kosovës në
15 Tiranë, pastaj Rexhep Selimi, ministër i rendit, Kadri Veseli
16 shefi i shërbimit informativ të Kosovës, Ramë Buja ministër i
17 pushtetit lokal, Sylejman Selimi komandant i gardës së
18 Kosovës, Bislime Zyrapi, Sali Veseli, që ishin pjesëtarë të
19 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, komandantin e Zonës
20 Operative të Pashtrikut Tahir Sinani, komandanti i Zonës
21 Operative të Drenicës Sami Lushtaku, Haxhi Shala, Nuri
22 Bexheti, Ferhat Shala, Elmi Reçica, Mensur Kosumi, Dilaver
23 Goxhaj, Numan Balic dhe ushtarakë e qeveritarë të tjerë.”

24 Dëshmitar, vëreni se Ramush Haradinaj nuk është në këtë
25 listë, cilin nga emrat që janë në këtë listë, për cilin prej

1 këtyre emrave keni dijeni?

2 PË. Dhe një herë, po ma bëni të vështirë këtë punë. Pala
3 kosovare nuk e ka paraqitur veten, nuk kanë treguar se kush
4 ishin. Këta persona mund të kenë qenë aty apo jo. Unë s'kam
5 mënyrë se si ta di nëse ishin pjesë e delegacionit të Kosovës.

6 PY. Po ju keni thënë se i njihni shumë prej këtyre
7 individëve, apo jo? Hashim Thaçin e njihni apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Jakup Krasniqin?

10 PË. Po.

11 PY. Agim Çekun?

12 PË. Po.

13 PY. Ju përmendët që e keni dëgjuar emrin e Xhavit Halitit?

14 PË. Siç e diskutuam, ishte një person i cili më është
15 paraqitur me atë emër në atë takim në Tiranë.

16 PY. Mesa të kujtohet, a dini nëse këta persona emrat e të
17 cilëve u paraqitën në këtë faqe, ishin pjesë e negociatave më
18 datë 19 qershor?

19 PË. Siç e thashë, nuk e them dot, nuk e di se kush ishte apo
20 kush nuk ishte, nuk i di këto hollësi, pasi unë nuk jam
21 përqendruar të di se kush ka qenë i pranishëm. Personat kyç me
22 të cilët po diskutonim janë ata të cilët i keni përmendur ju,
23 të tjerët nuk janë paraqitur. Ata nuk e paraqitën secilin që
24 ishte ulur rreth tryezës, kështu që nuk e di se kush kanë qenë
25 këta persona. Nuk kam si ta di dhe nuk e di nëse kanë qenë.

1 Nuk kam sesi ta di një gjë të tillë.

2 PY. E kuptoj.

3 PY. Gjatë negociatave të 19 qershorit në një pikë të caktuar,
4 dhe këtë e diskutuam, ju i nxorët të gjithë njerëzit jashtë
5 dhomës, dhe mesa kuptoj unë, mbajtët për diskutim Hashim
6 Thaçin, Agim Çekun, Gjeneralin Reith, James Rubin dhe veten. A
7 ishit ju të gjithë?

8 PË. Po, kështu më kujtohet.

9 PY. Dhe këta janë personat që ju menduat se janë personat kyç
10 të UÇK-së?

11 PË. Këta janë personat të cilët kanë ndërhyrë në diskutimet e
12 19 qershorit. Këta ishin bashkëbiseduesit tanë kryesorë, ata
13 ndërhyjnë në datën 19 qershor.

14 PY. Me qëllim që të marr përgjigje ndaj pyetjes sime. Po e
15 përsëris këta janë personat që i keni konsideruar se ishin
16 lojtarët kyç?

17 PË. Unë po përpiqen të përgjigjem në mënyrën më të mirë.
18 Mënyra si e formuloni ju është e rëndësishme dhe unë ju
19 tregova alternativën dhe alternativa është përgjigja që kam
20 unë.

21 PY. Atëherë të kalojmë në paragrafin 51 të këtij dokumenti.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Më thonë që ka një gabim përkthimi
23 në shqip kur thuhet që Agim Çeku ishte shefi i Shtabit të
24 Përgjithshëm të UÇK-së dhe jo dikush që ka qenë anëtar i
25 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 23

1 Z. HALLING: [Përkthim] Dakord.

2 Tani të kalojmë në dokumentin me numër DHT11893 deri në
3 DHT11909.

4 PY. Dhe ju thatë që fjalët kanë rëndësi dhe duhet të shohim
5 sesi e keni formuluar në deklaratën tuaj, Dëshmitar?

6 PË. Dakord.

7 PY. Në fillim thatë:

8 "Në një pikë të caktuar m'u desh ta ndaloja diskutimin
9 kryesor për të mbajtur një takim privat me lojtarët kryesorë
10 në të cilin unë paraqita rëndësinë politike të marrëveshjes që
11 ishte si një hap kyç në drejtim të një Kosove të pavarur."

12 PË. Dhe me "lojtar kyç" unë kisha fjalën për njerëzit e ish-in
13 më aktivë dhe të cilët kishin marrë pjesë në diskutime me ne.
14 Këtë kisha parasysh.

15 PY. Dhe nga dëshmia e juaj gjatë ditës së djeshme,
16 komandantët e zonave nuk ishin pjesë e këtij diskutimi?

17 PË. A mund të jeni më i qartë? Më 17 apo në 19?

18 PY. Në takimin e datës 19 qershor që po mbanit me këtë grup
19 të vogël, pra, kur i nxorët të tjerët, komandantët e zonave
20 nuk ishin aty apo jo?

21 PË. Jo, nuk ishin.

22 Z. HALLING: [Përkthim] T'i kthehem dhe një herë videos,
23 1D287 dhe të ndalojmë në pikën 00:39 sekonda.

24 PY. Dëshmitar, në dëshminë e ditës së djeshme thatë që këto
25 pamje ishin nga 19 qershori dhe jo nga 17 qershori,

1 pavarësisht se aty shënohet që është 17 qershori dhe Hashim
2 Thaçi nuk duket në këtë pjesë të filmimit. Por ju thatë që kjo
3 ishte biseda pas asaj bisedës që keni patur me personat kyç të
4 kësaj negociate.

5 Pyetja ime e parë është: Nëse këtu bëhet fjalë për datën
6 19 qershor, ti je duke veshur të njëjtat rroba këtu si ato që
7 kishe më datën 17 qershor. A mund të shpjegosh se përse janë
8 të njëjta këto rroba?

9 PË. Këto rroba kam veshur për negociata, nuk isha në shtëpi.

10 PY. Po këto nuk janë të njëjtat rroba pasi kishit një kollare
11 të kuqe gjatë nënshkrimit.

12 PË. Dhe arsyeja është se isha kthyer tani rolit tim si një
13 këshilltar politik dhe një jo anëtar i delegacionit ushtarak,
14 ishte një sinjal optik.

15 PY. Unë e kuptoj që ka njerëz në këtë pjesë të videos të
16 cilët kanë veshur uniforma, po të përqendrohemi te një person
17 tjetër i cili ka rroba civile.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të kalojmë edhe një herë në pikën
19 04:23 të kësaj video. Për t'u përqendruar dhe një herë tek
20 personi i cili më 17 qershor ka veshur këtë bluzë me blu dhe
21 të zeza. Tani të kalojmë në pikën 06:25 të kësaj video.

22 PY. Dëshmitar, i njëjti individ është në mes të ekranit me të
23 njëjtën triko?

24 PË. Po.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në minutën e

1 tretë.

2 PY. Dëshmitar, i njëjti individ ka të njëjtën triko që
3 ju thoni më datën 19. Në tre këto filmime të gjithë personat
4 ishin veshur me të njëjtat rroba. A mund të shpjegoni se të
5 gjithë po dërgonin sinjale optike?

6 PË. Jo. Të jemi të ndërgjegjshëm këtu. Jemi këtu në një zonë
7 lufte, nuk marrim valixhe me vete me rroba. Siç ju përmenda më
8 herët, ajo që ndjehej ishte nuhatja e luftës, kishin ndjesinë
9 e nuhatjes së luftës. Nuk ishim këtu në hotele me katër yje.
10 Ne ishim sigurisht në një zonë lufte. Ka njerëz të cilët kanë
11 veshur të njëjtat rroba gjatë gjithë kohës. Po kështu edhe unë
12 kam bërë të njëjtën gjë. Nuk shoh se ç'problem ka këtu që
13 njerëzit të veshin të njëjtat rroba për ditë me radhë. Dhe në
14 fakt kishte ekzistuar dhe mundësia për t'i larë rrobat më
15 datën 18, mes këtyre dy ditëve të diskutimit. Nuk shoh sesi
16 kjo mund të jetë me rëndësi të veçantë, fotografitë janë paksa
17 çoroditëse pasi janë edituar apo redaktuar në mënyrë të
18 çuditshme dhe datat jo domosdoshmërisht tregojnë atë që po
19 shihni.

20 PY. Dëshmitar, gjatë seancës përgatitore juve iu treguan një
21 pjesë të mëvonshme të kësaj videoje.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të shkojmë në minutën 09:07. Le ta
23 lozim këtë video për pak. Ndaloni.

24 PY. Dëshmitar, a të kujtohet të kesh parë gjatë seancës
25 përgatitore?

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 26

1 PË. Po.

2 PY. Dhe kush ky?

3 PË. Ky është James Rubin.

4 PY. Ju thatë në seancën përgatitore se data është e saktë?

5 PË. Po.

6 PY. Faleminderit.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta heqim videon.

8 PY. Tani të përqendrohemi tek vetë bisedimet e 19 qershorit.

9 Në dëshminë e ditës së djeshme, në faqen 56 të transkriptit të
10 ditës së djeshme, thatë që negociatat vazhduan gjatë gjithë
11 ditës dhe ishin të hollësishme.

12 PË. Negociatat zgjatën 13 orë pa ndërprerje pothuajse.

13 PY. Duhet të ndalohemi për një çast tek vendi i firmave.

14 PË. Dakord.

15 PY. Tani të kalojmë në deklaratën tuaj në paragrafin 56 dhe
16 58. Lidhur me mënyrën sesi u zhvillua diskutimi lidhur me
17 firmat.

18 Dëshmitar, a e kam kuptuar si duhet se në paragrafin 57
19 tregohet se si ishin firmat më datën 18 qershor dhe në 58 siç
20 ishin më 19?

21 PË. Është ashtu siç do të ishte dukur të dukej, duhur të
22 dukej.

23 PY. Pra, Agim Çeku, pra, aty shikohet, për shembull, që
24 komandanti i përgjithshëm nuk është në pjesën e Agim Çekut.

25 Aty ajo vendoset kur Hashim Thaçi -- kur ndryshohet emri i

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 27

1 Hashim Thaçit?

2 PË. Korrekt.

3 PY. Pra, këto versione që janë këtu, këto dokumente a ia
4 treguat palës Mbrojtëse të Thaçit?

5 PË. S'e kuptoj.

6 PY. Këto drafte të bllokut të firmave, a janë diçka që ia
7 keni treguar palës mbrojtëse?

8 PË. Jo, unë e dija se çfarë thuhej aty. Versioni përfundimtar
9 thotë ofruar nga Hashim Thaçi, komandanti i përgjithshëm e
10 kështu me radhë, kështu thuhet në marrëveshjen e nënshkruar që
11 e kemi parasysh. Unë e thashë që mënyra sesi do të ishte dukur
12 kjo më datën 18 qershor, ishte që emrat u ndryshuan dhe
13 përshkrimi në fund është si më poshtë, pra, do të ishte dukur
14 në këtë mënyrë.

15 Unë nuk mendoj që ka patur evoluim sipas dokumenteve. Dhe
16 fatkeqësisht personi i cili ishte sekretari në atë moment,
17 kapiteni Tovell, vrau veten para dhjetë vitesh. Pra, nuk ka
18 njeri që ta kujtojë këtë përveç John Reith.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është një
20 pjesë e çuditshme e dëshmisë dhe për këtë mënyrë ne mendojmë
21 që ka vlerë vizuale dhe duam të pranohet si fotografi dhe
22 prandaj do të kërkonim që paragrafi 57 dhe 58 të fotografohen
23 dhe të paraqiten si provë materiale e Prokurorisë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
25 kundërshtim.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po kemi kundërshtim. Prisni një
2 çast ju lutem.

3 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po Prokuroria ka thënë që nuk
5 mund të pranohen dëshmitë e dëshmitarëve gjatë pyetjeve që
6 bënë pala kundërshtare dhe këtë po bëjnë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Ne thjesht po kërkojmë të pranohet
8 fotografia.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është e njëjta gjë. Janë dy
10 paragrafë të dëshmisë së një dëshmitari. Është dëshmi e një
11 dëshmitari. Mënyra se si po e formuloni nuk është e ndershme.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, znj. Tavakoli, në
13 qoftë se Prokuroria do ta shkruante nga e para këtë deklaratë
14 dhe t'ia jepte dëshmitarit, do të ishte kjo e pranueshme?

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Prokuroria nuk mund të jetë
16 këtu dëshmitare.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë nuk thashë që do të
18 jap dëshmi. Unë them që në qoftë se do ta rishkruajnë këtë dhe
19 t'ia tregojnë dëshmitarit, do ishte e pranueshme?

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do të ishte njësoj si të jepnim
21 dëshmi, pasi ata nuk e kanë këtë informacion. Ky ishte
22 informacion i cili vjen nga dëshmia e z. Duncan dhe nga
23 deklarata që ai ka dhënë.

24 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 29

1 Sekretare, fotografojini këtë pjesë dhe ta shënojmë për
2 identifikim.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
4 këtë numrin P4493, shënuar për identifikim.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim nga
6 ekranin.

7 PY. Tani të përqendrohemi në datën 20 qershor 1999, që është
8 edhe pjesa e fundit e negociatave për këtë marrëveshje
9 angazhuese. Dje folët për diskutimet e fundit që keni patur me
10 Hashim Thaçin dhe Agim Çekun. Agim Çeku dhe Jakup Krasniqi
11 ishin atje në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, apo jo
12 PË. Agim Çeku sigurisht ishte aty. Ndoshta edhe Krasniqi.
13 Mendoj se është, po nuk më kujtohet saktësisht.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në fund të videos që u luajt dje,
15 P2519 është kjo videoja. Dhe mendoj që është ndaluar në pikën
16 01:09 në kohën kur e luajtëm gjatë ditës së djeshme. Ta
17 shikojmë edhe një herë. Pra, 01:09 është momenti kohor.

18 [Luhet videoincizimi]

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, aty është.

20 Z. HALLING: [Përkthim]

21 PY. Dhe kur thoni është atje tani sa për konfirmim edhe Agim
22 Çeku edhe Jakup Krasniqi?

23 PË. Po. Është edhe një gjeneral britanik, emri i të cilit nuk
24 më kujtohet tashmë, por e njoh.

25 PY. Dhe nga dëshmia e ditës së djeshme që dhatë ju, vendimi

1 për se kush do të firmoste nga UÇK-ja u mor më datën 19

2 qershor?

3 PË. A mund të tregoni se kur "u dakordëzua" për çfarë e keni
4 fjalën?

5 PY. Pra, më datën -- ky ishte dokumenti që shënuam për
6 identifikim, kjo ishte e fundit, pra, gjuha përfundimtare e
7 firmave?

8 PË. Ky ishte drafti përfundimtar që iu dërgua NATO-s.

9 PY. Dhe më datën 20 u diskutua çështja e se kush do të
10 firmoste nga NATO, kështu është?

11 PË. Po.

12 PY. Tani është edhe një video tjetër që dua të lozim përpara
13 se të marrim pushimin.

14 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
15 056563B Pjesa 7. Dhe ju lutem ta vendosim në ekran bashkë me
16 transkriptin që është P742.7-ET. Dhe videon ta lozim nga
17 momenti 01:12 sekonda deri në 02:54 dhe transkripti që duhet
18 treguar ndodhet në faqen 1, rreshti 20 deri në faqen 2,
19 rreshti 8.

20 PY. Dëshmitar, po shpjegoj për momentin. Hashim Thaçi i ka
21 dhënë një intervistë ZPS-së dhe ka shpjeguar se ç'ndodhi
22 menjëherë para nënshkrimit të marrëveshjes së çarmatosjes. Dhe
23 mund të shihni në të majtë që do të fillojnë në rreshtin 20
24 dhe aty do të dëgjoni. Edhe fjalët dhe do ta dëgjoni tani
25 dëshmitar kjo do të luhet kjo pjesë.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të tregojmë këtë
2 pasi video është konfidenciale?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk duam që ta shfaqim këtë
4 jashtë, por nuk ka problem që ta lozim në seancë publike.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "PY. Unë dua që të vazhdoj tani me një dokument tjetër.

7 "PË. Para sesa të shkojmë tek dokumenti tjetër dëshiroj
8 të sqaroj përfundimisht diçka.

9 "PY. Ju lutemi, vazhdoni.

10 "PË. Dokumenti që ma prezantove më herët ka qenë i
11 përgatitur për t'u nënshkruar nga Agim Çeku. Ka qenë i
12 diskutuar më herët dhe mendoj se dhe ai mund ta sqaron këtë
13 rrethanë. Pse është larguar nga momenti i fundit nga
14 nënshkrimi.

15 "PY. Që të jemi të qartë, a po i referoheni provës
16 materiale numër 18 që është Marrëveshja e Demilitarizimit?

17 "PË. Po. Dhe prandaj në momentet e fundit është ndërruar
18 emri që është zëvendësuar me timin nga dokumenti dhe ka mbetur
19 kështu. Pastaj, por nuk është zëvendësuar komandanti, nuk
20 është ndërruar. Ka qenë rrëmuje dhe gjithçka është bërë shpejt
21 e shpejt. Ka qenë dëshmitar edhe këshilltari i Sekretares
22 Albright, James Rubin ..."

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 PY. Vazhdon, por unë do ndaloj në këtë pikë. Dëshmitar, pashë
25 që po qeshnit në një moment. Hashim Thaçi tha që Agim Çeku u

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 32

1 largua përpara se të nënshkruhej marrëveshja. Kjo s'është e
2 saktë, apo jo?

3 PË. Jo.

4 PY. Dhe ai tha që emri i tij u ndryshua me emrin e Agim Çekut
5 në momentin e fundit. A ndodhi vërtetë kështu në 19 qershor?

6 PË. Po.

7 PY. Hashim Thaçi tha që emri i tij u ndryshua me të Agim
8 Çekut dhe nuk u ndryshua titulli, ngeli titulli kryekomandant.
9 Nuk ka ndodhur kështu, apo jo?

10 PË. Po, nuk ka ndodhur kështu.

11 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, tani mund të
12 bëjmë pushimin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Përpara se të bëjmë
16 pushimin, a mund të bëjmë një korrigjim ju lutem? Numrave të
17 deklaratës që pamë së fundmi, numrat që duhet të kishin dalë
18 janë P4494.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] faleminderit.

20 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.04

22 --- Seanca rifillon në orën 10.04

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
24 sillni dëshmitarin në sallë.

25 Dhe sa kohë do ju duhet, z. Halling?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Shpresoj të përfundoj brenda orës
2 11.00. Nëse do përfundoj më vonë, e sigurt është që do
3 përfundoj gjysmë orarëshin pas pushimit.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
6 z. Halling, fjala është për ju.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

8 PY. Dhe mirëmëngjesi sërish. Dëshmitar, tani kam disa pyetje
9 për atë që unë do ta quaj struktura ushtarake. Si pikënisje,
10 ka pas mosmarrëveshje -- në çdo ushtri ka normalisht
11 mosmarrëveshje, e pranoni këtë?

12 PË. Tensione, do të thoja, po.

13 PY. Dua të shohim disa nga pjesët e deklaratës suaj.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Fillimisht, shikojmë paragrafin 52
15 të deklaratës suaj, që është faqja DHT11903.

16 PY. Dëshmitar, këtu flisni për marrëveshjen angazhuese, dhe
17 keni bërë një vlerësim, mund të shikoni fjalinë në krye:

18 "Kjo nuk thoni -- ju thoni është një organizim hierarkik,
19 ku të ishte e padysgueshme udhëheqja".

20 Apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Shikojmë paragrafin 72. Këtu thoni, këtu flisni për
23 Hashim Thaçin dhe Agim Çekun.

24 PË. Po.

25 PY. Ju thoni:

1 "Në të gjitha marrëdhëniet me ta, nuk konstatova që të
2 kishte mes tyre marrëdhënie të fortë shqiptare, mes z. Thaçi
3 dhe Gjeneralit Çeku".

4 Kështu e keni thënë ju, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dje thatë që nuk keni parë shumë dallime mes Agim Çekut
7 dhe Hashim Thaçit, dhe po ashtu komentuat dhe lidhur me
8 vlerësimi e Gjeneralit Jackson kur tha se Thaçi ishte shefi i
9 Çekut.

10 PË. Po.

11 PY. Tani do ju tregoj një intervistë që ka dhënë Agim Çeku që
12 është publikuar nga Instituti për Luftë e për Paqe.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Shikojmë atëherë materialin
14 SPOE0040358 deri në 00403544. Më falni, doja të thoja
15 SPOE00403538.

16 PY. Dëshmitar, ky është fillimi i artikullit. Shikoni datën,
17 për kontekst, 27 maj 1999.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Dua të shikojmë faqen SPOE00403542
19 për të parë çfarë ka thënë Agim Çeku në fund të intervistës së
20 tij.

21 PY. Ai thotë si në vijim:

22 "Kur e pyetën çfarë mendon se do të ndodhë në Kosovë pasi
23 të përfundojë lufta, nëse do të jetë e pavarur apo rajon i
24 pavarur i Serbisë, ai u përgjigj: 'Unë jam një ushtar, detyra
25 ime është të kujdesem për ushtrinë, situatën në fushëbetejë

1 dhe që lufta të përfundojë me sukses'. Ai premtoi se do të
2 luftojë derisa forcat luajale, besnike, të Sllobodan
3 Millosheviqit të dëboheshin nga Kosova dhe t'ia linte
4 politikën 'qeverisë që drejtonte Hashim Thaçi.'"

5 Dëshmitar, e dini ju, pra, që Agim Çeku ka thënë që është
6 pjesë e një qeverie që drejtohej nga Hashim Thaçi?

7 PË. Jo, nuk thotë kështu këtu.

8 PY. A e dini ju se ai ka thënë se:

9 "Do të luftonte derisa ta dëbonte forcat e Sllobodan
10 Millosheviqit nga Kosova dhe do t'ia linte politikën 'qeverisë
11 që udhëhiqte Hashim Thaçi'?"

12 PË. Po, këtë thotë, por nuk thotë që: Jam pjesë e qeverisë.

13 Mbase nuk e kuptova unë mirë pyetjen tuaj. Ju kërkoj ndjesë
14 për këtë, por në fjali këtu thuhet -- dy fjali: "Unë jam
15 ushtar profesionist, kam një rol tjetër, dhe politikën ja lë
16 qeverisë sonë që drejtohet nga Hashim Thaçi". Dhe kjo
17 përputhet dhe me atë që kam thënë unë në dëshminë time që ju e
18 patë në ekran, kur unë thashë që ata punonin si ekip së
19 bashku, e thoshte: Unë do bëj punën time, ti do bësh punën
20 tënde. Pra, Agim Çeku ka folur për aspektin ushtarak, ndërsa
21 z. Thaçi ka mbuluar aspektin politik. Kështu ka qenë dinamika.

22 Besoj se u përgjigja.

23 PY. Në fakt ju interpretuat, në fakt, dëshminë time. Ju po
24 thoni, kështu ka thënë, por unë po ju pyes a e dini ju që e ka
25 thënë këtë Agim Çeku në maj të 1999?

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 36

1 PË. Jo.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të shohim një 1D99, edhe
3 do fillojmë në faqen SITF00172766.

4 PY. Dëshmitar, kjo është një deklaratë e Kolonelit Gjeneral
5 Çeku, shef shtabi i UÇK-së, në shtator 1999, pas përfundimit
6 të marrëveshjes së demilitarizimit. E keni parë asokohe këtë
7 letër?

8 PË. Jo, nuk besoj se e kam parë këtë shkresë. Për cilën
9 periudhë kohore po flisni?

10 PY. Ai këtu flet për Marrëveshjen e Demilitarizimit, thotë:
11 "Që nga mesnata e 20 shtatorit 1999, do të përfundojmë,
12 nuk do të mbajmë më veshur uniformat me emblemën e UÇK-së..."

13 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

14 PY. E shihni këtë, që është kabllogram i 20 shtatorit [Sipas
15 përkthimit] 1999?

16 PË. Nuk jam i sigurt. 21 shtator, nuk më thotë asgjë kjo
17 deklaratë. Por s'është për t'u habitur.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Data, në fakt, në faqen
19 tjetër është poshtë nënshkrimit.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po. Duhet të shkojmë në fund
21 të faqes tjetër.

22 PY. Këtu mund ta shihni, është me shkrim dore. Aty e shikoni
23 datën që thotë 20 shtator 1999.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Por në faqen pararendëse, shkojmë
25 në fund. Këtu s'ka datë por është pjesë e të njëjtit dokument,

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 37

1 dhe është një deklaratë e Hashim Thaçit për të njëjtin rast,
2 kryekomandant UÇK.

3 Pra, Agim Çeku dhe Hashim Thaçi sipas deklaratave, sipas
4 kësaj që shohim ne këtu, ka vendosur të njëjtin titull që kemi
5 parë edhe te marrëveshja, apo jo?

6 PË. Po.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Shikojmë dhe një herë nënshkrimin
8 e marrëveshjes angazhuese atëherë. Blovakun e nënshkrimeve.
9 Provën materiale P1444, ju lutem vendosni dhe shqipen në ekran
10 për të parë çfarë është thënë në shqip te pjesa e
11 nënshkrimeve. Është faqja 078204, 078204-AT. Vendosini, ju
12 lutem, të dy dokumenteve përbri njëri-tjetrit në ekran.

13 PY. Dëshmitar, ne e diskutuam gjerë e gjatë këtë faqe, por
14 dua t'ju tregoj si është përkthyer "komandant i përgjithshëm",
15 është në shqip, e shihni këtë?

16 PË. Po.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, dua të shohim provën P3916,
18 faqen SPOE00228173.

19 PY. Dëshmitar, për kontekst ky është një pjesë e materialeve
20 që janë gjetur në shtëpinë e z. Jakup Krasniqi. Si mund ta
21 shihni në organigramën përballë, do të shihni që ka "komandant
22 të përgjithshëm" në të djathtë. E shihni? "Shtabi i
23 Përgjithshëm", dhe shikoni shtatë zonat operative në të majtë.
24 A i shihni në organigramë?

25 PË. Po.

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 38

1 PY. Në shqip mund të shihni që "komandanti i përgjithshëm",
2 në shqip është e njëjta gjë, "komandanti i përgjithshëm",
3 *General Commander*. A keni parë ndonjë organigramë të ngjashme
4 të UÇK-së më përpara?

5 PË. Jo.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Shikojmë --

7 DËSHMITARI: Do më lejoni të bëj një koment, ju lutem, z.
8 Kryegjykatës?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

10 DËSHMITARI: Se nuk tha diçka tek pjesa e nënshkrimeve. Ku
11 thuhej qartë, që gjuha anglishte e marrëveshjes është gjuha
12 mbizotëruese, ka precedent. Kështu që nuk keni pse të
13 diskutojmë ne çfarë është thënë në shqip, apo tjetër kuptim i
14 shqipes. Është negociuar përmes përkthimit marrëveshja,
15 sigurisht, por është bërë e qartë tek marrëveshja që meqë
16 marrëveshja është negociuar në anglisht, anglishtja do të jetë
17 gjuha që ka precedencë, që është gjuha mbizotëruese. E thashë
18 këtë për t'ju ndihmuar mbase, për sqarim. Që anglishtja është
19 gjuha që do të ketë vlerë në këtë rast.

20 PY. Në rregull, Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim provën materiale P880.

22 Faqja e parë është në shqip, dhe -- më falni, e thashë gabim.

23 Faqja e parë është në anglisht dhe faqja e dytë është në

24 shqip.

25 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta shihni këtu, data është 10

1 gusht 1999. Është kërkesë për mbajtje armësh, ka një listë
2 emrash këtu. Shkojmë në fund për të parë pjesën e nënshkrimit
3 dhe këtu është një vulë e UÇK-së edhe thotë: "Komandanti i
4 përgjithshëm i UÇK-së, Hashim Thaçi", në të djathtë. Edhe në
5 të majtë, po "Komandant i përgjithshëm", në shqip.

6 PË. Çfarë date ka ky dokument?

7 PY. 10 gusht 1999.

8 PË. [Folës që flasin njëkohësisht].

9 PY. Po pyetja ime është kjo, a e dini ju që Hashim Thaçi e ka
10 përdorur këtë titull dhe në dokumente të tjera?

11 PË. Jo, dhe nuk kishte pse ta përdorte, në fakt. Më kujtohet
12 kjo problematikë. Është gusht, sikurse e pamë, ku pavarësisht
13 marrëveshjes, është bërë kërkesë nga disa anëtarë të vazhdonin
14 të mbanin armë, dhe Gjenerali Jackson apo personeli i tij
15 duhet ta kishin vënë re në fakt që kërkesa nuk duhet të kishte
16 ardhur nga Hashim Thaçi, por nga Gjeneral Çeku. Se kjo është
17 bërë shumë e qartë në marrëveshje si duhet të funksiononte
18 marrëdhënia, hierarkia.

19 Është dokument shumë interesant ky, por kjo është një
20 orvatje për t'i dhënë Hashim Thaçit një rol në marrëveshjen e
21 demilitarizimit të UÇK-së, nuk duhet të ishte lejuar asokohe.
22 E mbaj mend që ka dalë si problem asokohe.

23 PY. Pra, ju këtë kërkesë nuk e kishit parë ndonjëherë më
24 përpara.

25 PË. Këtë kërkesë, në këtë version, jo. Më ka informuar KFOR-i

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 40

1 që ka ardhur një kërkesë e ngjashme, dhe diskutimi i vetëm ka
2 qenë a ta lejojmë apo jo.

3 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, të gjithë
4 dokumentet që kemi parë lidhen me besueshmërinë e deklaratave
5 të dëshmitarit sa i takon Hashim Thaçit dhe Agim Çekut. Nuk
6 janë pranuar të gjitha materialet. Për shembull, intervista
7 IWPR, që është me numër SPOE00403538, është një deklaratë që
8 do të doni që të pranohej, si dhe përkthimi në gjuhën shqipe
9 të pjesës së nënshkrimeve, pra bllokut të nënshkrimeve, që
10 mban numrin 078204 deri në 078204-AT. Edhe nëse pranohet do të
11 donim që t'i bashkëngjitej provës materiale P1444.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund të bëj një koment?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Më falni një çast, sepse ka një
14 procedurë tjetër që duhet ndjekur.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do pranojmë
17 atëherë SPOE00403538 deri në 00403544 dhe blloku i
18 nënshkrimeve numër 078204. Keni gjë tjetër për të shtuar?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti SPOE00403538
21 deri në 00403544, do të marrë numrin e provës P4495, dhe
22 klasifikimi është konfidencial.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik. Në
24 fakt, të dy materialet mund të jenë publike.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ndërsa dokumenti

1 078204, 078204-AT, do të marrë numrin e provës P01444_ET.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

3 Riklasifikojeni si publike. Vazhdoni.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Që të sqaroj diçka me Sekretaren,
5 thuhet se do të marrë numrin e provës P01444_AT, po flas për
6 shqipen, duhet pranuar shqipja.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë
8 atëherë. Duhet të jetë me prapashtesën AT, jo ET.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Dëshmitar, unë kaq pyetje kisha lidhur me këtë. Por ju
11 thatë që kishit për të thënë diçka, dhe dua t'ju jap mundësinë
12 përpara se të vazhdoj me pyetjet e tjera.

13 PË. Kur shfaqët deklaratën time pak më herët, kaluat një
14 pjesë të deklaratës ku kam thënë që ai nuk kishte profilin e
15 një burri të fortë shqiptar. Që prej 1992-shit, unë kam takuar
16 plot burra shqiptarë, të egër, të fortë. I kam takuar në
17 Shqipëri, në Bosnjë, edhe e njihja shumë mirë profilin e
18 këtyre personave. Prandaj e kam thënë këtë gjë aty, që nuk të
19 jepte përshtypjen se kishte këtë profil. Unë i njihja këto
20 karaktere, kisha punuar me ta, kisha biseduar me ta, kisha
21 negociuar me ta. Ndërsa ai nuk ishte pjesë e këtij profili,
22 nuk e kishte këtë profil. Dhe doja ta sqaroja këtë.

23 PY. E kuptoj. Dua tani të flasim për zbatimin e marrëveshjes
24 angazhuese. Dje në dëshminë tuaj thatë që ka pasur dhunë për
25 shkak të shpagimit, dhe kanë qenë akte dhune individuale. Ju

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 42

1 kujtohet kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Si fillim, a po thoni në dëshminë tuaj se të gjitha aktet
4 e dhunës kanë qenë akte dhune rastësore në këtë kohë në
5 Kosovë?

6 PË. Ne nuk kemi pasur dëshmi se ka qenë dhunë e organizuar.
7 Besoj se jua dhashë përgjigjen me këtë.

8 PY. Dëshmitar, deri në momentin e mbërritjes së UNMIK-ut,
9 ishte KFOR-i që e kishte këtë përgjegjësi si, ushtronte
10 funksionet e policisë, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe vetë marrëveshja kishte parashikuar se si KFOR-i mund
13 të trajtonte rastet kur UÇK-ja nuk respektonte marrëveshjen.

14 PË. Po.

15 PY. Dhe marrëveshja ishte trajtuar pikërisht në mënyrë të
16 tillë, ishte rregulluar që drejtuesit e lartë të UÇK-së duhet
17 të informoheshin në rast se kishte shkelje të marrëveshjes?

18 PË. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, po.

19 PY. Jo, do flasim edhe për këto për një çast.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Por dua të shikojmë pak
21 marrëveshjen për t'ju treguar se ku e kam fjalën. Do të doja
22 të shikonim -- paragrafin 16 të marrëveshjes.

23 PY. Besoj se e thatë dhe dje, por COMKFOR-i ishte përgjegjës
24 në rast se do kishte mosrespektim të marrëveshjes, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe ky ishte Gjenerali Jackson, apo jo? Pra ju e shikoni
2 këtu që:

3 "Autoriteti për të trajtuar shkeljet e marrëveshjes është
4 i KFOR-it."

5 PË. Po.

6 PY. Në dëshminë tuaj dje thatë që Gjenerali Jackson nuk e
7 dinte çfarë ndodhte në bjeshkë. Por, ju keni folur vetëm
8 lidhur me marrëveshjen dhe atë që duhet të trajtonte ai.

9 PË. Jo, me hollësi ai nuk e dinte se çfarë po bënin dhe duhej
10 vepruar. Më lejoni t'jua jap dhe kontekstin. Kur shkova në
11 ambientin ku qëndronte ai, më datën 12 -- më falni, para se të
12 mbërrija, më falni, në 13, ishim në mes të problemit me, ne
13 kishim problemin e trupave ruse në Prishtinë, ai kishte parë -
14 - ose, ta them ndryshe, i kisha treguar projekt marrëveshjen,
15 por ai po përpiqej asokohe të dislokonte forcat, të
16 komunikonte me Gjeneralin Jackson se çfarë do bënim me
17 problemin e rusëve. Dhe unë i thashë, "a e ke lexuar
18 marrëveshjen që të kam çuar?" tani kini parasysh në çfarë
19 situate ishte ai.

20 Më pas i thamë se çfarë, deri në ç'fazë kishim arritur
21 pas dy takimeve të para. E informuam ose më saktë i kërkuam të
22 fliste me De Melon, që ai e bëri në fakt, edhe i dhamë
23 projekt-marrëveshjen që duhej nënshkruar.

24 Por gjatë gjithë kësaj kohe, ai ka qenë jashtëzakonisht i
25 përfshirë në situata komplekse, të ndërlikuara. Pra, duhet ta

1 keni parasysh që ai nuk kishte parasysh çfarë bënte John
2 Duncan dhe John Reith në male, në bjeshkë, në këtë situatë.
3 Edhe ai, ai s'e kishte kuptuar fare çfarë po ndodhte sepse
4 ishte krejt e natyrshme që ishte fokusuar diku tjetër, edhe
5 vetëm pas shumë vitesh, kur po pinim një gotë uiski të dy, ne
6 biseduam, ai më tha: "Unë s'e kam kuptuar punën që po bënit
7 ju. Ju më thonit të bëja disa punë, unë i bëja, por unë nuk e
8 kisha panoramën e qartë se si po funksiononin gjërat", dhe
9 ishte krejt e kuptueshme për shkak të situatës, këtë kam
10 dashur të them.

11 PY. Faleminderit. Tani të shohim se si ka qenë përbërja e
12 komitetit të përbashkët për zbatimin e marrëveshjes.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim paragrafin 21 të
14 marrëveshjes, ju lutem, që mban numrin 078202. Shikojmë më
15 poshtë në tekst.

16 PY. Në paragrafin 20 thuhet që:

17 "Komisioni do drejtohet nga KFOR-i dhe përbëhet nga
18 komandantë të lartë të KFOR-it dhe të UÇK-së, dhe një
19 përfaqësues nga administrata e përkohshme civile në Kosovë."

20 Dhe pjesë e përgjegjësisë të këtij komisioni, shikojmë më
21 poshtë tek 21, thotë që:

22 "Mund të thërritet pa njoftim paraprak dhe pritet
23 përfaqësim nga UÇK-ja në nivel të përshtatshëm, do të jetë
24 kryetari i KFOR-it. Në funksione përfshihet:

25 "... hetimi i cenimeve konkrete, apo të mundshme të kësaj

1 marrëveshjeje." Pika b.

2 Pra, kështu, këto ishin detyrat e komisionit të kësaj
3 marrëveshjeje, apo jo? A e pranoni që Gjenerali Jackson për
4 shkak të rolit të tij është personi më i duhur për të
5 konstatuar dhe për të paraqitur shqetësimet lidhur me
6 mosrespektimin e marrëveshjes nga ana e UÇK-së?

7 PË. Personeli i tij. Po sikurse e pamë dje, ai kishte ekipe
8 apostafat për hetimet, të cilët raportonin rregullisht dhe
9 bënin hetime të rregullta. Pra, kishte mjetet për ta kuptuar
10 çfarë po ndodhte nëse do të kishte raste të shkeljes së
11 marrëveshjes.

12 Kemi pasur dhe persona, nuk më kujtohet konkretisht kur,
13 por kemi pasur persona jo të -- të dislokuar, të dislokuar në
14 pikat e grumbullimit për të komunikuar me UÇK-në. Pra ai
15 kishte disa mjete për të konstatuar nëse do të kishte
16 mosrespektim të marrëveshjes.

17 PY. Nuk është se keni qenë përgjegjës -- [Mikrofoni
18 çaktivizuar].

19 [Nuk ka përkthim]

20 PË. -- të ndryshme dhe mendoj që në të tregohen se cilat kanë
21 qenë disa prej incidenteve. Kështu që, aty e kam parë për
22 shembull gjëra të ngjashme me atë çfarë ka parë ai. Si pjesë e
23 mbledhjes së zakonshme të informacionit.

24 PY. Por, a e pranoni ju që këto ishin çështje për të cilat
25 ishte përgjegjës Gjenerali Jackson, apo jo, dhe ju thjesht i

1 shikonit?

2 PË. Po, patjetër. Unë kisha të tjera shqetësime ose të tjera
3 probleme, ndërkohë që përgjegjësia kryesore për këtë ishte e
4 Gjeneralit Jackson.

5 PY. Gjenerali Jackson ka dhënë në dëshminë e vet që ka pasur
6 biseda të gjera dhe ka pasur probleme me Hashim Thaçin dhe me
7 komandantë zone për sa i takon qendrave të ndalimit. Keni
8 dijeni ju lidhur me këtë, Dëshmitar?

9 PË. Jo, nuk di gjë lidhur me këtë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të shikojmë një dokument
11 që është prova P2523, që është SPOE00000057.

12 E morëm parasysh komentin e përkthyesve.

13 PY. Dëshmitar, besoj që e shikoni këtu në fillim fare, që
14 thuhet "Gjenerali Mike Jackson", është data e dokumentit 19
15 qershor [Sipas përkthimit] 1999. Ndërkohë titulli është
16 "Incident në Ponosevac - e diel 18 korrik 1999". Thuhet që:

17 "Në orën 7.25 më datën 18 korrik 1999, që është ditë e
18 diel, duket sikur të ketë qenë një qendër ndalimi e UÇK-së,
19 dhe në këtë qendër të presupozuar ndalimi kanë hyrë trupat e
20 KFOR-it. 'Qendra' është ndërtuar në Ponosevac".

21 Dhe pastaj thuhet që:

22 "Patrulla e KFOR-it ka shkuar dhe ka vizituar këtë dhe më
23 tej thotë që patrulla e KFOR-it ka arrestuar shtatë individë
24 me uniformë të cilët kishin karta identifikimi ... të UÇK-së."

25 Pastaj jepet edhe karta e identitetit e UÇK-së dhe pastaj

1 jepen detajet e tjera në letër sikurse mund ta thoni. Pyetja
2 që kam për ju, Dëshmitar, është: A ju kujtohet ky incident?
3 PË. Nuk mendoj që më kujtohet ky incident konkretisht ky
4 incident nuk më kujtohet, por megjithatë ky është qëllimi
5 kryesor i marrëveshjes. Pra, marrëveshja synonte që të ofronte
6 një mekanizëm ku ne, ata që kryenim veprime të tilla, t'i
7 bënim përgjegjës. Domethënë, çështja ishte se kush e
8 urdhëronte këtë lloj sjelljeje.

9 Dhe në rastin në fjalë, nuk sugjerohet asgjë, domethënë
10 nuk sugjerohej që Gjenerali Çeku e kishte urdhëruar këtë.
11 Kështu që, është një letër normale që ndodhte në një rast të
12 tillë.

13 PY. Dëshmitar, ju thatë që me këtë rast, me këtë incident
14 konkret ju nuk e dinit që ka ndodhur ky incident. A mund të na
15 e thoni se cili ka qenë diskutimi që ka ndodhur pasi është
16 lëshuar kjo letër?

17 PË. Ma thoni dhe një herë, e keni fjalën kur u nxor kjo
18 letër, çfarë diskutimesh ka pasur? Domethënë, ky është diçka
19 që duhet ta kishte realizuar Gjenerali Jackson. Ishte detyrë e
20 tij, nuk ishte e imja.

21 PY. Do ju tregoj disa dokumente të tjera dhe pastaj do ju
22 pyes në qoftë se jeni i njohur me diskutimet e bëra lidhur me
23 ato dokumente.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Tani për momentin dua t'i kërkoj
25 Sekretares që të paraqesë në ekran dokumentin P755, do të

1 fillojmë me paraqitjen në ekran të faqes SPOE007739 [Sipas
2 përkthimit].

3 PY. Sa për t'ju informuar, bëhet fjalë për një kabllogram,
4 pra data është 29 korrik 1999. Ndërkohë që kalojmë në një faqe
5 tjetër, besoj që e shikoni pjesën ku përshkruhet një diskutim
6 me Hashim Thaçin. Le të shohim pikën d) "Forcat paramilitare:
7 "COMKFOR-i tha që ishte shqetësuar për elementë të
8 njësisë policore me uniforma të zeza. Ai pyeti se kush ishin
9 ata persona. Ata nuk kishin autoritet për të bërë arrestime.
10 Bëhej fjalë për kidnapim ose rrëmbime. Po humbej besimi, dhe
11 përgjigja që u dha nga Thaçi ishte evazive".

12 Dëshmitar, a e mbani mend një diskutim të tillë?

13 PË. Kjo është shumë specifike, kështu që nuk më kujtohet
14 konkretisht. Megjithatë, më kujtohen shqetësimet që kemi pasur
15 lidhur me njësinë, me policinë ushtarake.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani kemi
17 disa dokumente të tjera dhe për shkak të detyrimit që kemi për
18 ofruesit e dokumenteve përkatëse, sipas rregullës 107, do
19 kërkoni që të kaloni në seancë private.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
21 le të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 51

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 52

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 53

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 54

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 55

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 56

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 57

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 58

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 59

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 60

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 jemi në seancë publike.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 flisni tani, Tully.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ndërhyra para
13 kohe.

14 Sa i takon dokumentit të fundit që iu tregua dëshmitarit,
15 ky është një dokument që nuk u përdor gjatë pyetjeve të palës
16 thirrëse dhe dua që të kem të drejtën që ta shtjelloj më tej
17 me dëshmitarin. Po ashtu, sikurse e kemi thënë në parashtimin
18 F03342, është e rëndësishme dhe mund të jetë inkriminuese për
19 z. Selimi gjatë kundërpjetjeve dhe për këtë arsye, përderisa
20 dokumenti nuk është përdorur nga pala thirrëse, ne duhet që të
21 kemi mundësi që t'i bëjmë pyetje dëshmitarit lidhur me këtë
22 dokument. Kështu që mund të aplikojmë ose mund t'i kërkojmë që
23 të bëjmë pyetje plotësuese. Por më duhet që të konsultohem së
24 pari me z. Selimi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] në rregull.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Është e drejta e avokatit që të
2 bëjë pyetje plotësuese.

3 Megjithatë, sqarimi që kam unë tani është që për momentin
4 ne përfunduar me pyetjet që kemi për dëshmitarin. Është një
5 dokument me numër provizor prove, por në qoftë se Trupi
6 Gjykues nuk e pranon këtë dokument në provë, atëherë do i
7 kërkoj Trupit Gjykues që ta lexojë për procesverbal, kështu që
8 në qoftë se nuk do vendoset në favor të pranimi të këtij
9 dokumenti, më duhet të ndërhyj në mënyrë të tillë që ta bëj të
10 qartë për procesverbalin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim
12 parasysh kur të marrim vendimin lidhur me këtë.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
15 bëjmë pushimin deri në 11.35.

16 --- Pauza fillon në orën 11.08

17 --- Seanca rifillon në orën 11.38

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti i
19 shënuar për identifikim që iu referuar më parë nuk do të
20 pranohet. Ishte pjesë e një deklarate dhe si pjesë e
21 deklaratës është pjesë e deklaratës dhe unë mendoj që thatë që
22 kishit një rrugë alternative që do të eksploronit.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kemi nevojë për disa minuta të
24 tjera, për t'i bërë pyetje dëshmitarit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

1 Silleni dëshmitarin në sallë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe ndërkohë që pritet të vijë
3 dëshmitari të vendosim në ekran dokumentin DHT11110103 [Sipas
4 përkthimit] që është pjesë e dëshmisë së dëshmitarit.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, po
7 i afrohem momentin kur përfundon dëshmia juaj.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me gjithë
9 respektin për ju dhe për Gjykatën unë doja të bëja një pyetje
10 procedurale, pasi nuk kam dijeni për të gjitha procedurat. Dhe
11 ishte një çështje rendi dite nga pikëpamja diplomatike; nëse
12 më lejohet a mund ta bëj një pyetje të tillë?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta nuk
14 do të premtoj se do të japim përgjigje, por mund ta bëni
15 pyetjen.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

17 Përpara se përfunduam ZPS-ja më bëri një -- përfaqësues i
18 ZPS-së më bëri një pyetje dhe të them të drejtën isha kaq i
19 çuditur me mënyrën e argumentit sa më humbi aftësia për të
20 formuluar fjalët dhe ai e mori atë si një paaftësi për t'u
21 përgjigjur; është gabim. Unë desha t'i përgjigjesha dhe nëse
22 dëshironi se të dini se cila do ishte ajo përgjigje, unë do
23 t'i përgjigjem, por nuk e di se nga pikëpamje procedurale nëse
24 lejohet një gjë e tillë apo jo.

25 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 63

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
2 Mettraux po më konsulonte pasi një gjë e tillë u bë në seancë
3 private dhe para se të vazhdoni më tutje do të duhet të
4 kalojmë në seancë private.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Po ashtu është.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling ka
7 disa pyetje për t'ju bërë dhe do ta lejojmë këtë që të bëhet
8 pjesë e seancës së vazhdueshme.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 64

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 65

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
11 publike, të nderuar Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Vazhdoni.

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Në ekran, Dëshmitar, siç e sheh kemi paragrafin 57 dhe
16 58.

17 PË. Po.

18 PY. Për ta bërë të qartë për procesverbal këtu, ku thuhet:

19 "Ofruar nga Gjeneral Agim Çeku në emër të UÇK-së" dhe

20 "Pranuar nga Gjenerali Mike Jackson, Komandant i KFOR-it"

21 Pra, pjesa e firmave kështu dukej me datën 18 gusht -- 18
22 qershor 1999?

23 PË. Kështu duhej të kishte qenë, po.

24 PY. Dhe pastaj kemi:

25 "Ofruar nga Hashim Thaçi, Komandant i Përgjithshëm i UÇK-

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 66

1 së"

2 "Pranuar nga Gjenerali Mike Jackson, Komandant i KFOR-it"

3 Kjo është mënyrë -- kështu do të ishte dukur kjo pjesë me
4 datën 19 qershor?

5 PË. Në fund të 19 qershorit.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne jemi të
7 kënaqur me kaq. Nuk kemi pyetje të tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, siç thashë unë
10 kam kërkuar që t'i bëj pyetje dëshmitarit lidhur me pyetjet që
11 kanë lindur dhe nuk do të zgjasë më shumë sesa pesë minuta.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka vërejtje
13 Mbrojtja e Thaçit që Z. Tully të jetë i parë?

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Dhe të nderuar Gjykatës që ta kuptoj
16 dhe për të për të shkuar [E pakuptueshme] me sa kuptoj unë, ne
17 do të ndjekim rendin e duhur apo jo.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Pavarësisht se dokumenti i fundit
19 nuk ishte në seancë private, çdo gjë që ka lidhje me të duhej
20 të ishte në seancë private.

21 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

22 Z. TULLY: [Përkthim] Sa për të qenë të sigurt kalojmë në
23 seancë private.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
25 seancë private; jam dakord.

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 67

1 Sekretaria, të kalojmë në seancë private.

2 Z. TULLY: [Përkthim]

3 PY. Dhe sa për ta prezantuar veten, unë jam z. Tully --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 68

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 69

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 70

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 71

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 72

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
13 publike, të nderuar Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. Dje Prokurori ju pyeti lidhur me emërimin e Gjeneral Agim
17 Çekut si komandant i UÇK-së. A të kujtohet?

18 PË. Po.

19 PY. Dua -- thatë në atë kohë se nuk të kujtohet se kush e
20 kishte emëruar, kështu është?

21 PË. Po.

22 PY. Atëherë do të duhet të tregoj një intervistë që Gjenerali
23 Çeku dha në vitin 2000 për gazetën "Zëri".

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ka numrin e provës 1D00243. Ta
25 vendosim në ekran, ju lutem. Faqja 5 e këtij dokumenti, ju

1 lutem. Në paragrafin e dytë.

2 PY. Ku shihet aty fjalia e fundit; të lexojmë pyetjen në
3 fillimisht:

4 "Zëri: Cila është procedura e zgjedhjes suaj si Shef i
5 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Kosovë para fillimit apo
6 më herë?"

7 Dhe ai shpjegon: Dhe pastaj thotë:

8 "Qëndruam në Shtabin e Përgjithshëm për disa dhe puna ime
9 u diskutua për disa -- për një kohë të gjatë dhe vendimi për
10 të më emëruar Shef të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u mora
11 nga i gjithë Shtabi i Përgjithshëm, jo nga një individ i
12 vetëm."

13 A të freskon kjo kujtesën apo keni ndonjë arsye që të mos
14 jeni dakord me atë që ka thënë Agim Çeku?

15 PË. Ka kaluar një kohë shumë e gjatë. Nuk më kujtohet ta kem
16 parë këtë apo përkthimin e këtij artikulli. Është e çuditshme
17 përmendja e Shtabit të Përgjithshëm por mund t'i kthehem i
18 kësaj çështje më vonë. Më përforcon përshtypjen që kam krijuar
19 kur isha në Kosovë me datën 17 dhe 19 takova komandantët e
20 zonave që ata e kishin e trajtonin atë me respekt të dukshëm.
21 Fakti që ai ishte emëruar nga një grup njerëzish dhe jo nga
22 një person në krye pasqyrohet këtu dhe nuk më çudit.

23 Pasi marrëdhëniet dhe dinamika e marrëdhënieve të tyre
24 pasqyron një gjë të tillë.

25 PY. Faleminderit.

1 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

3 PY. Ju pyetën në mëngjes lidhur me lëvizjet e z. Ramush
4 Haradinajt?

5 PË. Po.

6 PY. Dua të sqaroj pak dëshminë që na dhatë. Dje thatë që
7 Ramushi ishte i pranishëm në takimin e 17-s?

8 PË. Po.

9 PY. Më pas ju tregua një video që për procesverbal ka numrin
10 1D287, ku diskutuat me Ramush Haradinajn dhe thatë që mund të
11 kishte ndodhur me datën 19 pasi ishte ditë e jo natë dhe ishte
12 dita e parë kur kemi mbajtur diskutime gjatë ditës dhe jo në
13 mbrëmje, është e saktë kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Dakord. Në qoftë se z. Haradinaj thotë që ka qëndruar
16 vetëm për një ditë atëherë ai e ka gabim, apo jo?

17 PË. Nuk isha i sigurt që tha ashtu.

18 PY. Çfarë menduat se tha?

19 PË. Me sa pashë unë i tha që ishte në takim dhe u largua, që
20 nënkupton se përse nuk ishte në darkën e më pastaj tme që do të
21 thotë që ishte aty për të marrë pjesë në mbledhje dhe më pas u
22 largua. Nuk erdhi për darkë. U mundova t'i shpjegoj Prokurorit
23 që këto janë dy gjëra të ndryshme.

24 Është e saktë ajo që tha; është e saktë ajo që shihet në
25 video; nuk ka asnjë konflikt mes të dyjave; nuk ka kundërshti;

1 nuk shoh ndonjë problem. Ndoshta mund të ma shpjegoni ju.

2 PY. Po ju mendonit se ai po fliste për datën 17.

3 PË. Po dhe ai ka qenë aty gjatë gjithë kohës së takimit por
4 jo në darkë.

5 PY. Po a ka qenë aty edhe me datën 19?

6 PË. Po.

7 PY. Tani do t'i kthehem çështjes së diskutueshme të
8 komandantëve të zonave.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të vendosim edhe një
10 herë videon 1D287, në 01:30.

11 [Luhet videoincizimi]

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Prokurori ju pyeti sot pas videos për të treguar emrat e
14 të gjithë personave që mendoni të ishin komandant zonash,
15 kështu është?

16 PË. Po.

17 PY. Po përpiqem edhe një herë. Personi i veshur me rroba
18 civile --

19 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të shohim personin e dytë nga e
21 djathta. E di që cilësia e fotografisë nuk është e mirë.

22 PY. A e njihni këtë person?

23 PË. Pas 26 vjet më vonë është shumë e vështirë për të dalluar
24 nga kjo fotografi.

25 PY. A kishit dijeni nëse ishte komandant zone?

1 PË. Siç e kam thënë nuk na janë prezantuar në mënyrë zyrtare.
2 Mua më kanë treguar fotografi me të gjithë, fotografi të tyre,
3 por NATO-ja e kishte këtë dokument me sekret shumë të lartë,
4 dhe në qoftë se NATO-ja nuk e nxjerr këtë dokument, unë nuk
5 jam në gjendje, nuk jam në gjendje që të tregoj se kush janë
6 këto persona. Unë dalloj personin që ishte ngjitur me Çekun,
7 pasi m'u përshkrua si një komandant i cili mendonte se ishte
8 shumë i pavarur dhe me të cilin do kishin vështirësi. Më kanë
9 treguar për këta persona, por kanë kaluar 26 vjet.

10 Këto ishin emra shqiptarësh të cilët nuk janë prezantuar
11 me ne. Nuk kishim fotografi apo informacione fotografike. Pas
12 26 vjetëve një gjë e tillë është shumë e vështirë.

13 PY. E kuptoj, por për sa i takon procesverbalit më duhet t'i
14 bëj këto pyetje. Nëse mund të përgjigjemi me "po" ose "jo", ju
15 lutem, dhe më pas do t'ju bëj një pyetje të përgjithshme nga
16 fundi.

17 Edhe pas 26 vitesh a keni dëgjuar ndonjëherë emrin Ahmet
18 Jusufi?

19 PË. E kam dëgjuar, por nuk më kujtohet gjë.

20 PY. Le t'i kthehemi personit në të majtë të cilin e keni
21 identifikuar. Është Rama?

22 PË. Besoj se është ai.

23 PY. A mendoni se ai ishte komandant zone?

24 PË. Më thanë se po.

25 PY. Në të njëjtën fotografi, në anën tjetër të Çekut?

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 77

1 PË. Shumë vështirë. Mund të jetë se për shkak fotografia
2 është e cilësisë së dobët.

3 PY. Dhe nuk keni dijeni nëse është komandant zone?

4 PË. Jo.

5 PY. Emri Tahir Sinani, a është i dëgjuar?

6 PË. Po e përsëris ka kaluar shumë kohë.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë tani në pikën
8 01:44.

9 PY. A e njihni këtë person?

10 PË. Nuk më kujtohet emri.

11 PY. A e dini nëse ka qenë komandant zone?

12 PË. Besoj se po.

13 PY. Shukri Buja a është emër që keni dëgjuar?

14 PË. Po. Atëherë duket se ky është Shukri Buja.

15 PY. Dhe a e dini që ky ka qenë komandant zone?

16 PË. Po, kështu e kam kuptuar.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të shkojmë në pikën

18 3:42. Kam nevojë të më ndihmojnë pak pjesëtarët e ekipit.

19 Vazhdojmë. Edhe më përpara ju lutem. Tek minuta 04:45. Më

20 duket se ju kam dhënë referencën gabim.

21 Ju kërkoj ndjesë, z. Dëshmitar. Z. Kryegjykatës po
22 komunikoj me komunikimin në fakt në raport me këta njerëzit.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] A më lejoni mua të bëj disa
24 komente?

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

1 PY. Më mirë jo tani. Të përfundoj unë me pyetjet e mia dhe më
2 pas mund të thoni çfarë doni të thoni.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kthehemi sërish te minuta
4 01:44. Jo, më duket se jua dhashë gabim. 03:42 ju lutem.

5 PY. Personi në cep më të majtë, kush është?

6 PË. Jo.

7 PY. Ka qenë komandant zone?

8 PË. Nuk e di.

9 PY. Emri Sadik Halitjaha, ju thotë gjë?

10 PË. I njohur më duket.

11 PY. A e dini nëse ka qenë zëvendëskomandant zone?

12 PË. Nuk e di.

13 PY. Po personi që ka vendosur dorën tek fytyra?

14 PË. Remi.

15 PY. Ka qenë komandant zone?

16 PË. Po.

17 PY. Po personi --

18 PË. Nuk e di.

19 PY. Personi në anën tjetër --

20 PË. Me kokën e rruar? Ky është Ramushi.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë te minuta 04:45 -- jo?
22 Më duket se nuk është nevoja. Në rregull.

23 PY. Z. Dëshmitar, z. Duncan, Trupi Gjykses i njeh ngjarjet
24 para 26 viteve -- më falni, është në dijeni që kjo është një
25 ngjarje që para 26 viteve. A është e saktë siç na thatë që

1 keni marrë pjesë dhe keni marrë një informim prej NATO-s
2 lidhur me çdo person në situata, apo jo, përpara se të shkonte
3 atje?

4 PË. Është bërë një informim, prandaj desha të komentoja më
5 përpara që ta sqaroj këtë gjë.

6 PY. Në rregull.

7 PË. Personat, pra, komandantët e zonave i njihte NATO-ja,
8 NATO-ja kishte një profil të personave se cilët ishin. Kur
9 shkuam në Bjeshkët e Berishës për takimin e 17 qershorit, më
10 dhanë disa karta me shkrim dore, karta me informacion që
11 kishin emrat e komandantëve të zonave dhe disa të dhëna,
12 domethënë, kush ishin, çfarë profesioni kishin pas më para, a
13 ishin pjesë të ish-Armatës Jugosllave, fakte lidhur me këta
14 persona dhe lidhur me personalitetin e tyre. Dhe mua këto më
15 shërbenin për të kuptuar si do të funksiononte takimi. Por
16 fotografi nuk kisha. Nuk na i prezantoi Gjenerali Çeku. Ai
17 thjesht tha, "Këtu jam me komandantët e zonës." Prandaj nuk ju
18 them dot kush është ky person e kush është ky person. Nuk
19 munda ta bëjë këtë gjë.

20 Gjenerali Çeku më tha, "Unë jam këtu me komandantë të
21 zonave", disa prej tyre flisnim shumë. Ata që flisnin i kujtoj
22 shumë lehtë, dhe prandaj ua di emrat, sepse më kujtohej se
23 flisnin. Ndërsa komandantët që thjesht qëndruan ulur dhe nuk
24 thanë gjë, nuk e di kush janë. Prandaj e kam kaq të vështirë
25 unë që ky person është X, është Y, se në informacionin

1 paraparak që më dhanë, nuk më dhanë, pra, fotografitë personale
2 dhe as nuk u prezantuan me emra.

3 PY. Pra, shumë e qartë. Pra, sipas jush, NATO-ja ju informoi
4 siç duhet dhe ju tha që do jenë komandantët e zonave atje, apo
5 jo?

6 PË. Nuk është se më dhanë informacion të mirëfilltë.

7 PY. Po ju dhanë disa karta për secilin person?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, nuk keni arsye që ajo çfarë thatë Çeku, lidhur me
10 komandantët e zonave -- nuk keni dyshim lidhur me atë që ju ka
11 thënë komandanti Çeku ama për komandantët e zonave?

12 PË. Jo, nuk kam arsye për ta dyshuar këtë.

13 PY. Dhe pas 26 vitesh më vonë, ndonëse është e vështirë për
14 ju për shkak të disleksisë, kjo ka kuptim dhe ishte tamam
15 ashtu siç e keni përshkruar.

16 PË. Po.

17 PY. Dhe emrat janë më të vështirë për t'u kujtuar, apo jo?

18 PË. [Nuk ka përkthim].

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Fillimisht heqim videon nga
20 ekrani.

21 PY. Sot paradite ju bënë pyetje lidhur me titullin e z. Thaçi
22 si kryekomandant apo komandant i përgjithshëm lidhur me
23 marrëveshjen që do bëhej nga anëtarë e lartë të UÇK-së, ju
24 kujtohet kjo pyetje?

25 PË. Po.

1 PY. Dje në transkriptin në faqen 44 dhe 45 ju thatë se NATO-
2 ja nuk mund ta njihte, nuk do ta njihte Agim -- Hashim Thaçin
3 si kryeministër të Kosovës; nuk do të pajtoheshin me këtë gjë.

4 "Nuk ishin ende gati as të njihnin Kosovën si shtet dhe e
5 sigurt që nuk do ta njihnin as Hashim Thaçin si udhëheqës të
6 Kosovës".

7 Ju kujtohet kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Dje në dëshminë tuaj ju treguan paragrafin 60 të
10 deklaratës suaj, ku në thelb keni thënë se z. Thaçi nuk mund
11 ta nënshkruante në cilësinë e kryeministrit, sepse NATO-ja dhe
12 komuniteti ndërkombëtar nuk e njihnin Qeverinë e Përkohshme të
13 Kosovës e rrjedhimisht atë pozitë.

14 Pra, dikush e sajoi këtë titull në mënyrë që të dukej
15 sikur z. Thaçi kishte legjitimitetin edhe pushtetin dhe për
16 këtë arsye iu dha titulli si kryekomandant apo komandant i
17 përgjithshëm.

18 PË. Po.

19 PY. Do t'ju tregoj një memo tani.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është me numër 1D00361.

21 Fillimisht shohim ballinën. Është një dokument i UN-it, i
22 Kombeve të Bashkuara - më falni. Shkojmë në faqen e dytë. Nga
23 Bernard Kouchner, SRSG. Më poshtë, 5 tetor '99 është data.

24 PY. Titulli është "Procedura për trajtimin e komunikimeve me
25 shkrim nga të ashtuquajtura Subjekte të 'Qeverisë së

1 Kosovës'." Dhe thuhet:

2 Zyrat e UNMIK-ut në të gjitha nivelet marrin komunikim me
3 shkrim nga e ashtuquajtura 'Qeveri e Kosovës' ose 'Qeveria e
4 Ndërmjetme e Kosovë -- e Përkohshme e Kosovës'. Ka qenë
5 politikë e këtij misioni t'ua kthejë këto letra dërguesit pa
6 përgjigje. Megjithatë Misioni nuk do të jetë në një pozitë të
7 atillë që t'i njohë këto institucione apo subjekte. Kjo
8 politikë nuk do të thotë -- nuk do të ketë komunikime të
9 përditshme të UNMIK-ut me përfaqësuesit të ashtuquajturës, në
10 thonjëza institucione -- më falni 'Qeveria' është në thonjëza,
11 institucione të 'Qeverisë'.

12 "Do ju lutesha që kjo politikë të respektohej nga të
13 gjitha zyrat e misionit, të gjitha shtyllat e misionit. Mund
14 të jetë e dobishme që me shumë kujdes të komunikoni pikat
15 tua të kontaktit lidhur me këtë vendim, në mënyrë që ne
16 t'jua bëjmë të qartë që nuk do t'i pranojmë këto komunikime."

17 Pra, komunikimi, UNMIK-u e ka bërë të qartë e thotë që
18 nuk i pranoi komunikimet nga organe që pretendojnë se janë nga
19 e ashtuquajtura qeveri e Kosovë, saktë?

20 PË. Saktë.

21 PY. NATO-ja, a kishte ndonjë politikë formale apo informale
22 për të mos pranuar korrespondencë, letërkëmbime nga persona që
23 ishin pjesë e qeverisë të përkohshme e më konkretisht me
24 Hashim Thaçin në cilësinë e kryeministrit?

25 PË. Jo, me sa kam unë dijeni. Kjo është diçka që do trajtohej

1 nga personeli i Gjeneralit Jackson, si rregull. Nuk kam pasur
2 dijeni që ta ketë pasur këtë politikë NATO-ja. Duhet të kishte
3 pasur se kjo ishte praktika e duhur, politika e duhur, por
4 ndonjëherë vinin letra nga z. Thaçi dhe këto letra nuk duhej
5 të ishin pranuar.

6 PY. Pse duhej ta kishte patur dhe NATO-ja këtë praktikë?

7 PË. Që të ishte në një linjë me organizata të tjera, të mos e
8 njihnin Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

9 PY. Pra, ju thoni fakti që letra është nënshkruar nga z.
10 Hashim Thaçi është një cenim i pozicionit të forcave aleate?

11 PË. Dhe më tepër se kaq; nuk është respektuar marrëveshja
12 këtu, sepse z. Thaçi nuk e kishte këtë rol dhe ai -- dhe kjo
13 letër duhet të ishte nënshkruar nga Gjeneral Çeku. Prandaj kjo
14 letër nuk duhet të ishte pranuar. Nuk e di çfarë ka ndodhur;
15 unë di thjesht që ka pasur një incident që kanë kërkuar armë
16 dhe ne ramë dakord që duhej dhënë. Por mënyra si e kanë
17 kërkuar unë nuk e di; nuk e kam parë shkresën konkrete.

18 PY. Faleminderit. Kam edhe një pyetje tjetër. Fakti që ka
19 përdorur titullin kryekomandant në këtë letër këmbim, për ju
20 kishte ndonjë kuptim?

21 PË. Jo, absolutisht jo. As nuk duhej të ishte pranuar as nuk
22 do ta kishte nënshkruar ai me këtë titull, në këtë cilësi.

23 PY. Ai ishte ai vërtet kryekomandant?

24 PË. UÇK-ja ishte duke u çarmatosur në atë kohë. Duhet të
25 respektonte marrëveshjen dhe rrjedhimisht s'duhej të kishte më

1 tituj të këtij lloji.

2 PY. Domethënë, ky titull nuk kishte asnjë vlerë?

3 PË. Ky titull ishte thjesht i pavlerë.

4 PY. Të flasim tani për dhunën. Jo, në fakt jo. Përpara se të
5 kalojmë te kjo pikë, dje ju bëmë pyetje për prejardhjen apo ju
6 bëmë pyetje lidhur me klauzolat në marrëveshje për mbrojtjen e
7 civilëve. Ju kujtohet këto?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe ju thatë:

10 "Ka pasur dhe problem që do të bëhej i dukshëm dhe u bë i
11 dukshëm, sikurse u diskutua dhe sot paradite. Pra, thatë që do
12 të ketë një situatë shumë të pasigurt, dhe në këtë rast UNMIK-
13 u mund të mos ishte aq i fortë sa ç'duhet sa të parandalonte
14 aktet e hakmarrjes. Dhe ju thatë që është krejt normale që të
15 kishim një angazhim, një zotim prej UÇK-së që nuk do të
16 merrnin pjesë në akte e dhunës dhe nuk do të lejonin të
17 ndodhte kjo."

18 Ju kujtohet kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Do të shikojmë atëherë një video. Është një konferencë
21 për shtyp e Pentagonit, zëdhënësi i Pentagonit Ken Bacon më 5
22 qershor 1999.

23 [Luhet videoincizimi]

24 "Kosova do të jetë [Sipas përkthimit] një vend shumë i
25 mirë për serbët, kur të vijë NATO-ja dhe nuk besoj se serbët

1 do të duan të qëndrojnë atje. Besoj se do të duan të kthehen
2 në Serbi. Ne nuk e dimë sa e madhe është pakica serbe atje,
3 mbase rreth njëqindmijë persona, diçka më shumë, por kur të
4 kthehen shqiptarët e Kosovës, ne supozojmë se shumë serbë ka
5 të ngjarë të kthehen në Serbi.

6 "PY. Pra, duket sikur po i inkurajoni personat që janë
7 serbë të largohen?

8 "PË. Jo, jo, nuk po e inkurajoj unë, po ju them si janë
9 faktet, si e parashikojmë ne."

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Pra, Pentagoni e parashikonte që mund të ndodhte kështu.
12 Kur thatë dje që klauzola ishte e përfshirë për të garantuar që
13 UÇK-ja nuk do të përfshihej në ato çka ndodhën më pas dhe kur
14 patë çfarë thoshte Ken Bacon në video, a ishte e njëjta gjë që
15 thatë edhe ju?

16 PË. Në fakt reflektova gjatë natës lidhur me këtë paragraf,
17 se si u përfshi ky paragraf. Me sa më kujtohet mua, projekt-
18 marrëveshja e parë kishte formulime lidhur me sulmet
19 shpaguese, por u diskutua me Uashingtonin, me Londrën dhe unë
20 e zgjerova më tej këtë shprehje e cila u përkthye më pas në
21 këtë paragraf. Pra, u bënë -- u kthyen në një paragraf ku u
22 përfshi the fakti i civilëve dhe burgimeve.

23 Pra, kjo pak a shumë ishte përgjigja e pyetjes suaj.

24 PY. Në fakt dua të kthehem në një pyetje që e fillova pak më
25 herët lidhur me dhunën në MNB lindje, pra, në forcat -- në

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 86

1 vendin ku qëndronin forcat shumëkombëshe, pjesa lindje. MNB
2 East.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pra, kalojmë në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 87

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem, nxjerrin në ekran

19 provën P02516.

20 PY. Ju lutem, fokusohuni në krye të faqes. Z. Duncan. Është

21 Gjenerali -- është dëshmi e Gjeneralit Jackson që është dhënë

22 në rastin Kontic në Gjykatën e Lartë në Londër më 24 maj 2016.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk e kemi përdorur këtë

24 dokument gjatë pyetjeve tona. A mund të na sqaroni si lidhet

25 kjo atëherë me fushëveprimin e pyetjeve tona?

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, ka lidhje sepse Prokuroria
2 dha shumë shembuj të rasteve individuale të dhunës që janë
3 kryer ndaj serbëve të pretenduara prej UÇK-së. Pra, për aktet
4 e dhunës ndaj civilëve. Po ashtu ka folur lidhur me pikëpamjet
5 e Gjeneralit Jackson në një memo dhe në raporte e një takimi
6 me z. Thaçi lidhur me natyrën, pra, pyetje lidhur me natyrën e
7 dhunës që ka ndodhur në verën e '99-s. Kjo deklaratë lidhet me
8 natyrën e kësaj dhune.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Vazhdoni.

11 Kundërshtimi rrëzohet.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Të shikojmë dy
13 paragrafë të shkretur në këtë tekst, ju lutem. Si fillim
14 shohim faqen 121589.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Edhe një herë ju lutem
16 numrin e faqes.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faqja 16 fillimisht. Ndalojmë
18 këtu.

19 PY. Ai përgjigjet:

20 "Po. Unë vetë nuk kisha prova ..."

21 Dhe kalojmë disa fjalë dhe thotë:

22 "... UÇK-ja nga pikëpamja institucionale, përmes
23 praktikave të veta po kryente akte terroriste kundër
24 personave. Unë nuk po them që kjo s'ka ndodhur prej personave
25 të caktuar, por nuk kam prova që kjo të ketë qenë praktikë e

1 UÇK-së.”

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë tani tek i njëjti
3 dokument në faqen 121594, që është faqja 21 në këtë dokument.
4 Edhe më poshtë në tekst.

5 PY. Tek rreshti 17 Gjenerali Jackson thotë:

6 “Po ju them, që nuk kam prova që nga pikëpamja
7 institucionale UÇK-ja të ketë pasur praktikë të spastrimin
8 etnik të serbëve që kishin mbetur aty.”

9 A pajtohem me vlerësimin e tij?

10 PË. Po. Në këtë rast pajtohem me vlerësimin e tij.

11 PY. Me sa keni ju dijeni, Gjenerali Jackson, a i ka raportuar
12 ndonjëherë komandës së NATO-s se Hashim Thaçi ka dirigjuar apo
13 ka kryer akte dhune ndaj civilëve?

14 PË. Jo me sa kam unë dijeni.

15 PY. Faleminderit.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Pyetje nga Trupi Gjykues:

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më erdhi mua radha,
20 mirëdita, Dëshmitar z. Duncan.

21 PË. Mirëdita.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, Trupi Gjykues ka
23 disa pyetje të tjera për ju në mënyrë të tillë që të sqarohemi
24 lidhur me disa prej temave të çështjeve që ju keni përshirë në
25 dëshminë tuaj deri tani. Pyetja e parë që kam për ju është

1 kjo. Kjo është një pyetje e cila ka të bëjë me eksperiencën
2 ose përvojën tuaj si diplomat britanik.

3 Në deklaratën që i keni dhënë Mbrojtjes me 24 gusht 2025
4 në paragrafin 4 se ju keni shërbyer në Paris dhe Khartoum dhe
5 më pas keni pasur pozicione në Londër përpara sesa të
6 ngarkoheshit me punë në Tiranë kur keni shërbyer si person i
7 ngarkuar me punë për periudhën nga 1992 deri '93. A ju
8 kujtohet t'ia keni thënë këtë Mbrojtjes, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni sa kohë
11 keni qëndruar në Shqipëri, sa muaj keni qëndruar në Shqipëri
12 gjatë asaj periudhe?

13 PË. Besoj se gjithsej kanë qenë tetë muaj. Unë jam vendosur
14 në Tiranë, në Shqipëri në qershor dhe jam larguar në fillim të
15 pranverës. Diçka e tillë, pak a shumë tetë muaj.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal flasim për
17 qershor të '92-shit dhe në fillim të pranverës së '93-shit;
18 për këtë periudhë e keni fjalën, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni thënë gjithashtu te kjo
21 - mund ta gjeni në paragrafin 73 të deklaratës që i keni dhënë
22 Mbrojtjes - që keni kryer disa vizita, tri ose katër vizita në
23 Kosovë pas nënshkrimit të marrëveshjes; a e konfirmoni këtë,
24 Dëshmitar?

25 PË. Po, kam pasur disa vizita.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për sa kohë keni qëndruar
2 pak a shumë në Kosovë gjatë këtyre vizitave kur keni shkuar?
3 PË. Sikurse e shpjegova në pyetje plotësuese, të nderuar
4 Gjykatës, pjesa dërrmuese e këtyre vizitave ishin të tilla që
5 thjesht shkonim me helikopter, bënim takime dhe ktheheshim më
6 mbrapa. Kjo ishte natyra e vizitave. Domethënë, thjesht
7 shkonim në mëngjes, pastaj kryenim vizita paradite dhe pasdite
8 dhe në darkë ktheheshim. Kështu që vizitat kanë qenë shumë të
9 shkurtra.

10 Megjithatë, në qoftë se doni datat konkrete kur kam
11 shkuar, më duhet të shikoj shënimet e mia, por mbaj mend që
12 kur kam shkuar vetë, kam qëndruar dy-tri ditë, por me
13 Gjeneralin Smith, me Rupert Smithin kam shkuar gjithashtu.
14 Kështu që gjashtë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes janë
15 bërë disa vizita. Është e vështirë që të thuash ekzaktësisht
16 se sa vizita kam bërë, sepse siç thashë, disa prej këtyre
17 vizitave ishin që të shkoje me helikopter; të qëndroje aty dhe
18 pastaj ktheheshe. Është e vështirë të kujtosh.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po të thuash disa ditë do
20 ishte ndoshta një vlerësim i drejtë?

21 PË. Gjithsej mund të thuash tri-katër ditë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e keni vizituar Kosovën
23 ndonjëherë tjetër përpara apo pas luftës përveç vizitave që
24 sapo na përmendët dhe në qoftë se e keni vizituar Kosovës, ju
25 lutemi na thoni; për sa kohë keni qëndruar atje dhe kur kanë

1 ndodhur këto vizita?

2 PË. Vitin më pas, që i takon të ketë qenë viti 2000 kam
3 shkuar për shkak të një problemi që kishim pasur që ishin
4 thashethemet e trupave që duhej që të kuptoshin që në situata
5 nuk ishte -- Bosnja, pra ishin në situatë tjetër dhe për këtë
6 arsye kishin vështirësi dhe mua më kërkohet që të shkoja që të
7 bëja një lloj raportimi atje. Kështu që kam qëndruar për disa
8 ditë.

9 Dhe më pas kam shkuar mesatarisht dy ose tri herë në vit
10 në Kosovë. Ndërkohë që përpara luftës, jo; nuk kam qenë në
11 Kosovë. Thjesht kam flutur mbi kufijtë e Kosovës, por nuk kam
12 qenë në Kosovë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Të vazhdojmë më
14 tej në paragrafin 13 të deklaratës që i keni dhënë Mbrojtjes
15 së Hashim Thaçit në gusht. Këtu trajtohen disa aspekte ose
16 disa tema që ju i keni diskutuar me ne; i keni diskutuar,
17 domethënë me Mbrojtjen dhe me Prokurorinë. Në paragrafin 13
18 përshkruhet:

19 "Gjatë bisedave në orët e vona në Kumanovë, Gjenerali
20 Jackson shprehu shqetësime serioze lidhur me mungesën e një
21 plani të hollësishëm për demilitarizimin e UÇK-së, që vlerësoj
22 që në atë fazë të përbëhet prej mbi 25.000 luftëtarëve të
23 armatosur."

24 Pyetja e parë që kam për ju Dëshmitar është: A ju
25 kujtohet ta keni diskutuar këtë temë me Mbrojtjen?

1 PË. Po, i nderuar Gjykatës, më kujtohet.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A e kam
3 kuptuar drejt që ju këtu e keni fjalën për diskutime të cilat
4 më pas çuan në Marrëveshjen e Kumanovës ose Marrëveshjen
5 Ushtarake Teknike ndërmjet forcës së sigurimit ndërkombëtar
6 KFOR-it dhe Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës
7 së Serbisë që është nënshkruar më 9 qershor 1999, për këtë e
8 keni fjalën?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, dje, dhe për
11 referencë këtë e keni thënë në faqen 22 të transkriptit në
12 kohë reale të dëshmisë suaj. Keni thënë dhe këtu citoj - në
13 kohën e nënshkrimit të marrëveshjes ose negociatave që çuan
14 nën nënshkrimin e marrëveshjes, UÇK-ja kishte rreth 20.000
15 luftëtarë.

16 Pyetja që kam për ju është kjo: Sa luftëtarë vlerësoni ju
17 që të keni pasur në atë kohë UÇK-ja; ka pasur rreth 25.000 apo
18 rreth 20.000 ushtarë?

19 PË. Të nderuar Gjykatës, ishte e vështirë që të përcaktoje
20 numrin se shifrat ishin të ndryshme. Ndërkohë që shifrat e
21 NATO-s ishin pak a shumë ndërmjet kësaj -- këtij numri,
22 domethënë 20.000 deri në 25.000. Por është shumë e vështirë
23 për mua të them që cila shifër është e vërtetë, sepse ishte e
24 vështirë që të përcaktohej se kush ishte pjesë e strukturës,
25 kush bënte çfarë; ishte e pamundur në atë kohë që të kishte

1 një numër ekzakt. Por kjo është shifër e cila u identifikua
2 pas marrëveshjes. Përpara marrëveshjes ishte shumë e vështirë
3 që të merrje një shifër nga UÇK-ja se kush ishin personat ose
4 sa vetë kishin ata në rangjet e tyre, sepse i takonte që të
5 ishin persona që do ishin pjesë e programit të
6 demilitarizimit. Dhe sigurisht, domethënë, do kishte avantazh
7 për ata që ishin aktualisht luftëtarë sepse do kishin mundësi
8 që të zënin një vend pune.

9 Dhe kishte edhe mundësi në fakt që edhe dikush që nuk
10 ishte anëtar i UÇK-së do të thoshte "që jam anëtar i UÇK-së
11 edhe më numëroni dhe mua". Kështu që në përgjigje të pyetjes
12 suaj nuk e kemi ditur ndonjëherë që sa ka qenë numri ekzakt i
13 luftëtarëve të armatosur të UÇK-së. Ka qenë diku nga 20.000
14 deri në 30.000. Pra, kjo është shifra më e besueshme; kjo
15 është shifra që na ka dhënë pala tjetër kur po bënim
16 negociatat për marrëveshjen. Domethënë ata duhej që të thonin
17 që sa luftëtarë kanë. Dhe ky është vlerësimi që kemi marrë
18 prej tyre, kështu që nuk mund t'ju jap një shifër ekzakte.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E kuptoj
20 shpjegimin dhe na ndihmoni me të.

21 Në paragrafin 15, juve i referoheni kapitullit 7,
22 artikulli I(2) (a) të Marrëveshjes së Përkohshme të Rambujesë
23 të marsit të 1999 dhe aty ju thoni që qëllimi ishte që të
24 arrihej armëpushimi i luftimeve që do të zgjaste në kohë.

25 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, dua t'ju pyes nëse
3 ky objektiv i Rambujesë u përmbush apo jo në Kosovë; domethënë
4 a u realizua një armëpushim i sulmeve në Kosovë që shtrihej në
5 kohë?

6 PË. Ndërkohë sa i takon luftimeve në kuptimin ligjor, të
7 nderuar Gjykatës, unë do thoja që kjo është e arritur me
8 evakuimin përfundimtar të trupave serbe dhe trupave
9 paramilitare me 21 qershor, ndërkohë situata pas 21 qershorit
10 nuk ishte situatë luftimesh, ishte më tepër shqetësime civile
11 të cilat të dilnin në pah që mund të identifikojë. Ndërkohë që
12 KFOR-i ishte më shumë i specializuar për ndalimin dhe për
13 kufizimin e sulmeve. Dhe ky është shpjegimi që mund t'ju jap
14 unë.

15 Domethënë, mund të them që në kuptimin ligjor, në
16 përkufizimin ligjor të termit luftimet kanë përfunduar mbas 21
17 qershorit, pas tërheqjes së serbëve.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në paragrafin
19 17 në dëshminë tuaj ju keni thënë që i keni thënë dëshmisë --
20 në dëshminë tuaj Mbrojtjes së Thaçit që Qeveria e Përkohshme e
21 vetëdeklaruar e Kosovës nuk ishte njohur nga një vend -- nga
22 asnjë vend dhe nga asnjë organ ndërkombëtar. Në praktikë nuk
23 kishin kompetenca për të udhëzuar "grupet civile të armatosura
24 ose grupet paramilitare", për të demobilizuar, për t'u
25 demobilizuar ose çarmatosur ose për të udhëzuar -- për të

1 zbatuar udhëzimet të tjera.

2 A na sqaroni për çfarë bëhet fjalë këtu, z. Duncan?

3 PË. Këtë e keni marrë nga Rezoluta 1244 apo jo? Mund të na e
4 sqaroni Gjykatës?

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, unë në fakt lexova
6 formulimin e pikës 17 të dëshmisë tuaj, dëshmisë që i keni
7 dhënë Mbrojtjes së Thaçit, ku ju keni thënë që Qeveria e
8 Përkohshme nuk kishte kompetencë që të urdhëronte ose të
9 udhëzonte askënd që të çarmatosej. Na thoni çfarë baze faktike
10 keni për këtë.

11 PË. Po përpiqem të jap përgjigje sa më të saktë pyetjes që më
12 bëtë. Por kjo ishte një organizim i vetëdeklaruar. Domethënë
13 ishte një qeveri e vetëdeklaruar dhe kishte emëruar organe ose
14 institucione të ndryshme në përbërjen e vet. Për shembull,
15 kemi parë që kishte ministri mbrojtje, instanca të tjera, por
16 nga ana tjetër nuk bëhej fjalë për një shtet se nuk kishte
17 asnjë arkitekturë ku mbështeteshin këto organe të emëruara.

18 Ishte një dikotomi e vërtetë, sepse sikurse jua shpjegova
19 dhe më herët në dëshminë time që Këshillimi i Sigurimit të
20 Kombeve të Bashkuara fliste, nga njëra anë me Serbinë, pra,
21 Serbia ishte njëra palë, por Serbia kishte një arkitekturë të
22 plotë shtetërore. Pra, kishte instanca, kishte shërbim publik,
23 kishte shërbim policor, kishte ministri drejtësie, ndërkohë që
24 në rastin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës nuk kishte asnjë
25 infrastrukturë mbështetëse, as ligjërisht dhe as praktikisht.

1 Dhe këtu jam mbështetur unë kur kam dhënë këtë pjesë të
2 dëshmisë suaj -- të dëshmisë time -- më falni.

3 Ky ishte problem kryesor, dhe problem kryesor tjetër
4 ishte që nuk ekzistonte një strukturë që mund të vinte në
5 jetë, që mund të zbatonte udhëzime. Sepse Z. Thaçi mund të
6 jepte një udhëzim, por nga ana tjetër nuk kishte legjitimitet
7 demokratik. Shteti që ai pretendonte të përfaqësonte nuk
8 ekzistonte në fakt. Nuk kishte shërbim publik; nuk njihej nga
9 askush. Kishte kufizim gjeografik, kaq kishte, asgjë tjetër.

10 Dhe kjo është baza faktike ku jam mbështetur, kur kam
11 dhënë këtë pjesë të dëshmisë sime.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Duncan.
13 Mbase për ta bërë më të qartë argumentin tim. Do ishte mirë që
14 të shtohet që në fund ajo çfarë ndodhi ishte që UÇK-ja u
15 demilitarizua brenda tre muajsh, apo jo?
16 PË. Po, po, kryesisht po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kemi dëgjuar kohët e fundit
18 në këtë sallë gjyqi që kjo ishte dhe këtu po përdor formulimin
19 tim; nuk jam i sigurt në qoftë se është përdorur ekzaktësisht
20 ky term ose kjo gjuhë, ky formulim. Megjithatë me fjalët e mia
21 mund të them që bëhet fjalë për një ushtri që u demilitarizua
22 në një kohë rekord; është një rekord botëror.

23 A ju kujtohet një gjë e tillë?

24 PË. Nuk e kuptoj për çfarë po flisni; nuk e kuptoj pyetjen,
25 mund të na e sqaroni?

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, është diçka që është
2 realizuar pa udhëzime. Kështu që si është e mundur që një
3 formë e armatosur të çarmatohet brenda tre muajsh në një kohë
4 rekord.

5 A keni një shpjegim tani? Besoj se koha ka kaluar dhe
6 mbase mund ta kesh një shpjegim tani.

7 PË. Po, jam në dijeni të komentit.

8 Tani ju thoni si është e mundur një gjë e tillë. Është e
9 mundur sepse këtë jam mundur t'jua shpjegoj edhe në dëshminë
10 tuaj [Sipas përkthimit]. Por për t'ju kthyer edhe një herë
11 argumentit tim, është e mundur se mënyra se si funksiononte
12 marrëveshja ishte që të shpërbëhej struktura e komandës që
13 ekzistonte. Pra, nuk kishte hierarki, por kishte një lloj
14 strukture, sepse ekzistonin komandantët e zonave, ishte Agim
15 Çeku dhe qëllimi i marrëveshjes ishte që të ndahej kjo nga
16 krahu politik i vetëdeklaruar. Këtë nuk e ka realizuar krahu
17 politik. Pra, ne përmes shkëputjes së krahut ushtarak ne patëm
18 mundësi që të realizonim këtë gjë se --

19 Jua kam thënë shpeshherë që po bëhej fjalë për një grup
20 heterogjen njerëzish, Kështu që kur unë kam parë në hollësi
21 aspiratat e komandantëve të zonës dhe kur jam mundur që të
22 gjejë mënyra që të plotësoj aspiratat e tyre dhe mendoj që ia
23 kemi dalë të bëjmë këtë gjë, ne e bëmë këtë realitet.

24 Domethënë në kuptimin që i bindëm ata që të nënshkruanin
25 marrëveshjes. Megjithatë e përmenda dhe pak më herët dhe unë

1 thashë e kam mbështetur këtë në një marrëveshje të mëparshme
2 në Namibi, por rastin në fjalë, domethënë, ekzistonte një
3 ushtri e organizuar; në Kosovë nuk ekzistonte një ushtri e
4 organizuar.

5 Por pavarësisht kësaj, pjesa e organizuar ose pjesa e
6 vetme në aspektin realist që qëndronte pas qeverisë së
7 vetëshpalluar ishte krahu ushtarak dhe këtë ne e shpërbëmë. Ne
8 përmbushëm aspiratat e tyre dhe ne e kuptuam që ishte në
9 interesin e tyre që të bëhej një gjë tilla. Duke e bërë këtë
10 në mënyrë të suksesshme ne i bindëm ata që të realizonin atë
11 çfarë donim ne që ata të realizonin që ishte demilitarizimi
12 ose çarmatimi. Kjo është arsyeja, shpjegimi që mund t'ju jap.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, e kuptoj.

14 Kam pyetjen e radhës për ju. Dje në dëshminë tuaj,
15 Dëshmitar, keni thënë dhe për procesverbal këtë e keni thënë
16 në faqen 83 të transkriptit në kohë reale, se Gjenerali Çeku
17 ka qenë përgjegjës për çarmatimin nga ana e UÇK-së. Domethënë
18 ai ka qenë përgjegjës për këtë proces dhe ai i ka raportuar
19 Gjeneralit Jackson. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni në qoftë se
22 Gjenerali Çeku i ka raportuar ndokujt nga UÇK-ja ose ndokujt
23 në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, dhe në qoftë se thoni po,
24 a dini se kujt i ka raportuar?

25 PË. Unë nuk e di se çfarë ka bërë ai, por ai nuk mendohej ose

1 supozohej që t'i raportonte askujt lidhur me atë çfarë po
2 bënte. Kjo ishte e qartë në kushtet e marrëveshjes dhe kemi
3 parë në fakt këtë shembullin shumë insistues të palës ose të
4 krahut politik që u mundua që të rivendoste kontrollin ose që
5 të rimernte në dorë kontrollin. Kjo nuk ishte jo e papritur,
6 domethënë ishte diçka që mund të pritej dhe, për shembull, z.
7 Thaçi në diskutimet gjatë datës -- gjatë takimit të 19
8 qershorit nuk dukej që e kuptonte ose e vlerësonte plotësisht
9 se çfarë mund të ndodhte në qoftë se ata do të nënshkruanin
10 marrëveshjen. Krahu politik nuk do të kishte më kontroll.
11 Thënë ideja ishte që krahu politik do të shpërbëhej dhe për
12 këtë arsye, domethënë, nuk ishte e qartë se cili ishte qëllimi
13 kryesor i marrëveshjes.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, ju thoni që nuk e
15 dinin në qoftë se Gjenerali Çeku i ka raportuar ndonjërit apo
16 jo?

17 PË. Për këtë mbase duhet të pyesnit Gjeneralin Çeku.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E kuptoj
19 plotësisht.

20 Vazhdojmë me paragrafin 21 të deklaratës. Në këtë pikë
21 thuhet, me datë 10 qershor ditën pas Marrëveshjes së
22 Kumanovës, ditën, pra, pasi u nënshkrua Marrëveshja e
23 Kumanovës, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi
24 Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
25 1244. Dua t'i kthehem përsëri Marrëveshjes së Kumanovës që

1 është nënshkruar me datë 9 qershor. Pyetja që kam për ju është
2 kjo: A e dini kush e ka negociuar dhe kush e ka nënshkruar
3 këtë marrëveshje në emër të NATO-s, nga njëra anë, dhe në emër
4 të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së
5 Serbisë, nga ana tjetër?

6 PË. Nga ana e NATO-s e ka nënshkruar Gjenerali Jackson.
7 Ndërkohë që nuk më kujtohet kush ka qenë ushtaraku nga ana e
8 Serbisë që ka nënshkruar dokumentin.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por ju kujtohet që ka qenë
10 një oficer ushtarak që e ka nënshkruar në emër të palës
11 tjetër, apo jo?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në qoftë se unë them që ka
14 qenë Gjenerali Nebojsa Pavkovic, do ju çudiste kjo gjë ju?
15 PY. Nuk më kujtohet. Nuk e di, por ky është informacion
16 publik, mund të gjendet lirisht besoj. Është një marrëveshje
17 që ka nënshkrim -- unë nuk kam parë këtë pjesën e
18 nënshkrimeve, bllokun e nënshkrimeve për këtë marrëveshje nuk
19 e kam parë. Duhet të jem i sigurtë. Mbase mund të kem parë
20 pjesë të Marrëveshjes së Kumanovës por jo bllokun e
21 nënshkrimeve.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është e vërtetë që ky është
23 informacion publik, por është një pyetje e rëndësishme, kështu
24 që, domethënë pyetja që ju bëra, në qoftë se e dini që
25 nënshkrimi e ka bërë një oficer ushtarak dhe jo politikan

1 është pyetje e rëndësishme për ne, ju e thatë këtë gjë, apo
2 jo, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 21 të dëshmisë
5 që i keni dhënë Mbrojtjes së Thaçit juve i jeni referuar
6 paragrafit 9 të Rezolutës 1244 ku thoni, që në të thuhet,
7 "vendosën që përgjegjësitë e pranisë së sigurimit ndërkombëtar
8 do të vendosen dhe do të veprojnë në Kosovë dhe këtu do
9 përfshihen si pika demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të
10 Kosovës dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të
11 Kosovës sikurse kërkohet në paragrafin 15", të Rezolutës.

12 Z. Duncan, a mund të shpjegoni ku thuhet "grupe të tjera
13 të armatosura shqiptarëve të Kosovës", për kë flitet?

14 PË. Kryesisht për FARK-un, të nderuar Gjykatës. Ishte -- ky
15 ishte grupi tjetër kryesor. Është e mundur që synimi mund të
16 ketë qenë që të përfshiheshin edhe forca të tjera më të vogla
17 të parregullta dhe do të kishte kuptim që të përfshiheshin dhe
18 forcat të tilla.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtu doja të dilja dhe unë.
20 A kishte forca të tjera të vogla, domethënë forca shqiptare të
21 vogla të armatosura që operonin në Kosovë rreth asaj kohe?
22 Domethënë, në vitin 1999, në verë të këtij viti; në goftë se e
23 dini.

24 PË. Me sa di unë kanë qenë ato që quheshin ndryshe grupe
25 mbrojtëse në nivel fshati që nuk ishin të strukturuar, nuk

1 ishin pjesë e asnjë strukture të organizuar.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në paragrafin
3 22 të deklaratës që i keni dhënë Mbrojtjes, përmendet
4 paragrafi 15 i Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 dhe
5 citoj; ky paragraf kërkonte "që UÇK-ja dhe grupe të tjera të
6 armatosura të shqiptarëve të Kosovës dhe të gjitha veprimet
7 ofensive të respektonin kërkesat për demilitarizim sikurse ato
8 ishin parashtruar nga shefi i prezencës së sigurimit
9 ndërkombëtar në konsultim me përfaqësuesin e posaçëm të
10 Sekretarit të Përgjithshëm."

11 Pyetja që kam për ju është e ngjashme me atë që ju bëra
12 pak më përpara. A kishte grupe të tjera të armatosura të
13 shqiptarëve të Kosovës që kryenin veprime ushtarake ofensive
14 në atë kohë, domethënë në verë të '99-s përveç UÇK-së?
15 PË. Përgjigja është e njëjtë si më parë, domethënë, ishin dy
16 grupe kryesore: njëri ishte UÇK-ja; tjetri ishte FARK-u dhe
17 kishte gjithashtu edhe disa grupe të vogla të parregullta në
18 nivel lokal, në nivel fshatrash. Megjithatë, këto ishin shumë
19 të vështira për t'u identifikuar. Kështu që gjithësi, duke
20 pasur parasysh zhvillimet ishte absolutisht normale që të
21 ekzistonin edhe grupe të tilla.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini në qoftë se FARK-u
23 ka kryer veprime ushtarake në Kosovë ose operacione ushtarake
24 në Kosovë në verën e vitit 1999?

25 PË. Kanë kaluar kaq shumë vite, të nderuar Gjykatës, kështu

1 që nuk di të them. Do më duhet që të shoh raportet e asaj
2 kohe; nuk jam në gjendje t'i përgjigjem pyetjes.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj plotësisht, nuk ka
4 problem. Një pyetje të fundit përpara sa të bëjmë pushimin e
5 drekës. Në paragrafin 26 ose të paktën sipas paragrafit 26 të
6 deklaratës që i keni dhënë Mbrojtjes së Thaçit, pra, kjo është
7 intervista që keni dhënë në gusht të 2025-s dhe kështu citoj.
8 Ju thoni që keni qenë "në dialog të rregullt me kolegët tuaj
9 në Londër për disa muaj lidhur me nevojën për një angazhim më
10 të ngushtë me lidhësin kosovar sa i takon skenarëve pas
11 konfliktit".

12 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, kjo është e saktë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, kë mendonit ju që
15 ishte lideri ose lidhësi i Kosovës në atë kohë kur keni
16 qenë në dialog të rregullt me kolegët tuaj në Londër? Kë
17 kuptonit ju si lider të Kosovës?

18 PË. Është për të ardhur keq, të nderuar Gjykatës, që NATO-ja
19 nuk ka pasur mundësi që t'i japë raporte ose ndoshta qeveria
20 britanike që të lëshojë raporte për atë periudhë që kishin të
21 bënë me negociatat e marrëveshjes, sepse do kishte qenë shumë
22 e thjeshtë për mua t'i përgjigjesha pyetjeve, po të kishim
23 pasur raporte me shkrim. Megjithatë do të mundohem që t'ju
24 them atë çka më kujtohet.

25 Në atë bisedë, në ato diskutime, ka qenë pjesë e

1 diskutimeve në NATO në Këshillin e Atlantikut Verior lidhur me
2 objektivin, sepse ishim drejt fundit të luftës dhe ideja ishte
3 se çfarë do të bënim më pas. Domethënë do kishim protektoratin
4 e UN-it e Kombeve të Bashkuara? A do ta stabilizonin situatën
5 edhe në fakt siç kishte thënë -- siç ishte thënë, domethënë,
6 dhe në deklaratat të mëparshme të UNSCR-së që të lejoheshin
7 serbët që të ktheheshin. Dhe ndërkohë ishte e vështirë që të
8 arrihej ajo pajtueshmëri lidhur me këtë.

9 Dhe në korrespondencën time me kolegë të lartë në Londër,
10 unë kam insistuar lidhur me këtë. Domethënë është e
11 rëndësishme që të sqarohet kjo se çfarë do të bëhet, sepse
12 ushtria është vërtet në një vështirësi reale sepse është e
13 pamundur për ta për të planifikuar pas pages, vendosjes së
14 pages, derisa të dihet se çfarë do bëni ju. Pra, mund të
15 krijohej një lloj kushti pageje, por kjo nuk është kaq e
16 thjeshtë edhe për t'u mbajtur, sepse mund të ekzistojë
17 mundësia që të përkeqësohet situata. Kështu që për këtë arsye
18 është e rëndësishme që të shpreheni lidhur me atë çfarë do të
19 bëhet.

20 Dhe jo vetëm kaq, por në këtë kontekst unë i kam bërë
21 thirrje atyre që të flisnin me lidërshtipin e Kosovës siç
22 kuptohej lidërshtipi i Kosovës sipas Rambujesë. Pra, duhej që
23 të flisnin me Rugovën me LDK-në, me z. Thaçi, me persona të
24 tjerë që kishin qenë të përfaqësuar në Rambuje ose si
25 përfaqësues ose ndërlidhës të udhëheqësve të shoqërisë

1 demokratike të Kosovës. Pra, të shoqërisë shqiptare të
2 Kosovës.

3 Domethënë kjo është ajo çfarë ju kam kërkuar unë kolegëve
4 të mi në Londër që t'ju bëhej thirrje aleatëve që të kishin
5 një lloj dakordësie lidhur me rezultatin fundor për të cilin
6 ne po luftonim që të realizohej.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Duncan. Do
8 bëjmë pushimin e drekës që e keni merituar plotësisht.
9 PË. Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do bëjmë
11 pushimin e drekës deri në orën 14.30. Ju lutem mos flisni me
12 askënd lidhur me dëshminë tuaj, Dëshmitar. Znj. Asistente
13 nxirreni dëshmitarin nga salla.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
16 pushim deri në orën 14.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

18 --- Seanca rifillon në orën 14.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni
20 dëshmitarin në sallë ju lutem.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përpara se
22 të vijë dëshmitari nuk di nëse mund ta ndihmojmë këtë
23 dëshmitar nëse paragrafët të cilëve ju referohemi mund t'i
24 vendosim dhe në ekran që t'i lexojmë në të njëjtën kohë. Ju
25 takon juve, po më duket, se mesa dimë ne për këtë dëshmitar,

1 më mirë do ishte.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
4 me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

6 Mirë se erdhët dhe një herë, z. Duncan. Shpresoj të keni
7 patur një drekë të këndshme.

8 PË. I nderuar Gjykatës, desha të isha i sigurtë nëse më
9 pyetët për praninë time fizike në Kosovë pas përfundimit të
10 luftës apo jo?

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

12 PË. Pas përfundimit të luftës unë vendosa kontakte me Wendy
13 Gilmour dhe me kolegët e tjerë që tregon se sa herë kam qenë
14 fizikisht atje.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e
16 tjera kanë të bëjnë me paragrafin 32 të paragrafit tënd, por
17 keni identifikuar një numër sfidash mes të tjerave faktin që
18 forcat e NATO-s do të fillonin të dislokoreshin në datën 12
19 qershor 1999, ndërkohë që forcat serbe do të largoheshin
20 brenda 21 qershorit. A të kujtohet?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, dua të pyes,
23 forcat serbe a e zbatuan afatin e 21 qershorit, pak a shumë?

24 PË. Me sa di unë po. Po përpigem të mendoj nëse ka patur
25 ndonjë problem në veri afër kufirit. Ka patur ca gabime si të

1 thuash apo mendësi të gabuara në atë kohë. Po më duket se pak
2 a shumë janë kaluar.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur flisnit për kufirin e
4 kishit fjalën për kufirin me Kosovën?
5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, pak a shumë forcat
7 serbe ishin larguar, pak a shumë, në datën 21 qershor?
8 PË. Po.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se ku kanë shkuar
10 forcat serbe? Kanë shkuar në kazermat e tyre në Serbi apo kanë
11 qëndruar në afërsi të kufirit me Kosovën?
12 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se ku kanë shkuar, po e kanë
13 zbatuar angazhimin e tyre dhe kjo kishte rëndësi.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Duncan,
15 sipas paragrafit 41 të deklaratës suaj për palën mbrojtëse, ju
16 thatë sugjerimi që UÇK-ja ishte organizatë e disiplinuar,
17 hierarkike nën kontroll të plotë politik u hodh poshtë nga
18 Gjenerali Çeku në takimin e parë thelbësor, siç e quani ju, më
19 15 qershor 1999. Atë kohë kur z. Çeku iu informoi juve se
20 Hashim Thaçi nuk ishte i disponueshëm në atë moment dhe tha se
21 UÇK-ja, autoritetet politike të UÇK-së do të duhet të
22 konsultoheshin, po edhe se ai nuk negocionte dot mbi asnjë
23 dokument pa praninë e komandantëve të zonave apo të rajoneve.

24 A të kujtohet që e ke thënë këtë gjë palës Mbrojtëse?
25 PË. Po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përveç z. Thaçi a donte të
2 konsultonte ndonjë njeri tjetër nga politike e UÇK-së z. Çeku,
3 a përmendni ndonjë njeri në përgjithësi?

4 PË. I nderuar Gjykatës, jo nuk ka përmendur askënd tjetër.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dua të kaloj
6 në paragrafin 15 të deklaratës suaj ku keni diskutuar sipas
7 dokumentit që ka përgatitur pala mbrojtëse për intervistën
8 tuaj, raundi i dytë i diskutimeve në selinë e UÇK-së në Kosovë
9 më 19 qershor 1999 dhe ju keni dhënë dëshmi dhe para nesh për
10 këtë takim.

11 Dhe sipas këtij dokumenti që kam unë përpara, ju thatë se
12 z. Thaçi iu bashkua ju për herë të parë dhe James Rubin,
13 Ndihmëssekretari i Shtetit në Shtetet e Bashkuara për këto
14 diskutime, është e saktë kjo?

15 PË. Po, i nderuar Gjykatës.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na shpjegoni se
17 përse ndodhi një gjë e tillë, cili ishte synimi i pjesëmarrjes
18 në këtë takim nga ana e z. Thaçi?

19 PË. Pala kosovare e ftoi. Nuk thamë ne që donim praninë e z.
20 Thaçi. Ne kishim organizuar të takoheshim sërish. Ju dëgjuat
21 Gjeneralin Reith duke folur për urgjencën që të takoheshim
22 sërish dhe kur ramë dakord për këtë takim dhe kur na u bashkua
23 neve z. Rubin dhe kolegët e tij, ne shkuam atje dhe gjetëm z.
24 Thaçi. Ne nuk kishim rol në ftesën që i dërguan atij apo nuk
25 thamë që ishte i ftuar.

1 Unë mendoj që ju thatë apo nënkuptuat në pyetjen tuaj të
2 mëparshme se nëse do të duhej të konsultohesh për shkak të
3 afatit të shkurtër që kishim ne në dispozicion, mirë që ishte
4 atje. Ishte më kollaj që të konsultohesh për anën politike në
5 qoftë se ndodheshin në atë dhomë, që ata t'i luanin të gjitha
6 ato kartat politike që dëshironin. Dhe unë prandaj e ndalova
7 takimin për shkak se ata po bënë kërkesa maksimale që donin
8 që në këtë marrëveshje të kishte deklarata politike.

9 Ja kjo është gjeneza e pranisë së z. Thaçi në këtë
10 diskutime.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Duncan, kjo
12 më çon tek pyetja ime pasardhëse, pra, komenti që ti bërë
13 lidhur me faktin që ti e ndalove takimin, siç thuhet në
14 paragrafin 51, siç thuhet këtu, takimi me -- ju ndaluar
15 diskutimet kryesore për takim privat me lojtarët kyç, si të
16 thuash, në të cilin treguat rëndësinë e kësaj për Kosovën si
17 një hap i rëndësishëm drejt një Kosove të pavarur.

18 Me kë, kush ishin këta lojtarët kyç pra, këta
19 pjesëmarrësit kyç me të cilët bisedove ti në takimin privat?
20 PË. Faleminderit. Nga ana jonë ishte Gjenerali Reith, unë,
21 James Rubin, ne të tre. Dhe nga pala kosovare ishte Gjenerali
22 Çeku, z. Thaçi dhe, besoj, se edhe z. Krasniqi.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Jakup Krasniqi?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më duket se iu

1 përgjigje kësaj kur i dhe përgjigje pyetjes së Prokurorit, kur
2 the që asnjëri prej komandantëve të zonave apo të rajoneve nuk
3 ishin të pranishëm në këtë takim, kështu është?

4 PË. Po, i nderuar Gjykatës. Është e saktë. Unë doja që të
5 kishim mundësi të bisedonim me tre personat më aktivë në
6 diskutim, ata që në mënyrë të pavarur të flisnin me varësit e
7 tyre të krahut politik apo ushtarak pasi biseda me të gjithë
8 këta në një seancë, pak a shumë, plenare, mund të çonte në
9 keqkuptimin, do t'i jepte atyre mundësinë që të vazhdonin të
10 hapnin debatin që në fakt dhe e bënë një gjë të tillë.

11 Dhe për të mos minuar autoritetin e tyre, unë iu kërkoja
12 gjithë të tjerëve që të largoheshin, me qëllim që të kishim
13 një shkëmbim të sinqertë mendimesh, siç njihet. Dhe seancë
14 gjatë së cilës unë ngula këmbë dhe thashë që nuk mund të
15 vazhdonte një gjë e tillë dhe arsyet se përse nuk mund të
16 vazhdonte dhe ua lashë atyre në dorë që të shkonin te kolegët
17 dhe vartësit e tyre për të shpjeguar se cila ishte gjendja
18 reale.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Siç e thatë dje, z. Duncan,
20 të gjithë u larguan me përjashtim të këtyre personave që
21 përmendët ju, kështu është?

22 PË. Korrekt. E saktë, i nderuar Gjykatës.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje, gjatë përgjigjes së
24 pyetjes së Prokurorit, në faqen 128 të transkript tonë thotë
25 se nuk keni dijeni për asnjë rregullore të brendshme të UÇK-

1 së, kështu është?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Megjithatë, z. Duncan, po të
4 pyes a kishit dijeni ju nëse kishte ndonjë rregull që me anë
5 të së cilit të kërkohej miratimi nga ana e komandantëve
6 rajonalë përpara se të arrihej në marrëveshje?

7 PË. A po flasim për rolin e komandantëve rajonalë?

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, komandantët rajonalë apo
9 lokalë siç i keni quajtur juve.

10 PË. Nëse e kam kuptuar si duhet pyetjen tuaj, unë nuk kisha
11 njohuri për ekzistencën e ndonjë dokumenti zyrtar i cili të
12 kërkonte praninë e tyre. Unë u bazova në diskutimin që kishim
13 me gjeneralin Çeku, i cili tha që prania e tyre ishte
14 thelbësore dhe unë i besova atij.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Dhe nuk ishte
16 vetëm prania e komandantëve të zonave apo të rajoneve, por
17 kërkesa që ato duheshin konsultuar apo që duhej marrë miratimi
18 i tyre?

19 PË. Nëse e kam kuptuar si duhet, i nderuar Gjykatës, këtu
20 bëhet fjalë për ndryshimin mes fjalës konsultim dhe
21 pjesëmarrje. Gjenerali Çeku më tha që komandantët e zonave
22 duhet të merrnin pjesë në diskutim. E dyta, që duhej
23 konsultuar krahu politik. Dhe këto janë dy gjëra të ndryshme.
24 E para, pjesëmarrja ishte thelbësore për komandantët e zonave
25 dhe autoritetet politike do të duhej të konsultoheshin.

1 Dhe, në fakt, kjo ishte e plotkuptimtë për mua. Edhe unë
2 e kuptova se përse e bëri kur bëri një kërkesë të tillë.

3 Shpresoj t'i jem përgjigjur pyetjes suaj.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbase nuk isha unë i qartë.
5 Pyetja ime kishte të bënte nëse ekzistonte një kërkesë formale
6 zyrtare për të konsultuar komandantët ose për të marrë
7 miratimin e tyre?

8 PË. Nuk kam pasur dijeni mbi një gjë të tillë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kam dhe nja dy
10 pyetje lidhur me bllokun e firmave të marrëveshjes angazhuese.
11 Dje në faqen 55 të transkriptit, thatë se i kishit kërkuar
12 ministrit të jashtëm Robin Cook më datën 18 qershor 1999 që të
13 kontaktonte z. Thaçi që ta mbështeste marrëveshjen që ishte
14 negociuar në Kosovë. A të kujtohet që i thatë një gjë të tillë
15 gjatë ditës së djeshme?

16 PË. Po. Nuk thashë unë e bëra një gjë të tillë. Thashë "ne".

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur them "ju" e kam fjalën
18 për juve në shumës.

19 E qartë. Pyetja ime është: Unë mendoj që një gjë e tillë
20 është me rëndësi për juve pasi ju - jo ti personalisht - keni
21 kontaktuar ministrin e jashtëm britanik Robin Cook që ai të
22 kontaktonte z. Thaçi. Përse ishte e rëndësishme që këtë
23 marrëveshje ta mbështesë z. Thaçi sa u përket juve?

24 PË. Nuk krejt -- pjesa e parë nuk është krejt e saktë. Pastaj
25 do i përgjigjem pjesës së dytë. Ajo që bëra unë është që folëm

1 me zyrën e Kryeministrit Tonny Blair dhe ata i kërkuan z. Cook
2 që të telefononte z. Thaçi. Dhe kjo pasi zbuluam se kishte
3 bisedime paralele nga Shtetet e Bashkuara në diskutimet e
4 zhvilluara në Lubjanë Jamie Rubin dhe Larry Rossin, të cilët i
5 përmendin dëshminë që dha këtu. Pra, ishte një si të thuash
6 një bisedë paralele dhe ne donim që ajo të mos ndërhynte në
7 punën tonë, në qoftë se ata ishin të angazhuar me z. Thaçi ne
8 donim të shtonim zërin tonë në këto përpjekje që t'u kërkonim
9 atyre që të ndalonin këto bisedime paralele, që ata të vinin
10 dhe të na bashkoheshin neve si pjesë e bisedimeve.

11 Dhe kjo e ka nxitur atë që të vijë dhe të na bashkohet
12 neve dhe të tregohet konstruktiv, që ishte konstruktive dhe kjo
13 ishte arsyeja se përse e bëmë një gjë të tillë dhe me ta.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani të flas
15 për bllokun e nënshkrimeve. Në paragrafin 60 dhe këtë e keni
16 përsëritur dhe në sallë disa herë, thuhet që z. Thaçi nuk mund
17 të nënshkruante në cilësinë e tij si kryeministër për shkak se
18 NATO dhe komuniteti ndërkombëtar nuk e njihnin Qeverinë e
19 Përkohshme të Kosovës. Ajo që dua të di nga ju është nëse z.
20 Thaçi donte ta nënshkruante këtë marrëveshje në cilësinë e tij
21 si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

22 PË. Po bëni pyetje shumë të hollësishme për negociatat që
23 kanë zgjatur 13 orë që është edhe dyta për nga gjatësia për
24 gjatë gjithë karrierës sime. Po përpiqem të kujtoj se çfarë ka
25 ndodhur ekzaktësisht. Nëse më kujtohet si duhet - dhe nëse

1 keni prova të tjera mund të më korrigjoni - ne na thanë që
2 duhet të nënshkruante z. Thaçi dhe jo Gjenerali Çeku. Dhe
3 përgjigja jonë ishte se "Nëse e doni këtë gjë, jemi të gatshëm
4 ta pranojmë një gjë të tillë, por ne nuk do ta pranojmë këtë
5 në cilësinë e tij si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme
6 pasi do të minonte të tërë operacionin". Dhe prandaj arritëm
7 në kompromisin që kemi diskutuar në dy ditët e shkuara.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse na ndihmon. Pasi dje në
9 faqen 99 të transkriptit tonë, rreshtat 15 deri në 17, ju
10 thatë:

11 "... kur u propozuan ne e bëmë të qartë se nuk mund të
12 nënshkruajë në cilësinë e tij si kryeministër ..."

13 Dhe prandaj po pyes, kush e kishte -- nga kush erdhi ky
14 propozim, nga z. Thaçi a person tjetër?

15 PË. Për gjuhën komandant i përgjithshëm apo për firmën?

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që u nënshkrua që ai do ta
17 nënshkruante?

18 PË. E kjo erdhi nga palë e Kosovës. Mund të ndihmoj të
19 kuptojmë kontekstin, i kthehemi çështjes se pse e ndalova unë
20 takimin.

21 Gjatë gjithë këtyre 13 orëve, z. Thaçi dhe z. Krasniqi, u
22 përpoqën që ta ndryshonin deklaratën, këtë marrëveshje. Ata e
23 bënë në mënyrë të qartë që tregonte se dëshironin të ndikonin
24 që ky dokument në mënyrë të tërthortë të ishte pranimi i
25 Kosovës.

1 Dhe i kemi thënë që "Ne nuk mund ta pranojmë këtë gjuhë"
2 dhe kemi shpjeguar përsëri dhe kjo ka vazhduar gjatë gjithë
3 kohës derisa ndalum bisedimet, derisa i ndalova bisedimet.
4 Pra, mund të shihet megjithëkëtë sekuencë se çfarë dëshironte
5 të bënte ai dhe përse ne e thamë se "Nuk mund të bëhet që
6 duhet të vazhdojmë këtë dhe këto ndryshime me amendamente
7 politike" pasi duhet të jenë shumë të vështira, shumë të
8 vështira dhe, në fakt, nuk është kjo mënyra se si, është
9 mënyrë e vështirë për ta bërë një gjë të tillë pasi kjo ishte
10 një angazhim nga ana e tyre dhe ne po u tregonim atyre se
11 çfarë duhet të fusnin në dokumentin e tyre.

12 Pra, ishin diskutime intensive shumë të gjata.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, për herë të
14 fundit, a kam të drejtë kur them që juve nuk ju kujtohet se
15 kush ka ardhur me propozimin për të futur frazeologjinë
16 Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së?

17 PË. Keni korrekt. Unë po përpiqesha të shpjegoja historikun e
18 këtij momenti se kush propozoj që të ishte ai dhe çfarë
19 gjuhe të përdorte. Dhe pas 26 vitesh kaq mund të shpjegoj apo
20 nuk shpjegoj. Pra, kaq mund të shpjegoj pas 26 vitesh.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më korrigjo nëse e kam
22 gabim, po ky propozim erdhi nga pala e UÇK-së, kështu është?

23 PË. Nga pala kosovare.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga ana kosovare. Dakord.

25 Faleminderit.

1 Nja dy pyetje të shkurtra për paragrafin 69 të deklaratës
2 suaj ku thatë gjatë -- dhe keni thënë edhe gjëra të ngjashme
3 edhe këtu në sallë dje dhe besoj edhe sot, kur thatë që z.
4 Thaçi ishte si enigmë për juve. Sipas paragrafit 69 të
5 deklaratës për palën mbrojtëse, ju i thatë palës mbrojtëse që
6 disa prej vendimeve politike apo mungesën e informimit politik
7 nga ana e tij, i patë si ishin, ju nuk i kuptonit dot. A mund
8 të na tregoni një shembull të vendimeve politike të z. Thaçi
9 që nuk i kuptoni dot?

10 PË. I nderuar Gjykatës, ishte mungesa e vendimeve sesa
11 vendimi, të nderuar Gjykatës. Nëse më kujtohet si duhet, unë i
12 tregova disa herë, e përgatita disa herë Gjeneralin Wesley
13 Clark për takimet me z. Thaçi. Dhe jam i sigurtë që janë
14 takuar në kuintat të Rambujesë. Mund ta kem gabim pasi nuk
15 ishim të lejuar që të shkonim atje, po jam i sigurtë që kanë
16 marrë pjesë atje. Unë nuk kam marrë pjesë vetë atje. Pastaj z.
17 Thaçi erdhi në selinë tonë në SHAPE.

18 Dhe ne e informuam atë në atë rast, më pas edhe pas
19 konfliktit e kam përgatitur atë për takimet të cilat i kemi
20 parë edhe në seancë private. Gjatë gjithë kësaj periudhe, unë
21 e kam përgatitur gjatë gjithë kohës atë se z. Thaçi dhe UÇK-ja
22 në një farë mënyre duhet të grumbullonin rreth vetes grupe
23 njerëzish të cilët kishin qenë pjesë e udhëheqësisë së
24 Kosovës, LDK-në, Rugovën e të tjerë që ai do të duhej të
25 bashkëpunonte me ta.

1 Dhe pavarësisht se në të ashtuquajturën qeveri të Kosovës
2 kishte vend edhe për ata, ajo asnjëherë nuk u bë realitet. Ne
3 vazhduam të përsërisin të njëjtën gjë herë pas here.
4 Politikisht kjo është e qartë se duhet ta bënte një gjë të
5 tillë. Një njeri me dimensionin e tij politik që kishte duhet
6 ta dinte vetë një gjë të tillë. Nuk kishte nevojë që ne t'ia
7 thonim një gjë të tillë. Dhe nëse nuk e bënte dot një gjë të
8 tillë duhet të na shpjegonte se pse nuk e ka bërë dhe këtë nuk
9 e ka bërë kurrë.

10 Dhe kjo më dukej enigmë, unë kam kaluar gjithë jetën duke
11 folur me zyrtarë të lartë dhe politikan të lartë. Kam qenë me
12 sekretari privat i dy ministrave dhe kishte arsye se pse e
13 bënin një gjë të tillë dhe prandaj mu duk e enigmë sjellja e
14 tij.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe disa pyetje, tre-katër
16 për më shumë vizita që ke bërë në Kosovë dhe të cilat i
17 përmende në fillim, të cilat i përmenda dhe unë në fillim të
18 këtyre pyetjeve.

19 Në qershor të 1999-s dhe, thuhet këtu në paragrafin 74 të
20 deklaratës suaj, ti e shoqërove Komandantin Suprem të Forcave
21 Aleate në Evropë në Pejë dhe në Mitrovicë, pra, më 6 korrik
22 1999, sipas deklaratës suaj. Dua të di sa keni qëndruar në
23 Pejë? Ishte një takim ditor?

24 PË. Po, i nderuar Gjykatës. Ishte pjesë e një udhëtimi prej
25 një ditor. Pra, pjesa e parë, më duhet të shoh raportin për ta

1 freskuar memorien se si ka qenë, por ka qenë një takim, një
2 vizitë ditore që është kaluar pjesërisht në Mitrovicë, si
3 pjesërisht në Pejë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 75 të
5 deklaratës suaj, thoni që keni vënë re dëmtimin e ndërtesave
6 në Pejë, që kishte shumë mullarë dhe ndërtesa nëpër ferma që
7 ishin të shkatërruara apo të djegura dhe aty thuhet në qytet
8 dhe thuhet:

9 "... janë shtëpi që private të shqiptarëve dhe blloqet e
10 apartamenteve të cilët ishin rrënoja ..."

11 Kështu është?

12 PË. Po, i nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja që kam unë është si e
14 dije ti që këto ishin shtëpi shqiptarësh, cila është baza e
15 njohurisë tënde?

16 PË. Baza ishte lloji i dëmit të bërë dhe prej sa kohës ishte
17 bërë. Unë shihja shtëpitë e serbëve të cilat digjeshin kur unë
18 isha atje. Shiheshin edhe ndërtesat e tjera të cilat ishin
19 djegur në mënyrë sistematike nga një periudhë e mëhershme. Dhe
20 në fakt unë kisha parë edhe raportet e asaj që kishte ndodhur
21 në Pejë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Duncan. Iu
23 përgjigjët pyetjes sime të dytë që ishte se si e dije ti që
24 janë djegur shtëpitë e serbëve. Siç e thashë, iu përgjigjët
25 kësaj pyetjeje. Faleminderit.

1 Mund të kaloj tani në paragrafin 79 të deklaratës suaj.

2 Sipas këtij paragrafi, Thaçi i ka treguar një deklaratë Clark
3 në të cilin ai trajtoji çështjen e dhunës në Kosovë të cituar
4 në gazetën Shekulli e datës 14 gusht 1999. Dhe me sa di unë
5 kjo është prova materiale 1D387 dhe kjo është sa për
6 procesverbal, procesverbalin tonë të brendshëm. Në këtë
7 dokument, Gjenerali Clark citohet të ketë thënë që:

8 "Unë", i referohet Gjeneralit Clark "Nuk do të veçoj
9 përfaqësim me UÇK-në. Udhëheqësi i tyre ka qenë bashkëpunues
10 me ne në nivele të larta."

11 Z. Duncan, a keni ndonjë ide se për kë e ka fjalën

12 Gjenerali Clark kur thotë udhëheqësi i UÇK-së?

13 PË. Jo. Është një deklaratë shtypi të tipit të cilave

14 Gjenerali Clark, tipi i deklaratës së cilës Gjenerali Clark e
15 ka bërë edhe më vonë. Dhe shpesh më kthehej mua dhe më pyeste
16 "Si ishte? Ishte mirë?". Kur fliste më shtypin ishte paksa
17 nervoz ndonëse i duhej të fliste shumë shpesh.

18 Dhe ka shumë paqartësi që futen në një krah të shtypi kur
19 je nervoz del përpara shtypit, kështu që nuk e kam idenë se
20 për kë e ka fjalën në këtë rast.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në të njëjtin
22 dokument, apo sipas të njëjtit dokument, Gjenerali Clark
23 shpjegoi se në shumicën e rasteve dhuna duhet parë si spontane
24 kryesisht në jug të Kosovës, ku është e lidhur me krimin e
25 organizuar. Kështu thuhet të jetë shprehur apo t'i ketë thënë

1 shtypit Gjenerali Clark. A të kujtohet ju një gjë e tillë?

2 PË. Po, i nderuar Gjykatës.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Duncan, ju thatë

4 Mbrojtjes sipas paragrafit 80 të deklaratës suaj, që jeni

5 dakord me vlerësimin e Gjeneralit Clark. Me fjalë të tjera a

6 besoni që dhuna në jug, kryesisht në jug të Kosovës i

7 atribuohet krimit të organizuar dhe, nëse po, cila është baza?

8 PË. Unë mendova se ishte një deklaratë e saktë me sa kishim

9 dijeni ne dhe kjo është e bazuar në informacionin që na vinte

10 nga komandantët e KFOR-it dhe burimet e tjera.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më duket se na duhet të

12 kalojmë në seancë private për të mbrojtur interesat e ofruesit

13 të informacionit sipas rregullës 107, ju lutem.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 122

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Duncan, kam

25 edhe disa pyetje të fundit që lidhen me seancën përgatitore me

1 Mbrojtjen, me ekipin e Mbrojtjes së Thaçit, në 12 dhe 17
2 shtator 2025, pra, javën e kaluar. Gjatë seancës përgatitore,
3 por edhe dje, besoj se dje e thatë këtë në Gjykatë, ju treguan
4 deklaratën e një personi Anthony Quinn, deklarata e
5 dëshmitarit të Anthony Quinn që ishe i Policisë Metropolitane
6 Mbretërore të Anglisë dëshmi që ia kishte dhënë Gjykatës së
7 Lartë në Angli.

8 Po pohoni me kokë?

9 PË. Po, po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas paragrafit 14 të
11 shënimit, që është përgatitur nga ekipi i Mbrojtjes së Thaçit
12 për seancën përgatitore, thuhet se ju kanë treguar disa
13 paragrafë, po veçanërisht paragrafin 17 dhe 24 të deklaratës
14 së këtij dëshmitari të z. Quinn pra, dhe keni konfirmuar se
15 nuk ka pasur Prokurori asokohe në Kosovë, në verën e 1999-s ma
16 merr mendja e keni pasur fjalën?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe se ka pasur raportime
19 nga KFOR-i që tregonin se grupe kriminale të organizuara nga
20 Shqipëria po përpiqeshin të hyjnë në Kosovë gjatë vakumit të
21 verës 1999 dhe ishin një problem shumë i madh, që ishte në
22 fakt diçka që sapo thatë edhe para pesë minutash.

23 A ju kujtohet sipas këtij raporti që keni lexuar ju, kur
24 ka filluar kjo? Këto grupe kriminale të armatosura ose të
25 organizuara do të themi, këto grupe të organizuara erdhën nga

1 Shqipëria, erdhën menjëherë pasi u larguan forcat serbe apo më
2 vonë në kohë?

3 PË. Nga sa kujtoj unë, kanë ardhur bashkë me refugjatët që po
4 ktheheshin në Kosovë. Mes tyre kishte dhe elementë të krimit
5 të organizuar që u përzjenë me ta. Në këtë periudhë që po
6 tërhiqeshin forcat serbe, aktualisht hynin refugjatët por mes
7 tyre kishte edhe elementë të krimit të organizuar. Kështu e
8 kam kuptuar unë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të jeni
10 edhe më konkret lidhur me këtë grupe të krimit të organizuar
11 çfarë krimesh ishin këto, çfarë krimesh u kryen këto ditë?

12 PË. Bëhet fjalë, tani të përshkruash krimin e organizuar
13 shqiptar është e vështirë. Ishin grupe personash shumë aktivë
14 asokohe. Ata kishin rreth 40 për qind të prostitucionit në
15 Evropën Perëndimore, pra, bëhet fjalë për trafikim lëndësh
16 narkotike, bëhet fjalë për trafikim armësh, mbase në këtë rast
17 nuk ishte prostitucioni, po bëhet fjalë për gjithë spektrin e
18 krimit të organizuar.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po trafikimi i qenieve
20 njerëzore?

21 PË. Padyshim dhe trafikim të qenieve njerëzore.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto krime shënjestronin
23 ndonjë grup të caktuar, për shembull, synonin vetëm serbët apo
24 vetëm popullatën rome apo shqiptarët e Kosovës, kishin ndonjë
25 shënjestër të caktuar?

1 PË. Këta njerëz të paskrupujt. Kë të mundnin, kë të gjenin,
2 kë të mundnin, shfrytëzonin çdo mundësi dhe çdo person që
3 mundnin.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Duncan për
5 durimin tuaj. Unë kaq pyetje kisha për ju.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
7 Mettraux.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, z. Duncan. Lajm
9 i keq për ju, z. Duncan, është se dhe un kam pyetje, por
10 shumica e pyetjeve janë trajtuar sot. Kështu që kanë ngelur dy
11 fusha që do të doja t'i trajtoja më shumë së bashku.

12 Si fillim do t'i kërkoj Zyrës Administrative të nxjerrë
13 në ekran provën P113 dhe veçanërisht faqen 008559.
14 Faleminderit.

15 Z. Duncan, shikoni në fund të faqes.

16 A ju kujtohet që këtë dokument t'ua ketë treguar
17 Prokuroria?

18 PË. Po, më duket se sot e kam parë këtë dokument.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pretendohet se është një
20 dekret numër 84/99, 28 prill 1999. Nënshkruar nga Kryeministri
21 Hashim Thaçi në emër të Qeverisë së Përkohshme së Kosovës
22 përmes së cilit emëron z. Agim Çeku si shef të Shtabit të
23 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E shihni?

24 PË. Ku është? Po e pashë, e pashë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se ju e përshkruat

1 dje në fakt, është në transkriptin e ditës së djeshme dhe ju
2 thatë sipas perceptimit tuaj dhe sipas jush kjo është thjesht
3 një propagandë, kështu?

4 PË. Nuk jam i sigurtë nëse është propaganda fjala e duhur në
5 fakt por është një vijimësi e një situatë e z. Thaçi dhe
6 kolegëve të tij në aspektin politik që të bindnin publikun që
7 ata ishin personat përgjegjës dhe se UÇK-ja është e organizuar
8 siç duhet, pra, është një organizatë e mirëorganizuar që ka
9 struktura të organizuara mirë të ngritura dhe se është një
10 organizatë profesionale.

11 Është pjesë e strategjisë së komunikimit kjo. Propaganda
12 fatkeqësisht ka një ngjyrim pak më negativ kështu që do
13 preferoja të mos e përdorja këtë fjalë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nëse më
15 lejoni do t'ju bëj një pyetje dhe mund t'ju rifreskoj edhe
16 kujtesën, por ky funksion, ky pozicion që z. Çeku po merr
17 përmes këtij dokumenti si shef i Shtabit të Përgjithshëm të
18 UÇK-së edhe kjo është e njëjta gjë, pra, është e njëjta pozitë
19 që është vendosur poshtë emrit të tij në marrëveshjen e
20 demilitarizimit që patë sot paradite apo jo?

21 PË. Jo, më duket se kemi një paqartësi këtu. Këtu kemi z.
22 Thaçi që shpall se z. Çeku i është dhënë kjo pozitë. Kur u
23 angazhua me z. Çeku, ai nuk u prezantua asnjëherë kështu. Pra,
24 kemi një shprehje mes asaj që ka menduar, pra, kemi një
25 mospërputhje mes asaj që mendonte se kishte z. Çeku dhe çfarë

1 thotë z. Thaçi që i kishte dhënë atij si pozitë. Prandaj
2 kthehem dhe një herë tek komunikimi dhe theksoj, i mëshoj
3 komunikimit në këtë dokument.

4 Dhe mbaj mend që më është treguar dhe një dokument tjetër
5 ku Gjenerali Çeku kishte thënë se ai ishte zgjedhur për të
6 kryer këtë detyrë, detyrën e drejtimit të fushës ushtarake. Ai
7 nuk ka përdorur titullin që ka përdorur z. Thaçi këtu. Këtu e
8 kemi mospërputhjen.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta bëjmë pak më të
10 thjeshtë punën, kështu që vendosim në ekran provën materiale
11 1D99.

12 A ju kujtohet që e patë këtë dokument sot z. Duncan?
13 PË. Po. Ky është kabllogrami i 21 shtatorit.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë më poshtë që të
15 njihemi me dokumentin. A pajtoheni që këtu janë disa dokumente
16 që flitet për tranzicionin e UÇK-së nga procesi i
17 demilitarizimit në KPC? Ju kujtohet? Pra, Trupat e Paqes së
18 Mbrojtjes së Kosovës.

19 PË. Pa e parë dokumentin unë nuk jam i sigurtë se për çfarë
20 deklarata bëhet fjalë këtu.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

22 PË. Po, e kuptova tani për çfarë e keni fjalën.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Titulli është "Deklaratë
24 nga Gjeneral-Lejtnant Gjeneral Çeku, shef i shtabit të UÇK-së.
25 E shihni?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë poshtë në faqe,
3 këtu kemi dy nënshkrime. Në të majtë kemi një që thotë
4 Gjenerali-Lejtnant Agim Çeku, shef i shtabit UÇK. A e shihni
5 këtë.

6 PË. Po, e shoh. E kam parasysh. Dhe dokumenti ka datën
7 shtator edhe në këtë periudhë ai e konsideroj veten shef
8 shtabi.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, do ju ndërpres këtu.
10 Thjesht ma konfirmoni në këtë moment. A është ky i njëjti
11 funksion dhe titull që patë para një çasti, pra, a është kjo e
12 njëjta pozitë që i është dhënë z. Çeku në dokumentin që patë
13 pak më herët? Pajtoheni?

14 PË. Shoh që është çuar në këmbë avokatja.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem
16 mos bëni pyetje sugjestionuese.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund t'i përgjigjeni
18 pyetjes?

19 PË. Ju lutem ma bëni dhe një herë pyetjen.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është ky i njëjti
21 funksion që po shohim këtu, pra, është i njëjti i funksion që
22 ka përdorur z. Çeku për të nënshkruar, a është i njëjti
23 funksion që pamë në shkresën e nënshkruar nga z. Thaçi në
24 dekretin e 20 prillit 1999?

25 PË. Mund t'ju them që është i njëjti titull, po, i njëjti

1 pozicion.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani shohim
3 provën materiale P392.

4 I lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran edhe shqipen.

5 Z. Duncan, është një dokument me dy faqe. Shikoni faqen e
6 parë veçanërisht disa pjesë të caktuara të cilat do t'i
7 trajtojmë së bashku. Po njihuni me dokumentin dhe më pas do të
8 flasim për të.

9 PË. Ju lutem pak më poshtë në faqe.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do kalojmë dhe ke faqja
11 tjetër, z. Duncan. Pra, për një çast do kalojmë në faqen
12 tjetër por fillimisht fokusohemi tek faqja e parë.

13 PË. Patjetër.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë pak në krye të
15 faqes.

16 A kujtohet që sot pasdite më duket, ju bënë pyetje lidhur
17 me raportimin e z. Çeku, pra, kujt i raportonte ai? Ju
18 kujtohet që folët për këtë?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal do të
21 shihni që lënda e këtij dokumenti është raport luftarak. Data
22 24 maj 1999. Pretendohet se burimin e ka nga Ushtria
23 Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm dhe i drejtohet
24 Ministrit të Mbrojtjes, z. Azem Sylja. E shihni këtë?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

2 Edhe tani ju lutem ju jap një çast të njiheni me
3 dokumentin, nëse keni nevojë për më shumë kohë, lirisht na e
4 thoni.

5 PË. Po, e pashë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetjen e parë që kam për
7 ju dhe besoj se ja di përgjigjen, është, a e njihni këtë
8 dokument?

9 PË. S'e kam parë asnjëherë këtë dokument përpara.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me mua dhe,
11 sigurisht mund të komentoni, a pajtoheni që ky është një
12 raport që diskuton aspekte të ndryshme ushtarake dhe operative
13 që lidhen me luftën?

14 PË. Po, kështu duket.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë poshtë dhe do të
16 shohim edhe shqipen që është i nënshkruar nga Agim Çeku.
17 Pajtoheni me mua?

18 PË. Shoh emrin, po. Kështu thuhet këtu.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me mua se këtu
20 z. Çeku e ka nënshkruar dokumentin me të njëjtin titull në
21 cilësinë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm sikurse e pamë në
22 dokumentin e mëparshëm dhe në dekretin e prillit 1999?

23 PË. Në fakt po, pajtohem.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky dokument edhe në këtë
25 rast bëhet fjalë për periudhën kohore përpara nënshkrimit të

1 marrëveshjes që u nënshkrua më 21 qershor 1999, apo jo?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani a e kam kuptuar drejt
4 unë dëshminë tuaj sot se pikërisht këto ishin veprimtaritë që
5 pas 21 qershorit 1999 do të konsideroheshin si aktivitete që
6 shkelnin apo nuk respektonin marrëveshjen?

7 PË. Po, e saktë është kjo.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ndonëse ju e keni
9 kuptuar dekretin si një dekret që sipas jush ky dekret donte
10 të jepte përshtypjen se ekzistonte një strukturë e mirë sa i
11 takon z. Çeku, por ama z. Çeku mendonte se ishte pikërisht
12 roli që ai ka pasur gjatë gjithë kësaj kohe, apo jo?

13 PË. Të nderuar Gjykatës, për mua tani unë kam një pikëpyetje
14 e cila është pse nuk kemi dëgjuar asnjëherë për Shtabin e
15 Përgjithshëm ne, me përjashtim të rasteve të deklaratave, duke
16 përdorur fjalët tuaja, të deklaratave propagandiste dhe ne
17 kishim propozimin për këtë marrëveshje edhe nënshkrimet e para
18 dhe atje Gjenerali Çeku s'e ka përdorur këtë titull?

19 Unë jam në dijeni të faktit se ka ekzistuar një organ që
20 quhej Shtabi i Përgjithshëm që është dhe në aktakuzë dhe më
21 duket se është krijuar më 1994. Tani pikëpyetja për mua është
22 kjo: Çfarë funksioni ka pasur ky organ gjatë konfliktit dhe
23 pse asnjëherë nuk na e ka përmendur as nuk kemi parë ndonjë
24 provë, të paktën mesa kujtoj unë, që të ketë ekzistuar ky
25 organ, ky Shtabi i Përgjithshëm?

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo do të ishte pyetja ime
2 e radhës për ju, z. Duncan. A mësuat ose më saktë a keni parë
3 ndonjëherë ndonjë dokumentacion të Shtabit të Përgjithshëm,
4 pra, vendime, urdhëresa, rregullore, keni parë diçka të këtij
5 lloji?

6 PË. Jo, mesa kam unë dijeni. Nuk kam dijeni të kemi parë
7 diçka të tillë. Por ajo që kemi parë ne ka qenë roli i
8 komandantëve të zonave apo rajonalë dhe roli i Gjeneralit Çeku
9 si dhe struktura ushtarake që ai na e ka përshkruar dhe na ka
10 thënë që jam komandant i kësaj strukture, ka qenë titull
11 tjetër pra. Tani për mua kjo që po shohim nuk është tërësisht
12 e qartë dhe as nuk ka qenë e qartë asokohe.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju qortoj, nuk po
14 ju kritikoj, por a e dini kur u bë z. Çeku anëtar i Shtabit të
15 Përgjithshëm të UÇK-së?

16 PË. Si rregull duhet ta di, po data nuk më kujtohet. Është
17 një informacion që ë ditur publikisht po nuk më kujtohet
18 konkretisht tani kur ka ndodhur.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se kush e ka
20 pasur pozicionin e tij ose një pozicion të ngjashëm përpara se
21 ta merrte ai?

22 PË. Mbase një prej me mbiemër Selimi. Ju thashë që unë kam
23 vështirësi me emrat, po është një nga personat që më pas u bë
24 komandant zone dhe që ka qenë i pranishëm në takime.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua të flas për një

1 grup tjetër pyetjesh, po do të jap kontekstin në fillimisht.
2 Ju janë bërë disa pyetje në kontekstin e demilitarizimit,
3 marrëveshjes së demilitarizimit edhe zinxhirit komandues të
4 UÇK-së. Nga sa kam kuptuar unë nga dëshmia juaj dhe ju lutem
5 ta sqaroni apo të më thoni nëse nuk e kam kuptuar drejt, pra,
6 unë e kam kuptuar sikur ju thatë se për zbatimin e kushteve të
7 marrëveshjes, sipas jush, zbatimi duhej kryer nga kahu
8 ushtarak i UÇK-së.

9 PË. Më falni se mikrofoni juaj u mbyll.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndjesë. A e kam kuptuar
11 unë drejt që, sipas jush, këtë marrëveshje duhet ta zbatonte
12 pjesa ushtarake e UÇK-së, pikërisht ata duhet të zbatonin
13 kushtet e marrëveshjes, pjesa ushtarake e UÇK-së, kahu
14 ushtarak i UÇK-së?

15 PË. Po, sepse sipas informacionit që kishim ne dhe, besoj se
16 jam përpjekur ta shpjegoj, por mbase s'ia kam dalë dot në të
17 shkuarën, ne kishim kuptuar që pushtetin e kishin komandantët
18 e zonave dhe Gjenerali Çeku. Nëse do kishim informacion tjetër
19 atëherë ne do ishim sjellë ndryshe. Nëse ky organ që quhej
20 Shtabi i Përgjithshëm apo që e quan veten Shtabi i
21 Përgjithshëm nëse do kishte qenë një organ i fuqishëm që të
22 kishte kompetenca dhe të ishte në një gjendje të komunikonte
23 me ne, atëherë pikërisht Shtabit të Përgjithshëm do i ishim
24 drejtuar ne. Por ama ne nuk e bëmë, sepse, sikurse ua thashë,
25 ne nuk e kemi parë këtë Shtab të Përgjithshëm.

1 Ne nuk kemi parë asnjë provë të ekzistencës së Shtabit të
2 Përgjithshëm. Di që ishte krijuar diçka në të shkuarën, kishte
3 disa deklarata publike. Po informacionet që kishim ne dhe
4 arsyeja që pse shkova në Tiranë dhe nuk shkova në Lubjanë ishte
5 pikërisht sepse ne na kishin thënë se personat me të cilët
6 duhet të komunikojmë me dhe të bashkëpunojmë ne, ndër të
7 tjerët ishte dhe Gjeneral Çeku, i cili na tha që "Personat që
8 duhet të kemi në palën tonë janë komandantët e zonave".

9 Kjo ishte arkitektura, efikase, jo efikase, nuk ka
10 rëndësi tani, por kompetencën dhe pushtetin e kishin këta
11 persona dhe pikërisht prandaj ne shkuam takuam këta persona.

12 Nuk e di sa ju ndihmova.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do shohim një dokument
14 tjetër për ta sqaruar dhe më tej këtë aspekt, po për këtë do
15 të kalojmë në seancë private për shkak të kërkesës së
16 rregullës 107.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 135

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 136

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 137

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 138

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 jemi në seancë publike.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
18 Sekretares.

19 Dhe faleminderit dhe juve, z. Duncan, për durimin dhe
20 për përgjigjet.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
22 Smith.

23 Së pari dua t'ju bëj një pyetje lidhur me dallimin që
24 keni bërë ju z. Duncan midis krahut ushtarak --

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A është e mundur të bëjmë

1 pushim prej dhjetë minutash, se zakonisht e kemi në këtë kohë
2 e kemi pushimin.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka ndonjë bazë shkresore
5 lidhur me këtë dallim që bëni ju midis krahut politik dhe
6 krahut ushtarak të UÇK-së? Ka ndonjë dokumentacion ku
7 mbështetet ky dallim?

8 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Juve gjatë dëshmisë i jeni
10 referuar dhe keni bërë dallimin midis krahut ushtarak dhe
11 krahut politik. Këto formulime ose kjo lloj ndasie nuk është
12 se është përdorur në tekstin e marrëveshjes. Çfarë ju ka bërë
13 juve të arrini në përfundimin që kishte një dallim midis
14 krahut politik dhe krahut ushtarak?

15 PË. Ju kërkoj ndjesë, nëse keni krijuar përshtypjen nëse
16 kishte ndarje të qartë. Ajo çfarë po sugjeroja unë, çfarë po
17 mundohesha të thoja është që ata kishin role të veçanta. Të dy
18 kahet kishin role të veçanta. Por nuk kam thënë në asnjë
19 moment që këto ishin dy organe tërësisht të veçanta.

20 Nuk e di si ta shpreh ndryshe ose nuk e di si të jem më i
21 qartë se kaq. Ishte e vështirë që të bëhej dallimi midis atyre
22 që kishin qenë aktivë në operacione në terren, domethënë,
23 personave që kishin marrë pjesë në operacione në luftime në
24 terren dhe atyre që kishin zgjedhur të kishin funksione
25 politike. Domethënë, si ta bësh dallimin e prerë me thikë?

1 Sigurisht që nuk mund të kesh një dallim të prerë me thikë,
2 por këta janë persona që kryejnë funksione të ndryshme dhe kjo
3 është mënyra më e mirë që unë mund të shprehem për t'ju bërë
4 të qartë juve që kishte një kah politik dhe një kah ushtarak.

5 Domethënë, organizata guerile ishte e zakonshme që të bëhej
6 një ndarje e tillë, domethënë, kishte persona të cilët
7 fillimisht ishin më shumë të përfshirë në luftime dhe pastaj
8 me kalimin e kohës kishin marrë role politike. Nuk është se ka
9 një dallim të prerë me thikë sikurse e thashë por ka dallim sa
10 i takon roleve.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur jeni takuar më 19
12 qershor të 1999-s, me aktorët kryesorë, siç thoni ju, nga
13 njëra anë jeni takuar me Thaçin, me Çekun dhe Jakup Krasniqin.
14 Për shembull, në këtë rast konkret a mund të më thoni se kush
15 nga këta persona ishte pjesë e krahut politik dhe kush ishte
16 në krahun ushtarak, domethënë, nga Çeku, Krasniqi dhe Thaçi?
17 PË. Çeku ishte shefi i krahut ushtarak, ndërsa z. Thaçi dhe
18 z. Krasniqi kryenin funksione politike.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani duke iu kthyer
20 përgjigjes që dhatë pak më herët, këtu ju a e shikoni si një
21 ndasi të qartë apo mendoni se kishte mbivendosje të këtyre
22 funksioneve, pra, funksionit politik dhe funksionit ushtarak.
23 PË. Është një pyetje në të cilën duhet marrë konteksti, nuk
24 mund të jap përgjigje kështu drejtpërdrejt. Megjithatë, në
25 çdo gjë që unë kam parë në atë negociatë për marrëveshjen, z.

1 Krasniqi dhe z. Thaçi asnjëherë nuk janë futur në çështje
2 ushtarake. Në asnjë rast nuk e kam parë as njërin as tjetrin
3 të merret me çështje ushtarake. Ata kanë folur vetëm për
4 aspekte politike. Po ashtu z. Çeku ka folur vetëm për çështje
5 ushtarake dhe nuk ka fare për çështje politike. Kështu që
6 duhet bërë një dallim praktik lidhur me këtë bisedë edhe
7 lidhur me rolet që ato kanë pasur.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë që më 19 qershor
9 1999, Thaçi dhe James Rubin mbërritën me helikopter.
10 PË. Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës. E keni fjalën për
11 17 apo për 19?

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam përshtypjen që ishte më
13 datë 19 kur ju thatë që këta dy persona kanë mbërritur me
14 helikopter, më korrigjoni nëse e kam marrë vesh gabim.
15 PË. Faleminderit për sqarimin. Unë në fakt më bëri përshtypje
16 që u tha që z. Thaçi dhe James arritën me helikopter. Nuk e
17 mbaj mend këtë gjë. Mbase s'më kujtohet mua.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në çfarë date mbërriti z.
19 Thaçi dhe Rubin?

20 PË. Z. Rubin arriti me helikopter së bashku me neve, ndërkohë
21 që z. Thaçi, mesa më kujtohet, mua ishte atje.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më 19 qershor 1999, të
23 njëjtën ditë që emri i Çekut u zëvendësua me emrin e Thaçit te
24 blloku i nënshkrimeve në marrëveshjen e demilitarizimit, ju
25 thatë që propozimi erdhi nga UÇK-ja, po thatë që nuk ju

1 kujtohet se kush e ka bërë propozimin. A është e saktë kjo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Teksti i marrëveshjes së
5 demilitarizimit shumë herë i referohet Shefit të Shtabit të
6 UÇK-së, por në asnjë rast të vetëm nuk flet për komandantin
7 kryesor të UÇK-së, përveçse aty poshtë tek shënimi, tek blloku
8 i nënshkrimeve. Doja t'ju pyesja, dikush nga NATO a
9 kundërshtoi këtë zëvendësim të menjëhershëm ose të beftë të
10 nënshkruesit të dokumentit nga UÇK-ja, domethënë, që
11 nënshkruesi ishte Hashim Thaçi dhe që ishte përcaktuar si
12 kryeshefi i UÇK-së?

13 PË. Nuk e kuptova mirë pyetjen? Domethënë, a kishte ndonjë
14 person nga NATO që kundërshtonte faktin që Thaçi të ishte
15 nënshkrues?

16 PË. Po. A kishte ndonjë kundërshtim me zëvendësimin e Çekut
17 me Thaçin?

18 PË. Jo, më 19. Më datë 20 mund të ketë pasur mundësi, të
19 nderuar Gjykatës, që mund të ketë pasur biseda apo diskutime.
20 Mbjaj mend që kam marrë transkriptet e thirrjeve telefonike, po
21 jo, nuk mbaj mend asgjë më datën 19.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Megjithatë nga këto draftet
23 që ju keni shkëmbyer, besoj, që ata janë informuar lidhur me
24 ndryshimin e bllokut të nënshkrimeve në marrëveshje apo jo?

25 PË. Të nderuar Gjykatës, sigurisht, ata i shikonin se kanë

1 parë dokumentin. Për shembull, NATO e ka parë dokumentin në
2 hollësi më datë 20 qershor.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ndonjë nga këto komandantët
4 e zonave ose personelit të UÇK-së që ka qenë i pranishëm në
5 negociata, a ka kundërshtuar që Çeku të zëvendësohej me
6 Thaçin, pra, emri i Çekut të zëvendësohet me emrin e Thaçit?
7 PË. Jo, sa më kujtohet mua, i nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e kam kuptuar drejt se çdo
9 person aty ishte i interesuar që të arrihej një marrëveshje që
10 në fakt do të vëzhgohej ose do të monitorohej nga UÇK-ja, e
11 kam kuptuar drejt këtë apo jo?

12 PË. Nuk e kuptoj pyetjen.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do e bëj ndryshe pyetjen. A
14 pajtoheni ju me faktin që t'i kërkosh një ushtrie çlirimtare
15 të çmilitarizohet është një prej aspekteve më të ndjeshme të
16 procesit të pages?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe asnjë komandant
19 përgjegjës nuk do e militarizojë ushtrinë në qoftë se ata
20 besojnë që forcat e tyre do të sulmohen më pas?

21 PË. Po, është prezumim i saktë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A kam të drejtë që e kam
23 kuptuar, që praktika e mirë për lidërshtipin e UÇK-së ishte që
24 të konsultoheshin me komandantët e zonës të cilët ishin
25 përgjegjës në fund fare për të realizuar dhe për të dhënë

1 pëlqimin fillimisht për marrëveshjen e demilitarizimit të
2 trupave të tyre në terren?
3 PË. Ky ishte prezumimi por bëhej fjalë për një organizatë e
4 cila nuk ishte hierarkike ku njerëzit nuk është se bënë ashtu
5 siç ju thoshin eprorët, por bëhej fjalë për një organizatë që
6 kishte një strukturë më komplekse sa i takon kompetencave dhe
7 autoritetit dhe atë kompetenca sa thuhej.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Duke iu kthyer përsëri
9 zëvendësimit të Thaçit, domethënë, zëvendësimit të Çekut me
10 Thaçin si nënshkrues, ata që ishin të pranishëm a kuptuan që
11 Hashim Thaçi kishte më shumë të ngjarë të ishte në gjendje të
12 siguronte përputhjen e UÇK-së me këtë marrëveshje sesa Agim
13 Çeku, domethënë, kishte më shumë peshë fjala?

14 PË. Me si e keni kuptuar ju dhe, kjo lidhet me diskutimin që
15 u nis prej kolegut tuaj, kompetenca ishte në të dyja anët.
16 Domethënë, kishim nga njëra anë kahun ushtarak që ishte i
17 përfshirë në sulme dhe në operacione në terren dhe nga ana
18 tjetër kemi dhe kahun tjetër, por nga ana tjetër ne mendojmë,
19 unë mendoj, që kompetenca ishte midis Agim Çekut dhe
20 komandantëve të zonës. Domethënë, ky ishte grupi që kishte më
21 shumë në dorë realizimin e marrëveshjes. Unë besoj këtë
22 gjykim. Ndërkohë që z. Thaçi erdhi si kërkesë e tyre për të
23 nënshkruar.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë, komandantët e
25 zonës dëshironin që Thaçi të nënshkruante marrëveshjen në emër

1 të tyre?

2 PË. Jo, emri i tij nuk erdhi nga komandantët e zonës. Por nga
3 bashkëbiseduesit që ne i përshkruanim si persona kyç, kryesorë
4 që ishin personat që kanë biseduar më shumë ose që kanë
5 shprehur më shumë mendimet e tyre lidhur me ato diskutime, që
6 kanë qenë Gjenerali Çeku, z. Thaçi, z. Krasniqi.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju mendoni që komandantët
8 e zonës ishin mbështetës që z. Thaçi të nënshkruante
9 marrëveshjen apo jo?

10 PË. Nuk është se e kanë kundërshtuar ata këtë gjë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do kalojmë rreth
12 provës, ose, le të themi, informacionit të përgjithshëm që
13 kishte shumë pak kontroll dhe komandë brenda UÇK-së. Në qoftë
14 se nuk po e shpreh siç duhet, ju lutem më korrigjoni.

15 Duket sikur teksti i marrëveshjes së demilitarizimit
16 prezumon që UÇK-ja në fakt kishte komandë dhe kontroll. Le të
17 shohim paragrafin 9 që ka marrë numrin e provës P01444.

18 Do i kërkoj Sekretares që të paraqesë dy versionet në
19 shqip dhe në anglisht në ekran.

20 Këtu thuhet:

21 "Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së merr përsipër
22 që të lëshojë urdhra dhe udhëzime të qarta dhe të sakta për të
23 gjithë njësitë dhe personelin e vet që është nën komandën e
24 vet për të siguruar që përmbushen të gjitha aspektet
25 organizative për ta vënë në jetë apo për t'i dhënë jetë kësaj

1 marrëveshje, për të zbatuar këtë marrëveshje.”

2 A kam të drejtë unë që mënyra se si e kuptoj këtë pjesë
3 është që presumohet në atë marrëveshje që ka komandë dhe
4 kontroll UÇK-ja vetë sa i takon zbatimit, apo jo?
5 PË. Është një pyetje e ngjashme me pyetjen e mëparshme që më
6 bëtë, por është një aspekt i ndryshëm i të njëjtës pyetje.
7 Personi i quajtur shefi i Shtabit të Përgjithshëm është
8 Gjenerali Çeku -- gjithsesi mund t’i kthehem prapë këtij
9 aspekti. Pra, Gjenerali Çeku është personi që ka komandë dhe
10 kontroll dhe sikurse e kemi diskutuar dhe më herët, kuptoj që
11 ekziston një përkufizim ligjor në sistemin e drejtësisë ose
12 gjykatave ndërkombëtare sa i takon komandës dhe kontrollit.

13 Ky përkufizim nuk është në të njëjtën linjë me atë se si
14 e kupton këtë term NATO. NATO kupton këtë që ti jep, ke
15 komandë, pra, jep urdhra, ndërkohë që personi që kryen këto
16 aspekte duhet të ketë komandë dhe kontroll. Domethënë, e bëra
17 këtë dallim dhe më herët gjatë dëshmisë time.

18 Domethënë, është e njëjta gjë si çfarë ndodhi në rastin e
19 rusëve që shkuan në Prishtinë, kjo është mënyra më e thjeshtë
20 për ta shpjeguar apo për të thënë se si ishte situata.

21 Gjenerali Clark kishte komandë dhe ai i ka dhënë urdhër
22 Gjeneralit Jackson ndërkohë që Gjenerali Jackson kishte
23 komandë dhe kontroll. Ndërkohë që Gjenerali Wesley Clark nuk
24 kishte kontroll sepse ekzistonte mundësia e asaj çfarë quhej
25 karta e kuqe dhe shtetasit, kombet e tjera mund të thonin “Jo,

1 që ti ke kontroll."

2 Domethënë, është e rëndësishëm që të bëhet dallimi midis
3 kontrollit dhe komandës dhe kontrollit. Domethënë, ideja është
4 që dikush mund të kishte kontroll por jo komandë, por kishte
5 dhe persona që kishin dhe kontroll dhe komandë. Ndërkohë sa i
6 takon aspektit të kontrollit dhe komandës, në kontekstin e
7 UÇK-së, këtë kontroll dhe komandë e kishte Agim Çeku. Z. Thaçi
8 kishte komandë po jo domosdoshmërisht kontroll. Ai mund të
9 lëshonte udhëzime.

10 Por a siguronte dot zbatimin e tyre? Nuk e kuptonin
11 kështu, nuk ishte kështu situata atëherë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në qoftë se ju mendonit që
13 Agim Çeku kishte kontroll dhe komandë, që nuk e kishte z.
14 Thaçi, pse nuk insistuat juve që Agim Çeku do vazhdonte të
15 ishte nënshkruesi i marrëveshjes?

16 PË. Për arsye që ata duhet të pajtoheshin, të binin në
17 dakordësi se unë isha besimplotë që ne kishim bërë një
18 negociatë me të gjithë ata që kishin shtresa të ndryshme ose
19 nivele të ndryshme kompetence ose autoriteti. Pra, të gjithë
20 këta persona kishin një farë kompetence. Këta kishin
21 kompetencë për t'u siguruar që kjo marrëveshje do të zbatohej
22 dhe ne e dimë sesi mendojnë shqiptarët, domethënë, ata kanë --
23 e kanë besën shumë të rëndësishme, kështu që në qoftë se
24 zotohen që do ta bëjnë diçka të tillë e zbatojnë atë.

25 Dhe jo vetëm kaq, po ka edhe një shtresëzim tjetër sepse

1 ata kishin aspiratat e veta për sa i takon të ardhmes së
2 Kosovës, domethënë, të armatës ose ushtrisë së ardhme të
3 Kosovës. Kështu që në qoftë se ata dëshironin që marrëveshja
4 të nënshkruhej nga z. Thaçi për ne nuk është se kishte asnjë
5 lloj problemi. Për ne do ishte problem në qoftë se nën emrin e
6 z. Thaçi do shkruhej kryeministri i Qeverisë së Përkohshme së
7 Kosovës, por Gjenerali Çeku dhe komandantët e zonës u pajtuan
8 me këtë proces. Kishin të gjithë arsyet e mundshme që të
9 pajtoheshin me të.

10 Domethënë, të duket shumë e komplikuar kur e shpjegon por
11 të paktën ky është realiteti si e kam parë unë, ose të paktën
12 kështu e kam kuptuar unë situatën dhe ju kam thënë që hartimin
13 e marrëveshjes e kam bërë unë.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa i takon ndalimit të
15 civilëve në Kosovë dhe, e dimë nga prova të tjera që kjo nuk
16 është respektuar si pikë, kjo ka qenë një marrëveshje
17 demilitarizimi e suksesshme përgjithësisht apo jo?

18 PË. Po, po. Të dhënat tregojnë, informacioni tregon që
19 përgjithësisht ka qenë një marrëveshje e suksesshme. Pra, u
20 sigurua marrëveshja që UÇK-ja u demilitarizua, pra, nga
21 perspektiva tona, nga perspektivat tona u përmbush objektivi
22 ynë.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit.
24 Duke marrë parasysh këtë shqetësim, domethënë, demilitarizimin
25 e një force që duhet të ishte nga 25 deri në 30.000 ushtarë,

1 një marrëveshje e tillë e nënshkruar nga z. Thaçi si
2 kryekomandant i UÇK-së, në fakt, a nuk rezulton që për arsye
3 të kësaj marrëveshjeje Hashim Thaçi ka ushtruar efektivisht
4 ose në mënyrë efikase kontroll dhe komandë mbi UÇK-në?
5 PË. Jo. Sepse bëhej fjalë për një marrëveshje
6 gjithëpërfshirëse, nuk është se kishte një hierarki nga lart
7 poshtë. Këtë jam përpjekur t'jua shpjegoj gjatë gjithë kohës.
8 Mbase nuk jam shprehur mirë gjatë gjithë kohës. Megjithatë, të
9 gjithë aktorët në proces kishin interes, jo se ai kishte
10 kontroll dhe komandë, por se të gjithë palët ishin të
11 interesuar që marrëveshja të ndodhte. Kjo nuk ka të bëjë fare
12 me komandën dhe kontrollin. Është një çështje diplomatike sesi
13 të gjitha palët pajtohen për objektivin. Pra, për aq kohë sa
14 të gjithë pajtohen me zbatimin nuk është fare e rëndësishme
15 dhe nuk mendoj që çështja e komandës dhe kontrollit është
16 përgjigja sesi ka funksionuar sepse u realizua kjo
17 marrëveshje. Nuk e mendoj këtë gjë.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje
19 të tjera për ju, Dëshmitar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
21 bëjmë një pushim. Pushim për dhjetë minuta.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shkurtimisht
24 dua t'ju kërkoj për kohën. Nuk e di nëse mund të përfundojmë
25 sot, apo jo, thjesht sa për të pasur një ide.

1 Prokuroria ka pyetje plotësuese?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

4 Tavakoli?

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, ne kemi disa pyetje. Rreth
6 15 minuta.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Edhe ne kemi disa pyetje, mbase pesë
8 deri në shtatë minuta.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Mbase kemi pesë deri në shtatë
12 pyetje.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
14 mbani parasysh faktin që dëshmitari duket i lodhur, kështu që
15 mundoheni që të bëni minimumin e pyetjeve. Nuk dua që t'ju heq
16 mundësinë për të bërë pyetje, por gjithsesi duhet të keni
17 parasysh lodhjen e dëshmitarit. Do bëjmë pushim për dhjetë
18 minuta dhe pastaj do kthehemi përsëri në sallë.

19 --- Seanca ndërpritet në orën 15.56

20 --- Seanca rifillon në orën 16.04

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 silleni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Duncan, të
25 kemi lodhur sot. Do përpiqemi që të përfundojmë sot, edhe pak

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli

Faqe 152

1 na ka mbetur. Na ka mbetur dhe rreth gjysmë ore për të
2 përfunduar.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
5 përballoni atë?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Ndjej që jemi në një situatë ku
7 diplomatët dhe avokatët flasin përpara njëri-tjetrit dhe ju
8 kërkoj ndjesë që tregoj këtë ndjesi timen gjatë procesit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
10 [Përkthim] Do të përpiqemi që të përballojmë dhe gjysmë ore
11 tjetër.

12 Në rregull, atëherë do të vazhdojmë. Znj. Tavakoli ka
13 disa pyetje për ju dhe do të bëjë pyetje lidhur me pyetjet e
14 bëra nga anëtarët e Trupit Gjykses, jo pyetje të reja.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
17 mund të filloni.

18 Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli:

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

20 PY. Mirëdita, z. Duncan.

21 PË. Mirëdita.

22 PY: Nuk e di në qoftë se ju kujtohet një pyetje e bërë nga
23 Gjykatësi Barthe?

24 PË. Po dëgjoj.

25 PY. Po pres që të zbardhet në transkript. Atëherë pyetja

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli

Faqe 153

1 kishte të bënte me FARK-un, në qoftë se juve ju kujtohet nëse
2 FARK-u ka kryer veprime ushtarake në Kosovë në verën e 1999-s.
3 Ju kujtohet kjo pyetje?

4 PË. Më kujtohet pyetja.

5 PY. A ju kujtohet që thatë që nuk ju kujtohet në qoftë se ka
6 qenë kështu apo jo, për shkak se ka kaluar shumë kohë që
7 atëherë dhe për këtë do ju duhej që të shikonit raportet? Ju
8 kujtohet të keni dhënë këtë pyetje [Sipas përkthimit],
9 Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Tani le të shohim në ekran dokumentin 1D236. Do të duhet
12 pak sa të shfaqet në ekran, z. Duncan.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Duhet të kalojmë në seancë
14 private.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
16 seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli

Faqe 154

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
20 publike, të nderuar Gjykatës.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

22 PY. Unë tani do t'i kthehem disa pyetjeve që ju ka bërë
23 Gjykatësi Mettraux. Së pari në pyetjen lidhur me një dekret
24 apo me një dokument që pretendohet se ishte Dekreti 84/99, 28
25 prill nënshkruar nga kryeministri Hashim Thaçi.

- 1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem ta vendosim në ekran.
- 2 Është P00113. Faqja e tretë. Zbresim pak poshtë ju lutem, znj.
- 3 Sekretare.
- 4 PY. Gjykatësi Mettraux ju tha se ishte nënshkruar nga
- 5 Kryeministri Hashim Thaçi dhe ju tha që me këtë caktohet Agim
- 6 Çeku që të jetë shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
- 7 Çlirimtare të Kosovës. A e shikoni?
- 8 PË. Po.
- 9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë mund ta heqim këtë
- 10 dokument nga ekranin.
- 11 PY. Dhe pak më pas me Gjykatësi Mettraux ju kërkoi që të
- 12 konfirmonit që Agim Çeku ka nënshkruar marrëveshjen për
- 13 çarmatosjen më të njëjtin post duke nënshkruar si shef i
- 14 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. A të kujtohet kjo pyetje?
- 15 PË. Po, më kujtohet kjo pyetje.
- 16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani a mund të vendosim në
- 17 ekran 1D99 në faqen e dytë.
- 18 PY. Kjo është edhe marrëveshja e çarmatosjes?
- 19 PË. Po.
- 20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë të kalojmë tek pjesa e
- 21 nënshkrimeve.
- 22 PY. Dhe këtu shihet si e ka nënshkruar, me ç' emër e ka
- 23 nënshkruar Agim Çeku këtu si shef i shtabit?
- 24 PË. Shef i shtabit, jo shef i Shtabit të Përgjithshëm.
- 25 PY. A është posti i shefit të shtabit a është i njëjtë me atë

1 Shtabit të Përgjithshëm sa u përket terminologjisë ushtarake?
2 PË. Në terminologjinë ushtarake është e ndryshme.
3 PY. Na e shpjegoni pak.
4 PË. Shefi i shtabit është oficer administrativ. Në selinë e
5 NATO-s keni komandantin strategjik, ka zëvendësin, zëvendësin
6 e tij dhe shefin e shtabit. Të tretë janë oficerë me grada me
7 katër yje. Shefi i shtabit është ai që është përgjegjës për të
8 gjithë selinë, rol administrativ. Shefi i Shtabit të
9 Përgjithshëm është rol ushtarak që ka të bëjë me çështje
10 strategjike ushtarake, që nuk ka të bëjë me administrative.
11 Është çështje komanduese.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Tavakoli, a po
13 sugjeroni që ky është post i ndryshëm? Pasi nëse është kjo
14 çështje, shefi i shtabit funksionon ashtu siç thotë z. Duncan
15 dhe ka një komandant të cilit i përgjigjet ky shef i shtabit
16 kështu. Kjo është ajo që po thoni?

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Më lejoni të konsultohemi një
18 sekondë.

19 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kur të paraqesim dosjen tonë
21 përfundimtare atëherë do e konfirmojmë një gjë të tillë. Nuk
22 kam pyetje të tjera për të bërë këtij dëshmitari.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Z. Duncan, unë kam vetëm disa pyetje që më mbeten dhe që
3 dalin nga pyetjet e bëra nga Gjykatësit.

4 E para ka të bëjë me një pyetje që bëri Gjykatësi Barthe
5 në fillim të seancës së pyetjeve të tij. Të pyetën lidhur me
6 bazën faktike të pohimit që Qeveria e Përkohshme nuk kishte
7 kompetenca për të dhënë urdhra askujt në procesin e zbatimit
8 të marrëveshjes për çarmatim?

9 PË. Po.

10 PY. Ju thatë:

11 "Po. Baza faktike është ..."

12 Dhe në faqen 93 ju thatë:

13 "... përgjigjem sa më saktë të jetë e mundur. Ishte një
14 organizatë e vetëdeklaruar kishit deklaruar në një numër
15 organesh. Siç kemi parë ministri të mbrojtjes e kështu me
16 radhë, po nuk ishte shtet. Nuk kishte arkitekturë mbështetëse
17 për t'i mbështetur këto organe të emërtuara."

18 A të kujtohet një gjë e tillë?

19 PË. Po.

20 PY. Është e drejtë apo jo që kur flet për organe të
21 vetëdeklaruar ato përfshinin ministrinë e mbrojtjes dhe disa
22 ministri të tjera pasi dua të kuptoj bazën faktike që po
23 paraqisni ju këtu.

24 Keni pasur ministri të shërbimit të zbulimit?

25 PË. Besoj se po.

1 PY. Ministri të rendit publik?

2 PË. Po.

3 PY. Ministri të drejtësisë?

4 PË. Po.

5 PY. Pra, një numër të këtyre organeve të vetëdeklaruar?

6 PË. Po, kështu e kam kuptuar unë.

7 PY. Dhe sa i përket ministrit të shërbimit të zbulimit të
8 Kosovës, a është e saktë, që ky organ dhe ky ministër nuk kanë
9 pasur mundësi praktike për të marrë masa sa i përket zbatimit
10 të marrëveshje së çarmatimit?

11 PË. Po, kështu e kuptoj unë. Dhe për ta shpjeguar se përse
12 dhe për të qenë sa më i qartë në përgjigje ndaj pyetjes së
13 bërë nga Paneli.

14 A mund të kalojmë në seancë private, ju lutem?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Unë kam kërkuar bazën faktike dhe
16 unë po dëgjoj këtu që do të japë një shpjegim të mëtejshëm dhe
17 nuk shoh arsyen se përse duhet të ndodhë një gjë e tillë. Kemi
18 kohë për të përfunduar çdo gjë, i nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
20 seancë private ju lutem.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Dëshmitari duhet t'i përgjigjes
22 pyetjes sime me një koment tjetër.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 159

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
14 publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

16 Z. DIXON: [Përkthim]

17 PY. Z. Duncan, për të konfirmuar se aty ku e nisa, ku
18 përmenda ministrin e shërbimit të inteligjencës së Kosovës,

19 është e saktë ajo që thatë ju si përgjigje ndaj pyetjes së

20 Gjykatësi Barthe se nuk ka patur arkitekturë për t'i

21 mbështetur këto organe të vetëshpallura dhe kjo ka vlerë edhe

22 për ministrinë apo për shërbimin e inteligjencës së Kosovës?

23 PË. Ka ekzistuar në UÇK një organ që mbledhte informacione të

24 zbulimit dhe luante "rol policor", po ishte aktiv dhe i

25 ushtronte kompetencat në një fushë të kufizuar gjeografike,

1 kështu e kemi kuptuar ne.

2 PY. Kur thoni që kishte, që operonte, a e keni fjalën që
3 operonte në disa hapa në "një pjesë të kufizuar kosovare" apo
4 në disa xhepa si të thuash gjeografik?

5 PË. Nuk e kemi të saktë, nuk mund ta precizojmë.

6 PY. Dhe nga ajo që keni kuptuar, a mendoni që kjo ka
7 ekzistuar pa një strukturë komanduese qendrore?

8 PË. Ne kemi patur njohuri të kufizuara për shkak të natyrës
9 së kësaj organizate, pra, kemi patur njohuri të kufizuara
10 lidhur me mënyrën apo në fushëpërfshirjen apo në shtrirjen e
11 aktivitetit të saj.

12 PY. Për sa i përket kësaj periudhe 1998, 1999, për këtë
13 periudhë e keni fjalën?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe ministria apo ministria e inteligjencës së Kosovës
16 dhe e kemi fjalën për periudhën e Qeverisë së Përkohshme?

17 PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojnë që të ngadalësohet e
18 folura.

19 Z. DIXON: [Përkthim]

20 PY. Mesa e dini ju dhe kemi arritur tani në qershor të 1999-
21 s, në periudhën e nënshkrimit të marrëveshjes, kjo ministri
22 nuk ka ekzistuar, apo jo?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë, kjo pyetje është
24 bërë dhe ka marrë përgjigje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi dakord.

1 Z. DIXON: [Përkthim] E mora përgjigjen më duket.

2 PY. Kjo është përgjigja?

3 PË. Jo, nuk është e saktë. Ka ekzistuar, ka organizuar një
4 shërbim të zbulimit aktiv në arkitekturën e UÇK-s?

5 PY. Po tani po flas për qershorin e 1999-s, kur po flisnim
6 për Qeverinë e Përkohshme dhe për krijimin e shërbimit të
7 zbulimit civil në Kosovë, e kam fjalën për qershorin e 1999.

8 PË. Në qershor 1999? Nga pikëpamja jonë nëse ishte ushtarake
9 apo civile për ne bëhej fjalë për një shërbim të zbulimit që
10 ishte i vetëqenësishëm.

11 PY. E kam fjalën për shërbimin civil të zbulimit. A mendoni
12 që ka ekzistuar ai në atë kohë?

13 PË. Nuk besoj që mund të bëjmë dallimin mes të dyjave. Ishte
14 një shërbim i zbulimit.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani do të
16 kaloj në një tematikë të fundit.

17 PY. Dhe pastaj do të përfundoj. Dhe kjo ka të bëjë me një
18 pyetje të bërë nga i nderuar Gjykatësi Mettraux. Pyetja kishte
19 të bënte me komentin që përsëritët lidhur me faktin se kush e
20 kishte pushtetin në UÇK, dhe që nuk e kishte Shtabi i
21 Përgjithshëm si organizëm kolektiv.

22 Gjykatësi Mettraux ju pyeti nëse keni parë ndonjëherë
23 dokumente, rregullore, vendime apo dokumente të çfarëdolloj
24 natyre. Kjo pyetje u bë nga Gjykatësi Mettraux në faqen 27.
25 Dhe thatë:

1 "Mesa kam dijeni, jo."

2 Të kujtohet një gjë e tillë?

3 PË. Po.

4 PY. A është e saktë atëherë që qasja ndaj këtyre dokumenteve
5 nuk ishte pjesë e punës suaj për atë që po ndodhte? Ju e keni
6 vlerësuar situatën mbi bazën e informacioneve që keni marrë,
7 na keni treguar se si i keni marrë dhe më pas keni vepruar në
8 bazë të asaj që ka dalë?

9 PË. Nuk e kuptoj dot pyetjen siç e keni bërë ju. A mund ta
10 bëni në mënyrë pak më saktë?

11 PY. E ka fajin formulimi im. Pyetja ime është kështu që në
12 atë kohën tuaj ti nuk ke pasur nevojë që të kesh pasur qasje
13 ndaj këtyre dokumenteve që mund të kishte nxjerrë Shtabi i
14 Përgjithshëm pasi ajo që kishe në dispozicion ishte
15 informacioni që kishe dhe e keni formuluar gjykimin tuaj mbi
16 bazën e tyre?

17 PË. Do të kishte qenë me vlerë po t'i kisha parë, por nuk kam
18 parë asnjë. Nuk kam parë dokumente si ato që ka përmendur i
19 nderuar Gjykatës. Kjo nuk është çështja nëse ishin me rëndësi.
20 Nuk i kam parë. Po t'i kisha parë do kishin qenë me relevancë
21 për punën time.

22 PY. A i keni kërkuar këto dokumente në atë kohë?

23 PË. Unë kam kërkuar për të gjithë informacionin e mundshëm
24 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

25 PY. Po a është e drejtë që gjykimin tuaj dhe pikëpamjet tuaja

Dëshmitari: John Duncan (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 164

1 - dhe nuk ishin vetëm tuajat por edhe të tjerëve - i keni
2 formuar mbi bazën e realitetit siç i keni parë, me njerëzit që
3 keni takuar e kështu me radhë?

4 PË. Është një mënyrë se si mund të shprehet një gjë e tillë.

5 PY. Dhe sipas mendimit tënd Shtabi i Përgjithshëm si
6 organizëm kolektiv nuk kishte fuqinë. Ky ishte konkluzioni që
7 keni nxjerrë nga informacioni që keni patur në atë kohë?

8 PË. Nuk mund të shtoj më shumë sa thashë në seancë private
9 lidhur me këtë çështje.

10 PY. E kemi atë informacion dhe do ta shfrytëzojmë.

11 Faleminderit, z. Duncan. Nuk kam më tej.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

13 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, ne kemi ndryshuar mendimin 20
14 minutat e shkuara.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
17 dy pyetje kam për të bërë.

18 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

19 Z. ELLIS: [Përkthim]

20 PY. Z. Duncan, për herë të fundit, pyetjet dhe përgjigjet të
21 cilat ndodhen në faqen 106 dhe 107 të transkriptit që kanë të
22 bëjnë me datën 19 qershor, kur kishit negociatat me këtë grup
23 të vogël ku identifikuat Gjeneralin Çeku, Hashim Thaçin dhe
24 Jakup Krasniqin. Në faqen 107 të transkriptit thatë se në këtë
25 takim nënvijëzova me forcë se:

1 "... nuk mund të vazhdohej kështu, tregova arsyet se
2 përse nuk mund të vazhdohej kështu. Dhe ua lashë atyre që të
3 flisnin me kolegët dhe vartësit e tyre për ta shpjeguar
4 qëndrimin."

5 Dhe e ke shpjeguar në përgjigje ndaj pyetjeve të
6 dëshmitarëve me mënyrën se si e keni perceptuar ju krahun
7 politik dhe atë ushtarak.

8 Dhe është e vërtetë që ju keni pritur që Gjenerali Çeku
9 të fliste me kolegët ushtarakë dhe Jakup Krasniqi të fliste me
10 kolegët politikë?

11 PË. Dhe e njëjta gjë vlente edhe për z. Thaçi.

12 PY. Dhe sa i përket palës ushtarake, e keni parë që ka ndodh
13 një e tillë, pasi keni parë që z. Çeku ka folur me komandantët
14 e zonës duke shfrytëzuar një diagramë që i kishit dhënë ju?

15 PË. Besoj se një e tillë shihet në videon që kemi. Mund ta
16 kem gabim. Po më duket se një gjë e tillë ka ndodhur.

17 PY. Faleminderit. Kaq kisha.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
19 që erdhët këtu. Faleminderit që na dhatë informacionet tuaja
20 dhe që treguat durimin e duhur gjatë këtyre dy ditëve. E
21 vlerësojmë. Ju urojmë gjithë të mirat për të ardhmen.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 largoheni.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
3 për durimin të gjithëve. Faleminderit për durimin. Ishte e
4 rëndësishme që ta përfundonim me këtë dëshmitar. Ka kaluar
5 mjaft.

6 Shihemi të hënën e ardhshme në orën 9.00, kemi dy
7 dëshmitarë të rinj.

8 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25